

**PARTNERITETI
PËR
QEVERISJE TË HAPUR**

PLANI KOMBËTAR 2023-2025

Mars 2023

Partne i



TABELA E PËRMBAJTJES

KONTEKSTI.....	4
HAPA TË NDËRMARRË PËR FORCIMIN E QEVERISJES SË HAPUR	4
FUSHAT KU PËRFSHIHEN ANGAZHIMET	18
ANGAZHIMET	18
1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit	19
2. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues	34
3. Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe integrimi i tyre në praktikatat e vendit tonë.....	39
4. Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi identifikimin e pronarëve përfitues dhe dokumentet shoqëruese për regjistrimin e të dhënave të tyre	42
5. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi	45
6. Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).....	59
7. Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë e-Albania.....	69
8. Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb/për portalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”)	76
9. Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve për shërbimet elektronike.....	83
10. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH, si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik	89
11. Ngritja e Bazës së të Dhënave për organizatat rinore	97
12. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore	106
13. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave.....	115
14. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike.....	122
15. Rritja e transparencës për kontratat publike	127
16. Promovimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.....	139
17. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.....	148

18. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit	155
19. Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta.....	162
20. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim ...	169
21. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.....	181
22. Rishikimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të tij nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar...	185
23. Vlerësimi i ndikimit, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të jenë në themel të një sistemi politik-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson aksesin e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.....	193
24. Bashkërendimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimin të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizmit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vëniesnë jetë të Platformës e-legislation.....	.203

KONTEKSTI

Qeverisja e hapur është çelësi për qëndrueshmërinë e një demokracie funksionale në një shoqëri moderne dhe gjithëpërfshirëse. Qeveria e Shqipërisë ka zhvilluar Planin e 6-të Kombëtar të Veprimit (PKV) që prej fillimit të iniciativës ndërkombëtare të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (OGP) në 2011.

Republika e Shqipërisë, si një nga 77 shtetet anëtare të nismës globale Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) dhe që nga fillimet e saj në vitin 2011, mbështet parimet e transparencës, luftën ndaj korrupsionit, fuqizimit të qytetarëve dhe përdorimit të përfitimeve të teknologjive të reja për të mundësuar të gjitha nivelet e administratës publike të bëhen më efikase dhe të përgjegjshme dhe të krijojnë parakushtet për një ofrim më efikas dhe inovativ të shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve publike.

Qeveria e Shqipërisë thekson vendosmërinë e saj për të promovuar, mbështetur dhe zhvilluar politika specifike për një qeverisje të hapur, në të cilën transparenca, dixhitalizimi i administratës, lufta kundër korrupsionit, drejtësia, përfshirja institucionale dhe llogaridhënia përfaqësojnë vlera vendimtare në zhvillimin e demokracisë, bazën e politikave në nivel të qeverisë, duke respektuar agjendën e qytetarëve. Gjithashtu, Programi i Qeverisë thekson përmirësimin e efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike me qëllim plotësimin sa më efikas të nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë si dhe masat që synojnë forcimin e transparencës, përgjegjësisë dhe integritetin.

Hartimi i Planit të ri Kombëtar të Veprimit 2023-2025 ndjek parimet dhe udhëzuesin e OGP-së në kuadër të PKV-së së re 2023-2025, mësimet e nxjerra nga zbatimi i planit të mëparshëm të veprimit, si dhe merr në konsideratë rekomandimet e paraqitura në raportin e Mekanizmit të Pavarur Raportues të PQH-së.

HAPA TË NDËRMARRË PËR FORCIMIN E QEVERISJES SË HAPUR NË SHQIPËRI

Me zbatimin e Planit të mëparshëm të Veprimit, qeveria shqiptare ka arritur progres të rëndësishëm në fushat që janë në fokus të Iniciativës OGP. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme në fushën e forcimit të një qeverie të hapur dhe transparente, ia vlen të theksohen disa nga arritjet më të rëndësishme në periudhën e mëparshme:

Transparenca Fiskale si pjesë e Reformës për Menaxhimin e Financave Publike

Reforma për menaxhimin e financave publike vazhdon të jetë një prioritet i qeverisë shqiptare jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP), por gjithashtu synon mbështetjen e një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët. Ecuria e kënaqshme në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Referuar raportit të monitorimit MPMQ (SIGMA) të vitit 2021¹, trajektorja e përgjithshme për Shqipërinë në MFP është në rritje, nga 2.8 në 2017 në 3.3 në 2021 dhe është mbi mesataren rajonale prej 3.1. Krahasuar me mesataren rajonale, performanca është e njëjtë ose më e mirë në secilin tregues në fushën e MFP-së, me përjashtim të funksionimit të auditimit të brendshëm (AB). Më e theksuar është performanca e lartë në fushën e

¹ <https://www.sigmaxweb.org/countries/albania-sigma.htm>

prokurimit publik dhe themelet për funksionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), AB dhe auditimit të jashtëm.

“...Të gjitha detyrimet e prapambetura tani regjistrohen në një llogari thesari të veçantë dhe raportet e detyrimeve të prapambetura nxirren direkt nga sistemi. Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 u përgatit duke përdorur Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSh), i zhvilluar rishtazi, dhe u miratua sipas rregullave. Buxheti i vitit 2021 dhe ekzekutimi i buxhetit të vitit 2020 ishin në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit të rishikuar. Drafti i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave është në pritje të finalizimit... ..Në prokurimin publik, ku Shqipëria është mesatarisht e përgatitur, vendi ka bërë progres të mirë, veçanërisht duke miratuar ligjin e ri për prokurimin publik. Për sa i përket statistikave, ku Shqipëria është gjithashtu e përgatitur mesatarisht, ka bërë progres në përafrimin me standardet SELL 2010, publikimin më të shpejtë dhe miratimin e Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në shumicën e fushave për kontrollin financiar, ku vendi ka bërë progres, veçanërisht në kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditimin e jashtëm... ..Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kyçe buxhetore. Publikimi në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura. Transparenca në të gjithë qeverinë vazhdon të tregojë nivele të ndryshme. Pjesëmarrja e publikut në procesin buxhetor duhet të forcohet më tej... ..Në vitin 2020, u arrit përparim thelbësor në monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe miratimin në kohë të planit të ri për 2021-2022. Norma e zbatimit të PKIE-së është përmirësuar në 87% nga 60% që ishte një vit më parë...”

Një nga objektivat e reformës synonte përmirësimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ), në nivelin e qeverisë qendrore, u arrit plotësisht. 20 Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) janë trajnuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe BPGJ gjatë vitit 2021. 33% e programeve buxhetore janë integruar plotësisht në BPGJ. Megjithëse ekipet e menaxhimit të buxhetit të 9 bashkive janë mbështetur teknikisht për të integruar në mënyrë efektive BPGJ-në në dokumentet e tyre të PBA-së.

Është arritur progres në ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) për të përafruar më tej me Acquis Communautaire (direktivat e reja të BE-së). Një ligj i ri për prokurimin publik është miratuar në dhjetor 2020, duke transpozuar 4 direktiva të BE-së. Në vijim të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, legjislacioni sekondar u miratua në vitin 2021. Planet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik (SPE) që nuk u materializuan gjatë vitit 2020 u zbatuan gjatë vitit 2021. SPE ka pësuar ndryshime në funksionalitetin e tij për t’iu përshtatur kuadrin të ri ligjor dhe gjithashtu për të përmirësuar performancën e tij të përgjithshme. Ndërfaqja e SIFQ dhe SPE u krijua në vitin 2020 dhe kontrolli online i fondeve të disponueshme mund të kryhej përpara se të fillonte çdo procedurë prokurimi. Treguesi % në vlerë të procedurave të përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve për vitin 2021 ishte 60.2%, ka pasur një tendencë në rritje krahasuar me vitin 2020. Përsa i përket Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), masat ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë për të rritur pavarësinë e saj.

Për të përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe mundësinë për të përdorur informacionin në financat publike, u kryen përpjekje (i) për të fuqizuar sistemet dhe kapacitetet për të përgatitur statistika financiare të qeverisë nëpërputhje me standardet ndërkombëtare; (ii) Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të; (iii) për të ofruar mundësi formale për publikun për t’u angazhuar në procesin e buxhetit; dhe (iv) kalimin në një bazë të

përshkallëzuar për të paraqitur pasqyrat financiare të qeverisë mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.

Llogaridhënia dhe transparenca përmes raportimit të performancës financiare dhe jofinanciare është rritur gjatë vitit 2021 me 25,6 % në përputhje me objektivin e synuar, 10 nga 39 raportet monitoruese të paraqitura nga ML/IB kishin raportuar në përputhje me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIMFSH.

Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur të vitit 2017, që nga viti 2015 Shqipëria ka rritur (a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor të dhënë në Raportin e Auditimit dhe Pasqyrën e Para-Buxhetit, dhe (b) numrin e raporteve të publikuara të ekzekutimit të buxhetit. Gjithashtu, procedurat për zbatimin e buxhetit të “gjatëvitit” janë përmirësuar dhe për herë të parë në faqen e internetit të MFE-së¹⁵ në vitin 2017 u publikuan: Raporti i Mesit të Vitit i Performancës Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore të qeverisë. Shqipëria u përmirësua pak më tej në Anketën e Buxhetit të Hapur të 2019 pasi ka publikuar edhe Rishikimin e Mesvitit në internet. Modelet dhe përmbajtja e raporteve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe atij brenda vitit të qeverisë u rishikuan gjatë vitit 2019. Seancat në punë me menaxherët e programit dhe departamentet e financave të dy ML-ve me qëllim përmirësimin e modeleve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe brenda vitit u zhvilluan në vitin 2020. Për më tepër, SIMFSH është shpërndarë në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore dhe të dhënat përkatëse janë ngarkuar në sistem. Gjatë vitit 2021 është hartuar dhe zbatuar një model i ri për Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit, duke përfshirë TKP që janë të harmonizuara me SIMFSH dhe informacionet financiare. Formatet e reja të Udhëzuesit për anekset e monitorimit të buxhetit, që përfshijnë TKP-të, nuk janë hartuar sikurse planifikuar gjatë vitit 2021 për shkak të modulit MPPB me problemet në sistemit SIMFSH. Vlerësimi i fundit nga Indeksi i Buxhetit të Hapur (OBI) në ofrimin e mundësive formale për përfshirjen e publikut në procesin buxhetor është bërë në vitin 2019 dhe pjesëmarrja e publikut për Shqipërinë vlerësohet 7/100 pikë. Të njëjtat vlerësime mbeten për vitin 2020 dhe 2021. OBI është matësi i vetëm i pavarur dhe krahasues në botë i transparencës së buxhetit të qeverisë qendrore. OBI u cakton vendeve të mbuluara nga Anketa e Buxhetit të Hapur një rezultat transparence në një shkallë 100 pikësh duke përdorur 109 nga 140 pyetjet në Anketë. Këto pyetje fokusohen në mënyrë specifike nëse qeveria i ofron publikut qasje në kohë në informacionin gjithëpërfshirës të përmbajtur në tetë dokumente kyçe buxhetore në përputhje me standardet e praktikave të mira ndërkombëtare. MFE-ja është asistuar nga nisma BOOST, një mjet i Bankës Botërore që i jep akses në të dhënat e buxhetit dhe nxit përdorimin efektiv për procese të përmirësuara vendim-marrëse, transparencë dhe besueshmëri. Duke filluar që prej vitit 2015, Ligji Buxhetor Vjetor u formulua në një mënyrë më transparente dhe të kuptueshme dhe u publikua “Buxheti me një Vështrim” dhe një version i thjeshtësuar i “Buxheti i Qytetarëve”. Gjatë vitit 2020 u përgatit dhe u zbatua një kalendar me proceset kyçe të buxhetit. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021 u përpunua dhe u publikua një udhëzues për Buxhetin e Qytetarëve. U kryen gjithashtu trajnime (2019-2021) për OShC-të për të nxitur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin e buxhetit.

Udhëzuesi për Buxhetin për Qytetarët¹⁷ u publikua sikurse planifikuar. Qëllimi kryesor i udhëzuesit është të rrisë angazhimin e qytetarëve, OShC-ve dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e buxhetit të qeverisë. Objektivat e produktit “Një kalendar për dëgjuesat mbi buxhetin me proceset kyçe buxhetore është përgatitur dhe zbatuar” kanë patur progres gjatë vitit 2021. Në këtë aspekt në seancat dëgjimore buxhetore të organizuara gjatë korrikut 2021 ishin të pranishëm 17 OShC nga 26 të ftuar. Procesverbalet e sugjerimeve të OShC-ve janë mbajtur dhe janë publikuar si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm të fazës teknike. Gjithashtu, në vitin 2021 u zhvilluan një sërë seminaresh online për ngritjen e kapaciteteve me organizatat e shoqërisë civile. Trajnimet kishin për synim rritjen e kapaciteteve të OShC-

ve për të kuptuar buxhetin e shtetit dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për të luajtur një rol mbikëqyrës për financat publike. Seria e seminareve filloi me dy seminare të mbajtura përkatësisht në nëntor dhe dhjetor 2021. Seminari i parë u përqendrua në ciklin buxhetor dhe pikat hyrëse për advokimin e OShC-ve; ndërsa i dyti mbi fazat e ndryshme të kalendarit buxhetor dhe ofrimin e aftësive për vlerësimin e buxhetit sektorial për OShC-të. Seminaret u mbajtën në distancë, për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19 dhe niveli i pjesëmarrjes ishte i kënaqshëm (webinar-i i parë: 14 persona nga OShC(10) të ndryshmedhe MFE(4); webinar-i i dytë: 13 persona). Webinar-ët online mundësuan përfshirjen e një gamë më të gjerë OShC-sh.

Reforma në luftën kundër korrupsionit dhe planet e integritetit

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria shqiptare ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Gjatë kësaj periudhe janë shënuar arritje të mira në qasjen parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) për luftën kundër korrupsionit, nga ku mund të përmendim:

- MD ka kryer takime, ka koordinuar procesin e hartimit të Planeve të Integritetit në të gjitha ministritë e linjës, duke siguruar të gjithë mbështetjen për procesin e tyre. 6 ministri (MIE, MTM, MAS, MSHMS, MK, MEPJ) janë asistuar në këtë proces nga IDM Albania. MD ka asistuar direkt me ekspertizë teknike stafin e MFE dhe MBZHR.MM dhe MB janë asistuar ngamisioni Pameca (DCIF). Vlerësimi i riskut të integritetit u përfundua dhe të gjitha ministritë kanë miratuar Planet e Integritetit, për periudhën 2022-2025².

² https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2021/04/1.-Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-eDrejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023_AL.pdf, <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-I-INTEGRITETIT-I-MINISTRIS%C3%8B-S%C3%8B-BRENDISHME.pdf>; <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria-2/baza-ligjore/5478-ndertimi-i-integritetit>, <https://www.financa.gov.al/plani-i-integritetit/https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Planii-Integritetit-MBZHR.pdf>, <https://www.infrastruktura.gov.al/rregullore-5/>, <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/urdher-nr.-267-per-miratimin-e-planitte-integritetit-te-MSHMS-2022-2025.pdf>; <https://turizmi.gov.al/plani-i-integritetit-te-ministrise-se-turizmit-dhe-mjedisit/>; <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Urdher-214-Miratimi-i-Planit-te-Integritetit22-25.pdf>; <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/PI-e-Risqeve-MAS-26-04-22.pdf> dhe <https://www.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/PI-MEPJ-26-04.2022.pdf>

- Të gjitha këto ministri pas miratimit e kanë publikuar instrumentin e Planit të Integritetit, në web të tyre”.
- KDIMDHP ka monitoruar rregullisht ½ e autoriteteve publike me qëllim kontrollin mbi zbatueshmërinë e programeve të transparencës. 194 autoritete publike e kanë vendosur në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.
- AKSHI ka tejkaluar numrin e shërbimeve online të shtuara dhe në përdorim. Janë 1225 shërbime në shërbim të plotë të qytetarëve (nga 720 që është vlera e synuar për vitin 2022), duke e realizuar me 505 shërbime më shumë.
- Janë hartuar, miratuar, publikuar Planet e Integritetit në të gjitha ministrinë e linjës dhe Plani i ri Integritetit në Policinë e Shtetit.
- ILDKPKI ka vijuar me seancat e dedikuara të trajnimit në 15 institucione publike dhe ka trajnuar gjithsej 600 subjekte deklaruese (aktivitet i kryer para afatit të parashikimit). Ka filluar nga funksionimi i plotë dhe i rregullt deklarimi online i pasurive dhe aseteve të subjekteve që e kanë këtë detyrim.
- 15 bashki i janë shtuar autoriteteve të vetëqeverisjes vendore, që kanë miratuar planet e integritetit në këtë periudhë, përkatësisht: bashkitë Belsh, Përmet, Pogradec, Bulqizë, Tiranë, Berat, Kukës, Pukë, Himarë, Kavajë, Maliq, Shijak, Has, Roskovec, Lezhë.
- Nga hetimet dhe operacionet e përbashkëta ndërmjet strukturave vendore dhe qendrore, evidentohet hetimi/operacioni “Pika 2”, me anë të të cilit është finalizuar operacioni i kryer në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Agjencinë e Mbikqyrjes Policore (AMP), Departamentin e Policisë Kufitare e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në koordinim me Prokurorinë Speciale dhe Inspektoratin Policor (IPK) të Republikës së Kosovës.
- Ministria e Drejtësisë, ka zhvilluar 2 fushata publike ndërgjegjësimi për luftën kundër korrupsionit. Gjatë muajit mars 2022, në rrugët e kryeqytetit u shfaqën video antikorrupsion: Promovimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në të gjithë ekranet publike të vendosura në rrugët e Tiranës me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e “advokacisë” antikorrupsion për qytetarët që kërkojnë shërbime publike. Në ditën kombëtare të drejtësisë, datë 09.05.2022, u lancua fushatë ndërgjegjësimi kundër korrupsionit, në fasadën e Universitetit Politeknik Tiranë, video: antikorrupsioni, me mesazhe të drejtëpërdrejta dhe thirrje kundër korrupsionit, një bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.
- Ministria e Drejtësisë ka publikuar udhëzuesin “Antikorrupsioni”, një instrument ndërgjegjësimi dhe informimi i luftës kundër korrupsionit i përgatitur në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo qytetar shqiptar dhe të huaj. Botimi gjendet i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë link: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022/>
- Ministria e Drejtësisë ka filluar punën për hartimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2023-2030. Është hartuar drafti i parë i koncept-dokumentit të ri, vizioni i të cilit është “Institucione publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, dhe ofrojnë shërbime efçente ndaj qytetarëve”. Strategjia e re kundër korrupsionit do të ketë një qasje gjithëpërfshirëse (parandalim- mekanizma të ndëshkimit – ndërgjegjësim) dhe do të

konfirmojë bashkëpunime institucionale të fushës.

- Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, si struktura përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, ka zhvilluar një sërë hetimesh administrative pranë institucioneve të ndryshme, pjesë të rrjetit, kryesisht apo bazuar në ankesat dhe denoncimet e ardhura nga burime të ndryshme, ku sipas rastit në përfundim të hetimeve administrative të zhvilluara, janë propozuar në raportin përfundimtar marrja e masave administrative përkatëse kundrejt nëpunësve/punonjësve të këtyre institucioneve, ose sipas rastit janë paraqitur dhe kallëzime penale drejtuar/referuar organit të prokurorisë kompetente. Për periudhën janar - qershor 2022, rezultoi se janë paraqitur/referuar pranë organit të prokurorisë 8 kallëzime penale, për 22 persona (nëpunës/punonjës) + persona të tjerë të paidentifikuar.
- Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar 122 procedime me 103 të pandehur, prej të cilëve janë dërguar për gjykim 85 procedime me 92 të pandehur, që përbëjnë 69,67 % të procedimeve të regjistruara ose 89,32 % të pandehurve të regjistruar. Gjithashtu është rritur numri i hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 34 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën, Kjo përbën një rritje 78,94 % krahasuar me 6 mujorin e parë të vitit 2021, dhe përbën 27,68 % të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër penale. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 27 personave të dyshuar për kryerjen e këtyre veprave në kompetencë të prokurorisë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ose krahasuar me 6 mujorin e parë të 2021 një rritje me 3 herë të numrit personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar të dyshuar për këto grup-vepra.
- Sektori kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit ka evidentuar 531 vepra penale dhe zbuluar 503 të tilla, ose 94.72%, me 715 autorë të proceduar penalisht, nga të cilët arrestuar/ndaluar 128 autorë, 545 ndiqen në gjendje të lirë dhe janë shpallur në kërkim 42. Krahasuar me 6 - mujorin e parë të vitit 2021, gjatë 6 - mujorit të parë të vitit 2022, për VP korrupsion, janë evidentuar 119 vepra penale më shumë, janë zbuluar 121 VP më shumë, janë proceduar 136 autorë më shumë, janë arrestuar/ndaluar 15 autorë më shumë, janë proceduar në gjendje të lirë 114 autorë më shumë dhe ka patur 7 autorë me masa të tjera sigurimi më shumë, ka patur numër të njëjtë të autorëve të shpallur në kërkim. Në nivel të përgjithshëm është rritur fuqia zbuluese me 4.7%.

Reforma në drejtësi, fuqizimi i transparencës, efikasitetit dhe aksesit në drejtësi

Pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi është edhe rishikimi i procedurave para gjykatave, të cilat duhet të rishikohen për të pasur një sistem drejtësie më të aksesueshëm, transparent dhe efikas. Në këtë drejtim duhen marrë masa për rishikimin e dispozitave ligjore përkatëse në Kodin e Procedurës Civile,³ Ligjin “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”⁴, Kodin e Familjes apo ligjet për funksionimin e gjykatave.

³ Ligji nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 14.5.2021.

⁴ Ligji nr. 49/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare, datë 14.5.2021.

Më konkretisht, pas analizave të bëra dhe procesit të konsultimit, Kuvendi miratoi ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile dhe Ligjin për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Gjithashtu, KLGJ, ka miraturar 1 akt nënligjor mbi nëpunësit civil gjyqësorë, i cili rregullon pagesën e orëve shtesë.⁵

Një prej objektivave të rëndësishëm të reformës është të sigurojë qasje efikase në drejtësi përmes ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave të përshtatshme gjyqësore.

Vetëm në gjashtë-mujorin e parë 2022 4311 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti dhe 742 persona kanë përfituar ndihmë juridike dytësore të garantuar nga shteti.

Disa nga arritjet kryesore të reformës specifikisht, si më poshtë:

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për 6 mujorin e parë 2022, raporton se 19 vendime konfirmim në detyrë të 19 subjekteve të rivlerësimit kalimtar; 23 vendime shkarkim nga detyra të 23 subjekteve; 5 ndërprerje të procesit për shkak të doreheqjes, sipas nenit G të Aneksit kushtetues; 4 vendime përfundim procesi pa vendim përfundimtar, për 4 subjekte që u ka mbaruar statusi i magjistratit; 2 vendime për pezullimin nga detyra për 2 prokurorë dhe detyrimin për të ndjekur 1 vit ShM.
- Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur për periudhën janar-qershor 2022, 23 vendime duke vendosur: lënien në fuqi të vendimit të KPK - në 17 vendime; ndryshimin e vendimit të KPK, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit-në 3 vendime; ndryshimin e vendimit të KPK, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit- në 3 vendime. Sa i përket denoncimeve nga publiku, gjatë periudhës kohore janar-qershor 2022, në KPA janë regjistruar dhe trajtuar 85 denoncime.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Është miraturar me Vendimin nr. 95, datë 09.05.2022, Rregullorja për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve. Me vendimin nr. 140 datë 06.06.2022, është miraturar programi që përcakton listën e prokurorëve për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional për vitin 2022. Me vendimin nr. 141, datë 06.06.2022, është miraturar planifikimi 3-mujor i vlerësimit etik dhe profesional i prokurorëve. Me vendimin nr. 142, datë 08.06.2022, janë caktuar relatorët dhe këshilltarët përgjegjës për procedurën e vlerësimit.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në përmbushje të kompetencave në kuadër të shqyrtimit, verifikimit dhe hetimit disiplinor, për periudhën Janar-Qershor 2022, rezultojnë të dhënat: Për periudhën janar-qershor 2022, rezultojnë të dhënat si më poshtë: 435 ankesa të reja të depozituara pranë Zyrës së ILD-së; Ankesa të trajtuara sipas fazës së shqyrtimit të tyre 906 ankesa të trajtuara në total, nga të cilat: -694 ankesa të trajtuara me 476 vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar; -211 ankesa të trajtuara me 156 vendime për arkivimin pas verifikimit; -1 kërkesë për procedim disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për sa i përket hartimit të urdhra të përgjithshëm me natyrë administrative ose procedurale për mbarëvajtjen dhe metodën e punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë periudhës Janar-Qershor 2022, ka miraturar 5 urdhra, të cilat lidhen me zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit dhe Planit Strategjik të Zyrës së ILD-së, si dhe lidhur me programin për

⁵Vendimi i KLGJ nr. 48 datë 08.02.2022

informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Me Vendimet nr. 103-124, të datës 19.05.2022 të KLP, është përfunduar verifikimi i pasurisë dhe figurës për 22 magistratë prokurorë.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Janë diplomuar 24 magistratë të rinj dhe janë emëruar 23 magistratë të profilit Gjyqtar. Janë transferuar/deleguar një gjyqtar në gjykatën e apelit Gjirokastër dhe janë promovuar 6 gjyqtar në Gykatën e Lartë 9 gjyqtar në juridiksion apeli dhe 3 në Gykatat e posaçme.
- Gjykata Kushtetuese. Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pasi u njoh me listën e kandidatëve të renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procesit të votimit, vendosi të shpall fitues me 7 (shtatë) vota pro.
- Shkolla e Magistraturës. ShM ndërroi një proces të gjatë analize të metodologjisë të trajnimeve, përfshirë procesin e analizës së nevojave dhe atë të realizimit të aktiviteteve trajnuese. Metodologjitë e Shkollave të Magistraturës homologe janë marrë në konsideratë dhe aplikohen gjatë mbajtjes së aktiviteteve trajnuese të caktuara në Pasqyrën e Kurseve për vitin akademik. · Prokuroria e Përgjithshme. Në 6 mujorin janar-qershor 2022 janë emëruar 21 opgj në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas procedurave të përcaktuara në ligji nr.25/2019 “Për policinë gjyqësore”. Sipas parashikimeve ligjore këta opgj para fillimit të detyrës i janë nënshtruar trajnimit profesional. Gjithashtu bazuar në nevojat e prokurorive, janë kryer ndërhyrje strukturore pasqyruar në urdhërat nr. 6 dhe nr.7, datë 28.01.2022 të Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, gjatë periudhës janar-qershor 2022 ka vijuar pjesmarrja në trajnimin vazhdues nga ana e prokurorëve sipas detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në RSH", si dhe ka filluar trajnimi i 21 opgj të emëruar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
- Shërbimi i Provës. Është miratuar Urdhri i Ministrisë të Drejtësisë nr. 80, datë 22.02.2022 "Për miratimin e Programit Fillestar dhe Vazhdues të Specialistëve të Shërbimit të Provës". Në përmbushje të rolit aktiv që ka Shërbimi i Provës gjatë fazës së ekzekutimit të dënimeve alternative, ka nënshkruar 10 marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht me: Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Shoqatën Community Aid, Shoqatën Antigonea, Bashkinë Vorë, Bashkinë Maliq, Bashkinë Prrenjës, Bashkinë Lezhë, Bashkinë Klos dhe Bashkinë Kamëz. Gjithashtu, është miratuar Urdhri nr. 196, datë 06.05.2022 i Ministrisë të Drejtësisë “Për përcaktimin e procedurave të bashkëpunimit për mbikqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Është në proces miratimi marrëveshja ndër-institucionale që do të sigurojë infrastrukturën e duhur për rritjen e numrit të IEVP-ve ku do të implementohet arsimimi dhe formimi profesional. Viti akademik 2021-2022 ka patur një zgjerim të këtij shërbimi në institucionet, pritet të zgjerohet dhe më tej, në varësi të ecurisë së bashkëpunimit me aktorët e tjerë të përfshirë në proces.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Më datë 22.04.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u lançua sistemi i ri dhe inovativ online, i cili synon të mbledhë komentet e avokatëve, prokurorëve, ekspertëve, dëshmitarëve dhe palëve në një çështje gjyqësore, si dhe përdoruesve të shërbimeve administrative, me qëllim përmirësimin e shërbimit të drejtësisë. KLGJ është në fazën e prokurimit të ngritjes së infrastrukturës mbështetëse për sistemin e ri ICMIS në zbatim të vendimit nr. 7, dt. 26.07.2022 të QTI.

- Ministria e Drejtësisë. Përgjatë periudhës janar-qershor 2022 janë kryer 25 Inspektive të përgjithshme, 5 Hetime disiplinore iniciuar bazë ankesash, 11 Raporte të përfunduara, 19 në proces shqyrtimi. Gjithashtu, 9 Inspektive/hetime disiplinore për përmbaues, 3 Raporte të përfunduara, 6 në proces hetimi.

Reforma në transformimin digjital & Open Data

Qytetarët marrin nëpërmjet e-Albania çdo dokument shtetëror, nga certifikatat personale e deri te certifikatat e pronësisë, mund të paguajnë faturat mujore, shërbimet shëndetësore, të marrin certifikatat e gjykatës, certifikatat e sigurimit dhe çdo shërbim tjetër utilitar. Një qytetar i thjeshtë nuk ka më nevojë të shkojë në zyrat e shtetit për problemet e tij.

Portali qeveritar e-Albania është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway - GG), e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronike me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, duke garantuar shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike. 58 sisteme elektronike janë të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprueshmërisë dhe shkëmbejnë të dhëna në kohë reale, krahasuar me 55 sisteme elektronike të administratës publike në fund të vitit 2021.

Nga data 1 maj 2022, shërbimi i administratës publike ndaj qytetarëve dhe biznesit ndryshoi si më poshtë:

- Për të gjitha shërbimet publike, aplikimet e të cilave dorëzohen në e-Albania, përgjigja merret në mënyrë elektronike nga institucioni që ofron shërbime, e vulosur ose e nënshkruar në mënyrë elektronike;
- Çdo shërbim dhe përgjigje e administratës monitorohet në kohë reale;
- Tavolinat e pritjes janë eliminuar pothuajse plotësisht.

Statistikat për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 janë paraqitur më poshtë.

- Numri i dokumenteve të vulosura elektronike të shkarkuara në janar - dhjetor 2022: 6,599,243 (krahasuar me 2,459,740 në të njëjtën periudhë të një viti më parë)
- Numri i përdoruesve të regjistruar në janar - dhjetor 2022: 428,543 (krahasuar me 628,296 në të njëjtën periudhë të një viti më parë).
- Aktualisht, në portalin e-Albania janë më shumë se 2,800,000 përdorues të regjistruar.
- Numri i përdorimit të shërbimeve elektronike në janar - dhjetor 2022: 15,847,288 (krahasuar me 12,612,356 në të njëjtën periudhë të një viti më parë)
- Numri i dokumenteve të nënshkruara elektronike të shkëmbyera ndërmjet punonjësve të administratës publike në emër të qytetarëve gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 (nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve të Nënshkruara elektronike, siç shpjegohet në raportin e mëparshëm): 48,681
- Numri i përgjithshëm i dokumenteve të shkarkuara të e-vulosura që nga zbatimi i tij në shtator 2017 deri në dhjetor 2022 është mbi 23 milionë.

Ndikimi vihet re drejtpërdrejt në uljen e ndjeshme të radhëve në sportelet fizike të institucioneve publike, të cilat po shtypin më pak dokumente në kopje fizike ose po ndjekin praktikën e ofrimit të shërbimeve të tyre vetëm online nëpërmjet portalit e-Albania:

- Numri i certifikatave të gjendjes civile të vulosura elektronike të shkarkuara gjatë vitit 2022 u ka kursyer qytetarëve më shumë se 3,000,000 EUR ose më shumë se 10,000,000 EUR në total (shtator 2017 – dhjetor 2022). Një certifikatë e marrë në kopje fizike në sportel kushton 50 lekë (0.39 euro), ndërkohë online është pa pagesë;

Vlerat i referohen shifrave:

- Mbi 23 milionë certifikata të gjeneruara në total (aplikim qytetar në portalin e-Albnaia + shkarkime nga moduli i administratës publike në emër të qytetarëve)
- Mbi 7.7 milionë certifikata të gjeneruara në total për vitin 2022 (6.6 portal + 1.1 modul)
- Sigurimi i dokumenteve me vulë elektronike i ka shpëtuar qytetarëve dhe bizneseve më shumë se 600 vite pritje në radhë.
- Dhënia online dhe falas e “Certifikatës së gjendjes gjyqësore”, e cila dëshmon nëse një person ka qenë ndonjëherë i dënuar apo jo, i ka kursyer qytetarëve 270,000 euro në vitin 2022; 79,129 aplikime për vitin 2022
- Dy vërtetime nga Drejtoritë e Shërbimeve të Transportit Rrugor: një për statusin e mjetit dhe tjetri për drejtuesit e mjeteve që kërkojnë dokument dëshmitar për leje drejtimi, të cilat tashmë ofrohen në kohë reale si dokumente të vulosura elektronike dhe pa pagesë.

Shërbimet elektronike të zbatuara gjatë vitit 2022

- Policia e Shtetit gjatë këtij viti ka vënë në zbatim shërbimin për qytetarët që kanë humbur dokumente të ndryshme dhe mund të deklarojnë humbjen e dokumenteve online.
- Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ofron tashmë shërbim online për dokumentet arkivore gjyqësore dhe hetimore.
- Vërtetimi i pagës, shërbim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është një shërbim lehtësues për çdo punonjës dhe të vetëpunësuar që mund të pajiset në kohë reale me këtë lloj vërtetimi me vulë elektronike. Dokumenti vjen në ndihmë në procedura të ndryshme, si në sektorin privat ashtu edhe në administratën shtetërore dhe ndihmon në uljen e informalitetit (në sektorin privat).
- Dy shërbime për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve janë publikuar këtë vit, me qëllim përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse për subjektet aplikuese.
- Gjatë këtij viti, Universiteti i Tiranës ofroi, nëpërmjet e-Albania, për të gjithë studentët që kanë ndjekur ose aktualisht janë duke studiuar, marrjen e certifikatës së diplomimit dhe listës së notave me vulë elektronike, duke shmangur radhët në zyrën e sekretarisë së universitetit dhe vonesat. për studentët që ishin të interesuar për këto dokumente.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofron tashmë shërbime elektronike për verifikimin në kohë reale të statuseve të deklaratave doganore të mallrave dhe pagesave.
- Drejtoria e Përgjithshme Detare ka shtuar shërbime të reja lidhur me certifikimin e anijeve të ndryshme të aplikantëve, të cilët tashmë ndjekin të gjithë procesin e aplikimit dhe certifikimit online.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nëpërmjet shërbimit të saj të ri “Aplikim për programin e formimit profesional për institucionet publike apo private” synon të promovojë kualifikimin dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore në fushat e programimit dhe TIK-ut, nëpërmjet zgjerimit të gamës së këtyre. kurse kualifikimi me përfshirjen e sektorit privat. Për kategori të ndryshme studentësh që aplikojnë për të marrë pjesë në kurset e ofruara nga sektori privat, ofrohet mbështetje financiare nga shteti.

Open Data

Një portal i hapur i të dhënave është një ndërfaqe e bazuar në ueb që i mundëson kujtdo të aksesojë, të përdorë dhe të rishpërndajë të dhënat e ngarkuara në të. Portalet e të dhënave të hapura publikojnë të dhëna që kanë karakteristikat teknike dhe ligjore që lejojnë qytetarët, bizneset, organizatat joqeveritare, organizatat e shoqërisë civile, studiuesit dhe gazetarët të kenë akses në grupet e të dhënave dhe të dhënave të grupeve të të dhënave, kryesisht në formën e të dhënave numerike për t'u përdorur lirisht.

Portali i të dhënave të hapura në Shqipëri (<https://opendata.gov.al/>) ofron aktualisht të dhëna të hapura nga disa sektorë – për shembull: shëndetësia, thesari, doganat, arsimit, biznesi – etj. Ky angazhim do të përmirësojë shkallën e vëllimit dhe cilësisë së të dhënave të hapura të disponueshme në portalin e të dhënave të hapura të qeverisë. Disa organe publike janë të angazhuar në mënyrë aktive me iniciativën, por kërkohet më shumë angazhim për të sjellë organe të tjera publike në bord për t'i vënë të dhënat e tyre të disponueshme si të dhëna të hapura. Kërkohet gjithashtu promovim më i madh i portalit në mesin e përdoruesve të mundshëm. Ky angazhim do të vërë në dispozicion të dhëna të reja nga institucione publike shtesë, si dhe do të zhvillojë strategji për të përmirësuar kuptimin e qytetarëve për përdorimin dhe aplikimin e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe për të rritur aksesin për qytetarët.

Aktualisht, portali ofron më shumë se 91 grupe të dhënash në fushat e shëndetësisë, thesarit, buxhetit, doganave, arsimit, biznesit dhe shumë më tepër.

- Ministrinë dhe institucionet që kanë publikuar informacione në portal janë:
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Evropës dhe e Punëve të Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Qendra Kombëtare e Biznesit

PROCESI PER PERGATITJEN E PLANIT KOMBETAR OGP 2023-2025

Gjatë ciklit të Planit të V-të të Veprimit, Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (MPR) hartoi raportin e vlerësimit dhe nënvizoi se 'megjithatë, qeveria vazhdoi të vepronte në kundërshtim me procesin e OGP-së ndërkohë që zhvilloi planin e veprimit pa një forum shumëpalësh. Duhet të krijohet, pa vonesë, një forum i përkushtuar shumëpalësh për të monitoruar zbatimin e planit aktual dhe për të zhvilluar plane të veprimit në të ardhmen që marrin në konsideratë përparësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile, (reference faqe 2).

Në këtë kuadër, Qeveria e Shqipërisë është mobilizuar në bazë të këtij rekomandimi dhe ka ngritur Komitetin Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisje të Hapur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur", të cilat janë ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022.

Urdhri i Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022 synon të kontribuojë në një zbatim më efektiv të standardeve të Qeverisjes së Hapur brenda anëtarësimit të Qeverisë Shqiptare në Nismën Globale të "Partneritetit të Qeverisjes së Hapur" (OGP).

Komiteti është një organ konsultativ për përmbushjen e detyrimeve për qeverisjen e hapur në emër të Qeverisë Shqiptare. Krijimi i këtij Komiteti vjen në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Shqipërisë si vend anëtar me të drejta të plota në Iniciativën Globale për Qeverisje të Hapur (OGP). Zbatimi i detyrimeve si vend anëtar bën të domosdoshëm krijimin dhe funksionimin e Komitetit, i cili do të përmbushë detyrimin për të bashkërenduar një proces kombëtar për miratimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur dhe monitorimin periodik të tij. Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore marrin masa për të ndjekur objektivat e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur, zbatimin dhe monitorimin e tij, në përputhje me standardet e Iniciativës Globale për Qeverisjen e Hapur.

Komiteti bashkë-kryesohet nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimit dhe nga përfaqësues të anëtarëve të organizatave jofitimprurëse. Detyrat e Komitetit lidhen me:

- Të rishikojë dhe promovojë zbatimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur, si dhe të sigurojë orientimin për zbatimin dhe raportimin e institucioneve për ecurinë e tij;
- Ju inkurajojmë koordinimin në nivelin më të lartë të institucioneve, me qëllim orientimin dhe udhëheqjen e punës për zbatimin e politikave dhe masave për arritjen e angazhimeve të qeverisjes së hapur.
- Të inkurajojë dialogun në kuadër të politikave dhe ndërmjet tyre, në zbatimin e qeverisjes së hapur.
- Të shqyrtohen raportet e vetëvlerësimit të përmbushjes së masave për vendin, të përgatitura nga sekretariati, si dhe të japin rekomandime për përmirësim.
- Shqyrton raportet e vlerësimit nga mekanizmi i pavarur i qeverisjes së hapur për vendin.
- Të rekomandojë masat e nevojshme ligjore, si dhe të orientojë punën organizative për nisma ligjore për arritjen e angazhimeve.

- Promovimi i planifikimit për financimin e masave nëpërmjet programimit buxhetor afatmesëm, bashkëpunimit me partnerët e zhvillimit, nëpërmjet sistemit të planifikimit të integruar (SPI).

- Nxitja e dialogut ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të pavarura,

organeve të vetëqeverisjes vendore, partnerëve për zhvillim, shoqërisë civile, për zbatimin e masave, si dhe nxitja e nismave të veprimeve të koordinuara në këtë kuadër.

- Ofron mbështetje teknike për aktivitetet e Komitetit Shumëpalësh RRETH Partneritetit për Qeverisje për t'u hapur në përgjithësi, si dhe në veçanti për procesin e 'bashkëpunimit', në përputhje me standardet për pjesëmarrje në Iniciativën OGP;
- Siguron organizimin e takimeve dhe temën e çështjes për diskutim, të përgatitur në bashkëpunim me ministritë dhe aktorët e tjerë, pranë Komitetit;
- Koordinon procesin teknik dhe orientimin metodologjik të institucioneve në nivel teknik për përgatitjen e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur;
- Koordinon procesin teknik me institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatimit dhe përgatitjen e raporteve të vlerësimit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur nga institucionet në ngarkim të tyre;
- Siguron bashkërendimin e punës me institucionet për hartimin dhe shqyrtimin teknik të raporteve të vlerësimit nga mekanizmi i pavarur i Qeverisjes së Hapur për vendin, si dhe i paraqet Komisionit informacionin përkatës me rekomandime;
- Koordinon punën për përgatitjen e nismave të nevojshme ligjore, si dhe masat lidhur me planifikimin për financimin në programin buxhetor afatmesëm;
- Koordinon punën ndërmjet Komisionit, institucioneve publike dhe partnerëve për zhvillim, si dhe partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë të interesuar;
- Siguron drejtimin metodologjik dhe teknik të punës, për përgatitjen e instrumenteve teknike efektive për arritjen e angazhimeve në Planin Kombëtar;

Komiteti Shumëpalësh përbëhet nga anëtarët e parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145 datë 20.12.2021 ndryshuar me Urdhrin nr. 177, datë 28.10.2022 dhe bashkëdrejtohet në rolet e bashkëkryesuesve nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimit, si dhe nga një përfaqësues i zgjedhur nga radhët e anëtarëve të shoqërisë civile në Komitet, i cili përcaktohet nga anëtarë të vetë shoqërisë civile dhe komunikohet në mbledhjen e parë të Komisionit, në zbatim të ligjit nr.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile KKSHC”.

Në këtë kuadër Komiteti OGP zhvilloi mbledhjen e parë më 11.11.2022 ku në një prej pikave të Konkluzioneve Operacionale⁶ ishte dërgimi i paketës metodologjike/kalendarin e punës tek të gjithë institucionet për inicimin e procesit të hartimit të Planit Kombëtar OGP 2023-2025 dhe caktimin e pikave të kontaktit për OGP-në në cdo institucion.

Në këtë kuadër Koordinatorja Politike OGP dërgoi shkresën drejtuar gjithë institucioneve për incimin e punës për hartimin e Planit Kombëtar OGP në përputhje me standartet OGP⁷.

Plani i punës parashikon tre komponentë kryesorë (i) planifikimin (ii) bashkë-bërjen (iii) hartimin e planit. Si një komponent të integruar parashikohej dhe ndërgjegjësimi i publikut të gjërë lidhur me takime publike dhe audiencë me qëllim ndërveprim dhe sinergjizim të aktiviteteve. Për më tepër të referohet tek plani i punës por dhe të gjitha informacionet e publikuara për të gjitha fazat në faqen e dedikuar OGP⁸.

Në fazën e bashkë-bërjes u publikuan 6 anketime tematike dhe 1 anketë kombëtare si dhe u

⁶ https://ogp.gov.al/uploads/2022/12/Konkluzione_Operacionale_%20Takimi%201_11.11.2022.pdf

⁷ <https://ogp.gov.al/uploads/2022/12/Scan-28-Dec-22-17-24-05.pdf>

⁸ <https://ogp.gov.al/faqe/procesi-i-bashke-krijimit>

zhvilluan me shoqërinë civile dhe grupet e interesit rreth 7 takime tematike. Për më tepër referencë raportit feedback-co-creation/Co-creation Feedback Report⁹.

Në mbledhjen e tretë të Komitetit OGP në përputhje me konkluzionet operacionale¹⁰ anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin sipas diskutimeve dhe në përputhje me procedurat paketa dhe dokumenti i prioriteteve publikohet në faqen OGP¹¹.

Në fazën e tretë u zhvilluan rreth 7 takime konsultative me shoqërinë civile me raporte të dedikuara ku u konsolidua paketa e Planit Kombëtar 2023-2025, në përputhje me të gjitha hapat e parashikuara në plani i punës/kalendari si dhe të publikuara në faqen OGP.

Në përputhje me Ligjin Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” paketa u konsultua dhe në regjistrin elektronik për konsultimin publik për periudhën e parashikuar 6.03.2023 deri më 20.03.2023 si dhe u miratua në Komitetin OGP sipas parashikimeve të bëra në planin e punës.

FUSHAT QË PËRFSHIHEN ANGAZHIMET

⁹<https://ogp.gov.al/uploads/2023/1/7.%20Raporti%20i%20dokumentit%20të%20prioriteteve%20të%20identifikuara%20në%20kuadër%20të%20procesit%20të%20bashkëbërjes%20co-creation.pdf>

¹⁰<https://ogp.gov.al/uploads/2023/1/5.%20Konkluzione%20Operacionale%20mbledhje%20e%20Komitetit%20Shumëpalësh%20të%20OGP%20datë%2009.02.2023.pdf>

¹¹<https://ogp.gov.al/uploads/2023/1/6.%20Dokumenti%20i%20prioriteteve%20të%20identifikuara%20në%20kuadër%20të%20procesit%20të%20bashkëbërjesco-creation.pdf>

Plani Kombëtar i Veprimit 2023-25 për zbatimin e Partneritetit të Qeverisjes së Hapur synon të zhvillojë angazhime të reja në fusha të tilla si:

- antikorrupsioni & pronarët përfitues ;
- aksesimi në drejtësi;
- transformimi digjital dhe inovacioni;
- transparenca fiskale;
- shërbimet publike
- gjithpërfshirja
- e drejta në informim, konsultim dhe ndikim rregullator
- parlamenti i hapur

ANGAZHIM 1 FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI

ANGAZHIM 1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.

1.Pjesa hyrëse për angazhimin: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.*

Lufta kundër korrupsionit është një ndër politikat më prioritare, dhe për të cilën Shqipëria këshillohet t'ë ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë përbëjnë ana tjetër një shtyllë të rëndësishme dhe nga ku gjenerohen ndërhyrje dhe propozime konkrete të fushës që qëndrojnë në bazë të nismave qeveritare, po jo vetëm.

Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (SNKK), që prej vitit 2015, me afat përfundimtar vitin 2023. Deri më tani janë hartuar dhe zbatuar tre plane konkrete veprimi, mbështetur në masa dhe aktivitete që bashkojnë institucione publike (qeveritare dhe të pavarura), autoritete jashtë qeverisë por edhe partnerë të huaj që bashkërendojnë nismat dhe veprimtaritë e tyre kundër korrupsionit.

Që nga miratimi i SNKK në vitin 2015, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash që synojnë rritjen e aftësisë së vendit për të parandaluar, frenuar e reduktuar korrupsionin. Një numër i madh i këtyre reformave janë zbatuar dhe kanë dhënë rezultate konkrete përgjatë kohës së zbatimit.

Gjithashtu, SNKK përbën një dokument me tre qëllime politike (parandalim –ndëshkim-ndërgjegjësim) dhe i mbështetur në 18 objektive specifike. SNKK jep një qasje horizontale të luftës kundër korrupsionit e cila përfshin sektorë si transparenca, prokurimet publike, shërbimet elektronike, inspektimet dhe kontrollet financiare në administratën publikë, integriteti i autoriteteve publikë qendrore dhe vendore - (parandalimi); bashkëpunimi dhe rritja e hetimeve penale si dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar - (ndëshkimi) si edhe planifikimi dhe ndëveprimi e masave me efekte ndërgjegjësuëse dhe të komunikimit kundër korrupsionit, ndërveprimet me organizatat e shoqërisë civile dhe mjetet e denoncimit publik kundër korrupsionit - (ndërgjegjësimi).

Nga ana tjetër, angazhimet e qeverisë në luftën kundër korrupsionit janë inkorporuar edhe si pjesë përbërëse e Partneritetit për Qeverisje të Hapur, kjo nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive në promovim të transparencës, fuqizimit të qytetarëve dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes dhe pjesë e së cilës Shqipëria merr përsipër zbatimin prej vitit 2011.

Plani i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2023-25, është plani i 6-të kombëtar dhe komponent me rëndësi i së cilit vijojnë të mbeten çështje të integritetit, luftës kundër korrupsionit e të pronarëve përfitues në zbatim të fushë 1 të OGP. Ministria e Drejtësisë konfirmon

përgjegjësinë funksionale dhe operacionale për tu përfshirë në këtë plan me angazhimin: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.*

Angazhimi prioritar ka në përbërje të tij 3 (tre) masa prioritare, si përmenden:

1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit
2. Edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i administratës publike mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit, dhe për të cilat janë bashkë-hartuar masat dhe aktivitete për ndjekje dhe zbatim nga autoritete publike (qeveria), nga OSHC por edhe në bashkë-rendim dhe zbatim të qeverisë dhe të OSHC-ve.

Plani i veprimit për këtë angazhim prioritar ka në përbërje të tij 17 masa/aktivitete, 9 prej tyre me udhëheqës MD dhe 8 me udhëheqës OSHC-të si konkretisht: IDM dhe ALTRI edhesi propozuese kryesuese, dhe për të cilat parashikohen marrja e produkteve konkrete, të matshme për periudhën e zbatimit, vitet 2023 – 2024 - 2025.

1. Progresi i qeverisjes së hapur

Që nga viti 2017, Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit është institucion lidernëhartimin e politikave dhe përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e antikorrupsionit. Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë udhëheq angazhimin ndërinstucional për të siguruar një performancë dhe kulturë më të lartë në luftën kundër korrupsionit në sektorët më të prekshëm dhe të ndjeshëm ndaj korrupsionit në mënyrë që të sigurojë një administratë publike të paanshme, të ndershme dhe efikase me nëpunës civilë dhe zyrtarë të tjerë publikë me vlera, parime dhe integritet të lartë.

Angazhimi në zhvillimin e instrumenteve të denoncimit kundër korrupsionit, angazhimi në krijimin dhe zbatimin e instrumenteve të integritetit në institucionet qendrore dhe varësitë e tyre dhe të tjera nisma me efekte parandalimi kanë qënë pjesë e planeve të veprimit për partneritet për qeverisje të hapur, ardhur këto si nisma të bashkë-propozuara dhe bashkë-zbatuara me njësi jashtë qeverisë.

Vendosja dhe aplikimi i një angazhimi të tillë siç është: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit*, përforcon njëkohësisht parimin e zbatimit të qeverisjes së hapur dhe konfirmon vullnetin që qeveria dhe OSHC së bashku me grupet e interesit janë një dhe të pandara në këtë priritet, edhe për vitet e zbatimit të këtij plani veprimi.

3. Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me rregulloren e OGP, dhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 “Për ngritjen dhe Funkcionimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisjen e Hapur”, ka inicuar, kryer dhe përfunduar procesin e hartimit të Planit të Veprimit Për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023 – 2025, për fushën 1: Antikorrupsioni & integriteti dhe pronarët përftues, me një angazhim prioritar direkt me titull: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.*

Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit është zhvilluar sipas këtyre fazave dhe në përputhje me afatet e kalendarit të propozuar dhe të miratuar nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

1- Propozimi dhe kërkesa për propozime e angazhimeve prioritare:

Në funksion të përcaktimit të qëllimit primar të politikës për institucionin dhe fushën e veprimit u hartua dhe u shpërndapër plotësim dhe miratim nëpërmjet konsultimit publik pyetësori–sondazh (anketa) për përcaktimin e angazhimeve prioritare të Ministrisë së Drejtësisë në PKV 2023-25 (dhjetor 2022). Pyetësori kërkonte kontributin konkret mbi rolin dhe përfshirjen e OSHC-ve dhe të grupeve të interesit. Pyetësori (anketa) u shpërnda via email, u publikua në faqen e internetit të OGP Albania dhe gjithashtu të Ministrisë së Drejtësisë. Për këtë qëllim u hartua edhe një raport konsultimi.

Kjo fazë u shoqërua e komunikime të shtuara me OSHC dhe grupet e interesit via email, telefon dhe webite të Ministrisë së Drejtësisë si dhe të OGP Albania.

2- Hartimi i angazhimeve prioritare/ konsultimi dhe dakordësimi i tyre:

Rezultatet dhe kontributet e marra në përfundim të afatit për plotësim të sondazhit (anketës) u diskutuan dhe dakordësuan me zhvillimin e dy takimeve (12 dhe 17 janar 2023) të cilat konfirmuan përfshirjen e grupeve të interesit, organizatave të shoqërisë civile, akademisë, ministrive të linjës si dhe çdo të interesuari në hartimin dhe konsolidimin e komponentëve të planit kombëtar të OGP, për angazhimin: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.*

Paketa e plotë e raportimit të kësaj faze (pyetësori - raportet e konsultimit, agjendat e takimeve - takimet e zhvilluara dhe angazhimet prioritare të propozuara) janë dorëzuar pranë sekretariatit teknik të Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

3- Hartimi, konsultimi dhe dakordësimi i masave/produkteve të PV për angazhimin:

Ministria e Drejtësisë, si institucion udhëheqës i angazhimit prioritar: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit*, dhe pas marrjes së miratimit në takimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur (9 shkurt 2023) me pjesëmarrjen e Zv.Ministrit të Drejtësisë (anëtar i Komitetit), u vijua me procesin e krijimit,

hartimit dhe daakordësimin e masave/aktiviteteve dhe të produkteve konkrete të angazhimit të ndërmarrë.

MD përgatiti njëdraft-plan veprimi, sipas formatit të dërguar nga sekretariati teknik pranë Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, dhe ka zhvilluar dy takime(21 dhe 24 shkurt 2023) me grupet e interesit dhe OSHC-të mbi propozimet dhe angazhimin e tyre në masa specifike në bashkë-bërjen e planit të veprimit.

Drafti dërguar nga MD fillimisht përmbante masat e propozuara nga qeveria, me afatet e zbatimit. Në takimin e datës 21 shkurt 2023, drafti u shtua edhe me propozime të OSHC-ve, të cilat u dakordësuan në takimin e datës 24 shkurt 2023. Kjo fazë e procesit ka përdorur mjete të komunikimi si, via email, telefon, website, si edhe përdorimin e mjeteve komunikuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në MD(Twitter; LinkedIn; Facebook), shoqëruar me postera informimi publikë.

Paketa e plotë e raportimit të kësaj faze (drafti i planit të veprimit - raportet e konsultimit, agjendat e takimeve - takimet e zhvilluara janë dorëzuar pranë sekretariatit teknik të Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

4. Angazhimi

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit

ANGAZHIM 1
FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

ANGAZHIMI 1: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Lufta kundër korrupsionit, është një ndër politikat më prioritare, të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi. E ndërsa parandalimi dhe ndëshkimi lidhur me luftën antikorrupsion është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj por me rëndës strategjike paraqitet edhe ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi e tij për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit.</p> <p>Ministria e Drejtësisë në ushtrim të rolit të saj të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ndërmerr përgjegjësinë të krijojë, udhëheqë zbatimin, koordinojë dhe lehtësojë masa dhe aktivitete së bashku me OSHC dhe grupe interesi për të rritur dhe siguruar angazhimin: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.</p> <p>Masa dhe aktivitete specifike janë planifikuar për zbatim, me vehte dhe në bashkë-zbatim MD/KKKK dhe IDM e ALTRI dhe me një përfshirje të posaçme të strukturave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektori Privat, etj)

	<ul style="list-style-type: none"> • MD/KKKK • MAS • AMSHC • QBZ • MFE • MM • MB • KLP • ILDPKI • Avokati Popullit • DNJF 	<p>OSHC të vendit që operojnë në fushën e AK:</p> <ul style="list-style-type: none"> • IDM • ALTRI 	<p>Partnerë të huaj në fushën antikorrupsion:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Delegacioni i BE, Tiranë • Ambasada Italiane, Tiranë
Periudha e implementimit	2023 -2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Angazhimi prioritar: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit*, adreson rekomandimet e dhëna qeverisë shqiptare për të rritur impaktin e luftës kundër korrupsionit, përfshirjen dhe bashkërendimin e veprimeve kundër korrupsionit, ndërmarrjen e veprimeve që do të përmirësojnë perceptimin e publikut dhe të grupeve të interesit (OSHC-media-akademi, partnerë të tjerë) kundër korrupsionit.

Shtylla e tretë e SNKK 2015-2023, sondazhe për matjen e besimit në institucionet publike të vendit, numri i raportimeve të korrupsionit nga qytetarët, dëshmojnë se Shqipëria duhet të bëjë përpjekje për rritjen e besimit të shoqërisë duke u fokusuar në promovimin e mekanizmave që aktualisht ekzistojnë por edhe të tjera si këtp.

Në kuadër të hartimit të politikave kundër korrupsionit dhe integritetit, institucionet publike, në bashkëpunim me median dhe OSHC-të duhet t'i kushtojnë vëmendje të shtuar transparencës dhe dokumentave politikë të prodhuar, me qëllim analizimin e tyre nga të gjitha grupet e interesit.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Mungesa e besimit në institucionet publike, mangësitë kulturore e antikorrupsionit në shoqëri apo mosreagimi i institucioneve publike, janë disa nga faktorët që ndikojnë në situatën aktuale të luftës kundër korrupsionit.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ndërgjegjësimi dhe edukimi për mekanizmat antikorrupsion, janë dy fusha të parashikuara në strategjinë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015-2023 dhe në planet e saj të veprimit. Konkretisht, janë të parashikuara masa në funksion të ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit, nxitja e publikut dhe rritja e besimit në mekanizmat antikorrupsion, si dhe rritja e përfshirjes së shoqërisë civile në këto nisma.

Masat e parashikuara në SNKK 2015-2020 dhe në Planin në fuqi të Veprimit 2020-2023 kanë ndikuar në krijimin e një klime bashkëpunimi ndërmjet publikut dhe institucioneve publike. Janë krijuar mekanizma cilësore dhe efikase për parandalimin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, ka bashkëpunim të mirë por kërkohet më shumë frekuencë.

Ministria e Drejtësisë ka një strategji komunikimi dhe vizibiliteti, dhe një plan veprimi (vjetor) me aktivitete dhe nisma me OSHC dhe grupe interesi. Edicionet vjetore, të rregullta të Java e Integritetit prej vitit 2020, një bashkëpunim i ngushtë me biznesin, OSHC dhe akademinë janë evidenca të mira por që duhen replikuar dhe përgjatë vitit.

Vijimi i punës duke intensifikuar përpjekjet në ndërgjegjesimin dhe edukimin e publikut, do të krijojë kushtet e përshtatshme për një shoqëri të ndërgjegjësuar për rrezikun e korrupsionit dhe me besim të lartë në institucionet publike, duke përmirësuar edhe perceptimin publik kundër korrupsionit, të kryer jo vetëm nga organizatat vendore dhe rajonale por edhe ato ndërkombëtare si *Transparency International*.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Ministria e Drejtësisë në ushtrim të rolit të saj të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ndërmerr përgjegjësinë të krijojë, udhëheqë zbatimin, koordinojë dhe lehtësojë masa dhe aktivitete së bashku me OSHC dhe grupe interesi për të rritur dhe siguruar angazhimin: **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit**, i orientuar kundrejt fushave si edukimi – ndërgjegjësimi – por edhe përfshirja aktive e strukturave të administratës publike.

Botime antikorrupsion, video dhe mjete komunikimi, e-buletine, forcim kapacitetesh, manuale hetimi, metodologji monitorimi, instrumente integriteti, etj janë disa prej zgjidhjeve të propozuara për tu kryer në këtë plan veprimi. Shiko planin e veprimit në vijim.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Rezultatet e pritshme nga masat e parashikuara në planin e veprimit të OGP, janë:

- **Edukimin/ Mësimi** i të rinjve dhe fëmijëve rreth pasojave të korrupsionit dhe rëndësisë së integritetit në shoqëri si një hap i rëndësishëm për krijimin e një kulture të drejtësisë;
- **Aktivizimi qytetar:** Qytetarët duhe të jenë të angazhuar dhe në gjendje të denoncojnë korrupsionin si dhe të përfshihen në fushatat ndërgjegjësuese;
- **Media:**Roli i medias në sensibilizimin e publikut kundër korrupsionit duke u përfshirë në publikimin e politikave dhe mekanizmave kundër korrupsionit;
- **Bashkëpunim ndërmjet aktorëve të shoqërisë:** Institucionet publike më transparente dhe organizatat e shoqërisë civile më të përfshira në hartimin e dokumentave kundër korrupsionit dhe integritetit, organizimin e aktiviteteve për promovimin e kulturës antikorrupsion dhe reagimit të shoqërisë.

Angazhimi

Aktivitete/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme epërfundi mit	Aktorët e Interesit		
1.Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet: 1.1 Mjete dhe mekanizma informimi nëpërmjet videove ndërgjegjësuese dhe informuese kundër korrupsionit, me qëllim nxitjen dhe marrjen e denoncimeve nga qytetarët	1.1.1 Krijimi dhe prodhimi i videove kundër korrupsionit, i zhvilluar	6M II 2023	Udhëheqësi:Ministria e Drejtësisë/KKKK		
	<u>Aktorët e Interesit</u>				
			MD/KKK K	DBE/ Asistenca teknike për KKKK	
	1.1.2 Lançim dhe publikim në rrjetet e komunikimit të DPA në MD/KKKK të videove dhe postime (postera) kundër korrupsionit	6M II 2023 - 6M I2024	Udhëheqësi:Ministria e Drejtësisë/KKKK		
<u>Aktorët e Interesit</u>				MD/KKK K	DBE/ Asistenca teknike për KKKK
1.2Krijimi dhe promovimi i mjeteve të komunikimit të DPA; përditësimi i tyre me njoftime dhe zhvillime të fushës së korrupsionit	1.2.1 Profile dhe rrjete sociale të komunikimit të krijuara Twitter; LinkedIn; Facebook; njoftime ditore të fushës antikorrupsion	6M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
<u>Aktorët e Interesit</u>				MD/KKK K	
1.3 Mjet komunikimi dhe informimit elektronik mbi	1.3.1 E- buletine mujor informative i shkruar, shpërndarë		Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
<u>Aktorët e Interesit</u>					

aktivitetin dhe veprimtarinë e DPA (baza mujore)	dhe publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe rrjetet sociale të DPA	2023-2024-2025			
			MD/KKK K		
1.4 Informimi dhe bërja publike e planit vjetor të propozimeve ligjore (plani analitik i akteve)	1.4.1 Plani analitik i akteve (ligjore dhe n/ligjore) i publikuar dhe i njoftuar	2023- 2024	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD/KKK K QBZ		

	1.5.1 Intervista mediatike (TV, etj) për veprimtarinë e DPA dhe të Rrjetit AK	6M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
1.5 Informimi nëpërmjet mediave për aktivitetin dhe veprimtarinë e DPA dhe të mekanizmave antikorrupsion			MD/KKKK	Kanale dhe stacione Media (TV, radio)	
1.6 Aktivitete (Forume) diskutimime qëllime ndërgjegjsimi për mekanizmat e denoncimit kundër korrupsionit	1.6.1 1-2 forume/vitpër mekanizmat kundër korrupsionit	6M II 2023– 2024 -6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
2. Edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet:	2.1.1 Njoftim dhe shpërndarje e fjalorit antikorrupsion	6M II 2023	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		

2.1 Prgatitja dhe publikimi (shpërndarja) e fjalorit të korrupsionit, me qëllim rritjen e informacionit të qytetarëve për kuptimin e korrupsionit.			MD/KKKK		DBE/ Asistenca teknike për KKKK
2.2 Prgatitje dhe publikimi(shpërndarja) e guidës kundër korrupsionit, me qëllim rritjen e informacionit të qytetarëve për kuptimin dhe mekanizmat e denoncimit të korrupsionit	2.2.1 Njoftim dhe shpërndarje e Guidës Antikorrupsioni të printuara dhe të shpërndara	6M II 2023	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD/KKKK		DBE/ Asistenca teknike për KKKK
2.3Mekanizma edukimi dhe informimi AK në shkolla të arsimit të mesëm të lartë	2.3.1 Takime të zhvilluara/vit nga ekspertë të fushës AK në shkolla të arsimit të mesëm të lartë	6M II 2023 - 6M II 2024	Udhëheqësi: Ministria e Drejtësisë/KKKK		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD/KKKK MAS		Ambasada Italiane në Tiranë
2.4Mekanizma monitorimi të zhvilluara, për zbatimin e instrumenteve të integritetit nga OSHC-të	2.4.1 Dy trajnime të zhvilluara me OSHCdhe studiuës të rinj për planet e integritetit dhe metodologjinë e monitorimit të zbatimit të Planeve të integritetit nga OSHC	6M II 2023	Udhëheqësi: IDM		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD	IDM	

2.5 Forcimi i rolit të OSHC-ve në luftimin e korrupsionit dhe edukimin e publikut të gjerë për mekanizmat e përdorur	2.5.1 Krijimi dhe ngritja e Rrjetit Informal Kombëtar të OSHC-ve kundër korrupsionit me pjesëmarrjen e të paktën 50 OSHC-ve në nivel kombëtar	6M I 2024	Udhëheqësi: ALTRI			
			<u>Aktorët e Interesit</u>			
			MD/KKKK	ALTRI		
	2.5.2 Sigurimi i një platforme digjitale interaktive për rrjetin e OSHC-ve kundër korrupsionit	6M I 2024				
	2.5.3 Informacione të ndryshme mbi korrupsionin (informacion ligjor, raporte, statistika, menyra raportimi të korrupsionit, materiale ndërgjegjësuese dhe informuese etj.) që do të përfshihen në platform, të përgatitura	6M I 2024				

3. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike për kuadrin ligjor dhe rregullator për antikorrupsionin dhe mekanizmat antikorrupsion në sektorin publik, nëpërmjet:	3.1.1 Përfaqësues të institucioneve publike të trajnuar për kryerjen e riskut të integritetit në institucionet publike dhe hartimin e PI	6M II 2023	Udhëheqësi: IDM			
			<u>Aktorët e Interesit</u>			
			MD/KKKK ASPA MFE MM MB KLP ILDPKI Avokati Popullit DNJF	IDM		
3.1. Angazhimi i ToT me përfaqësues të institucioneve publike, për kryerjen e						

vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet publike.					
3.2 Rritje dhe pëmirësim të kapaciteteve teknike e profesionale të administratës së KDI, MSHMS dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për modulën “Etika dhe Integriteti në Administratën Publike - Planet e Integritetit”	3.2.1 Stafi i KDI është trajnuar për modulën “Etika dhe Integritetit në Administratën Publike-Planet e Integritetit” 3.2.2 Stafi i MSHMS është trajnuar për modulën “Etika dhe Integritetit në Administratën Publike-Planet e Integritetit” 3.2.3 Stafi i Kuvendit të Republikës është trajnuar për modulën “Etika dhe Integritetit në Administratën Publike-Planet e Integritetit”	6M II 2023	Udhëheqësi: IDM		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD/KKKK ASPA	IDM	KLP KDI MSHMS Kuvendi ISHP
3.3 Mekanizmat e monitorimit të instrumenteve të integritetit në institucionet publike me OSHC-të dhe median	3.3.1 Tryezë e rrumbullakët me përfshirjen e të gjithë grupeve të interesit mbi gjetjet e 5 raporteve të monitorimit të planeve të integritetit KLP, MSHMS, ISHP, KID dhe administrata e Kuvendit nga OSHC-të	6M I 2024	Udhëheqësi: IDM		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			MD KLP MSHMS ISHP KMDHPDI Kuvendi	IDM	
3.4 Mekanizma dhe instrumente hulumtimi (ligjor,	3.4.1 Analizë e kuadrit ligjor, politikë dhe e praktikave në	6M II 2023	Udhëheqësi: ALTRI		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		

politikash dhe hulumtimi në terren për hetimin administrativ të korrupsionit) të zhvilluara dhe pranuara	terren për hetimin administrativ të korrupsionit, e kryer 3.4.2 Manual për teknikat e suksesshme të hetimit administrativ të korrupsionit në administratën publike, i hartuar dhe dorëzuar pranë KKKK	6M II 2023- 6M I 2024	MD- KKKK/Rrjeti i Koordinatorëve AK	ALTRI	
3.5 Krijimi i një mjeti metodologjik për të matur periodikisht perceptimin publik për korrupsionin dhe efektivitetin e mekanizmave kundër korrupsionit	3.5.1 Metodologji për matjen e perceptimit qytetar/të publikut e hartuar dhe e dorëzuar pranë MD/KKKK	6M II 2023	Udhëheqësi: ALTRI		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		<u>Aktorët e Interesit</u>
			Qeveria	OSHC	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MD/KKKK	ALTRI	
3.6 Forcimi i kapacitetesh të DPA dhe Rrjetit të Koordinatorëve AK mbi hetimin administrative të rasteve të korrupsionit	3.6.1 Trajnime të organizuara me koordinatorët e Rrjetit Antikorrupsion dhe stafin e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, duke sjellë teorinë në praktikë mbi zbatimin e Manualit	6M II 2024	Udhëheqësi: ALTRI		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		<u>Aktorët e Interesit</u>
			MD- KKKK/Rrjeti i Koordinatorëve AK	ALTRI	

ANGAZHIM 2

FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI

Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit Përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues

1. Pjesa hyrëse:

Republika e Shqipërisë, deri në vitin 2021 nuk kishte një mekanizëm i cili mund të identifikonte se, cilët janë pronarët përfitues të subjekteve të regjistruara në Shqipëri. Në kuadër të rekomandimeve ICRG/FATF dhe MONEYVAL, qeveria shqiptare në korrik të vitit 2020 miratoi ligjin me nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues” i cili parashikonte ngritjen e regjistrimit të parë në shqipëri, ku do të regjistroheshin të dhënat e pronarëve përfitues për subjektet raportuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 2021 u miratuan edhe aktet nënligjore që rregullonin procedurën dhe dokumentacionin shoqërues që subjektet raportuese duhet të depozitoinin.

Regjistri i Pronarëve Përfitues u bë aktiv më 1 shkurt 2021.

Përgjatë kësaj periudhe, subjektet raportuese, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kryen regjistrimet e të dhënave të pronarëve përfitues. Ndërkohë, në kushtet kur regjistri i pronarëve përfitues është populluar me të dhënat e subjekteve raportuese, Qendra Kombëtare e Biznesit angazhohet që në bashkëpunim me grupet e interesit, të piketojnë ato elementë të legjislacionit në fuqi, që mund të kenë nevojë për rishikim me qëllim lehtësimin e procedurave të regjistrimit.

Aktualisht, Regjistri i Pronarëve Përfitues është populluar në masën 97.4 % për subjektet tregtare të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe në masën 98.19% për Organizatat Jofitimprurëse.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues, ka marrë përsipër disa angazhime që lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar të cila lidhen me:

- ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i subjekteve raportuese për këtë detyrim mbetet një mekanizëm shumë i rëndësishëm për të patur një regjistër të përditësuar në cdo kohë, pasi pas aktivizimit të regjistrimit të pronarëve përfitues në shkurt 2021 dhe popullimit të regjistrimit, regjistrimi i të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve të krijuar rishtas dhe përditësimi i të dhënave mbetet një angazhim i shtetit shqiptar;
- vlerësimin praktikave më të mira në bashkëpunim me përfaqësuesit e subjekteve raportuese dhe grupet e interesit e cila është një angazhim, që do të çojë në përmirësimin e praktikave të ndjekura nga vendi ynë në procesin e regjistrimit të të dhënave të Pronarëve Përfitues dhe në përditësimin e tyre në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.
- rishikimin e legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues pasi përballja e subjekteve raportuese me nocionin e ri të pronarit përfitues dhe zbatimin e një procedure të re të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, sjell nevojën për një njohje të legjislacionit në fuqi me qëllim zbatimin e saktë të tij dhe ndërmarrjen e ndryshimeve nëse është e nevojshme.

1. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit, Qendra Kombëtare e Biznesit organizoi një takim online në datë 27.02.2023 ora 11:00, me subjektet raportuese dhe grupet e interesit me tematikë “Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 (tre) angazhimet prioritare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit me grupet e interesit”kuu prezantuanjë material mbi OGP se çfarëështënëvetvetedhehistorikun e sajdhemë pas u shpjeguan 3 (tre) angazhimet, njëpërshkrimishkurtëpërsecilënprejtyredheaktivitetetëcilat QKB propozonte. Kjo nisëm u vlerësua shumë nga subjektet raporuese të cilët pranuan të bashkëpunojnë në vijim në përfshirje të tyre në aktivitetet pasuese për të diskutuar mbi të 3 (tre) angazhimet.

E gjithë kjo iniciativëështë goxha me vlerë dhe sjell një rezultat shume efektiv nisur nga eksperiencia e vazhdueshme që Qendra Kombëtare e Biznesit ka me subjektet raportuese të cilave i ofron asistencë në cdo formë komunikimi për problematikat/vështërsitëqë ato hasin.

4. Angazhimet

Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;

Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit European mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe integrimi i tyre në praktikatat e vendit tonë;

Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi identifikimin e pronarëve përfitues dhe dokumentet shoqëruese për regjistrimin e të dhënave të tyre.

ANGAZHIM 2
FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI

ANGAZHIMI 2: Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;

Vendi	Shqiperi		
Emërtimi i angazhimit	Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Republika e Shqipërisë, deri në vitin 2021 nuk kishte një mekanizëm i cili mund të identifikonte se, cilët janë pronarët përfitues të subjekteve të regjistruara në Shqipëri.</p> <p>Për këtë arsye, Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) rekomandoi ngritjen e një regjistri i cili do të bëjë të mundur regjistrimin e pronarëve real përfitues.</p> <p>Regjistri i Pronarëve Përfitues u bë aktiv më 1 shkurt 2021.</p> <p>Aktualisht, Regjistri i Pronarëve Përfitues është populluar në masën 97.4 % për subjektet tregtare të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe në masën 98.19% për OrganizatatJofitimprurëse.</p> <p>Ndërkohë që, regjistri është populluar me të dhënat e pronarëve përfitues të pjesës më të madhe të shoqërive ekzistuese, ligji parashikon detyrimin e regjistrimit të të dhënave për çdo shoqëri tregtare dhe OJF të regjistruar rishtazi e ndërkohë parashikon detyrimin e përditësimit të të dhënave nga subjektet raportuese në vijimësi.</p> <p>Në këtë kuadër Qendra Kombëtare e Biznesit merr angazhimin për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues. Qëllimi dhe sfida është që Regjistri të përmbajë të dhëna të sakta dhe të përditësuara.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Qendra Kombëtare e Biznesit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
	MFE QKB AKSHI DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Pas aktivizimit të regjistrimit të pronarëve përfitues në shkurt 2021 dhe popullimit të regjistrimit, regjistrimi i të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve të krijuar rishtas dhe përditësimi i të dhënave mbetet një angazhim i shtetit shqiptar. Në këtë kuadër ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i subjekteve raportuese për këtë detyrim mbetet një mekanizëm shumë i rëndësishëm për të patur një regjistër të përditësuar në cdo kohë. Mungesa e informacionit nga ana e subjekteve raportuese për detyrimin ligjor për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe ndryshimeve përkatëse, mungesa e informacionit për procedurën, afatet ligjore dhe penaltitetet, mbetet një problematikë që ka nevojë për adresim dhe zgjidhje.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Detyrimi për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues është një procedurë e re për të gjithë subjektet raportuese që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Popullimi i regjistrimit me të dhënat e pronarëve përfitues, në fazën e regjistrimit fillestar të të dhënave, ishte sfida kryesore, ndërkohë krijimi i ndërgjegjësimit tek subjektet raportuese se të dhënat duhet të përditësohen sa herë që pësojnë ndryshime, mbetet një sfidë e shtetit shqiptar.

Mungesa e njohjes së legjislacionit dhe nocioni i ri, e bëjnë një sfidë në vetvete përmbushjen e detyrimit ligjor për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.

4. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues, është angazhuar që në vazhdimësi të orientojë dhe të njoftojë subjektet raportuese nëpërmjet të gjitha kanaleve të saj të komunikimit.

5. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Zhvillimi i një fushate sensibilizimi/ndërgjegjësimi që synon njohjen nga subjektet raportuese të detyrimit për regjistrimin e ndryshimi të të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

6. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Subjekte raportuese të informuara mbi detyrimin për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përmbushja e këtij detyrimi sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Popullimi i regjistrimit me të dhëna të sakta dhe të përditësuara.

Angazhim

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
<p>1. Fushatë informimi, sensibilizimi në lidhje me detyrimin ligjor për përditësimin e të dhënave nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si faqja zyrtare të QKB-së, e-mail, platforma qeveritare e-albania)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pop-up në faqen e qkb dhe e-albania - Njoftim për cdo subjekt raportues të regjistruar rishtazi në RT dhe ROJF për detyrimin ligjor - Video sensibilizues dhe demonstruese 	6M I 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE QKB AKSHI DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë
<p>2. Takime konsultuese me subjektet e detyruara (bankat, noteret, avokatet) me qëllim që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të njoftojnë subjektet raportuese për detyrimin ligjor për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Takime me subjektet e detyruara 	6M II 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE QKB AKSHI DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë

ANGAZHIM 3
FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI

ANGAZHIMI 3: Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.

Vendi	Shqiperi		
Emërtimi i angazhimit	Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Pas hyrjes në fuqi të Ligjitnr. 112/2020 “Për regjistrin e Pronarëve Përfitues” dhe pas aktivizimit të regjistrimit të pronarëve përfitues në shkurt 2021 është vërejtur që gjatë zbatimit të tij janë konstatuar vështirësitë dhe sfidat që janë hasur nga subjektet raportuese në zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues si dhe ndryshimet e të dhënave të regjistruara të pronarëve përfitues. Arrihet në konkluzion se, vlerësimi i praktikave më të mira në bashkëpunim me përfaqësuesit e subjekteve raportuese dhe grupet e interesit është një angazhim, që do të çojë në përmirësimin e praktikave të ndjekura nga vendi ynë në procesin e regjistrimit të të dhënave të Pronarëve Përfitues dhe në përditësimin e tyre në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.		
Udhëheqësi i angazhimit	Qendra Kombëtare e Biznesit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)
	MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Problematikat e hasura nga subjektet raportuese gjatë identifikimit të pronarit të tyre përfitues, të lidhura këto me nocionin e pronarit përfitues, procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Detyrimi për regjistrimin e të dhenave të pronarëve përfitues është një procedurë dhe një sfidë e re për të gjithë subjektet raportuese që operojnë në Shqipëri duke qenë se akoma është një koncept i ri në ciklin e jetës së një biznesi apo OJF. Këto praktika shërbejnë si një udhërrëfyes në konsolidimin e praktikave tona.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues, ka marrë pjesë në takimet e grupit të punës të krijuar nga anëtarët e EBRA për pronarët përfitues. Në këtë takim janë diskutuar praktikatat e ndjekura nga vendet anëtare të EBRA për zbatimin e regjistrimit të pronarëve përfitues dhe të Direktivës së katërt të AML. Në këto takime janë diskutuar problematikat e hasura gjatë zbatimit të legjislacionit në fuqi mbi regjistrimin e pronarit përfitues.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Vlerësimi dhe analizimi i praktikave më të mira të zbatuara nga vendet e tjera të BE-së të cilat kanë edhe eksperiencë disa vjecare në këtë proces. Diskutimi në formën e takimeve konsultative me përfaqësues të subjekteve raportuese dhe grupet e interesit mbi këto praktika.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Identifikimi i praktikave më të mira me qëllim integrimin e tyre në legjislacionin shqiptar dhe zbatimin gjatë procesit të regjistrimit dhe përditësimit e të dhënave të pronarëve përfitues.

Angazhimi Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
<p>1. Zhvillimi i një takimi me përfaqësues të subjekteve raportuese dhe grupet e interesit trajnimeve, përmes të cilave synohet të merret një eksperiencë duke ju referuar praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues .</p>	<p>- Hartimi i një Raporti apo Manuali orientues që evidentojnë praktikat më të mira, ku subjektet të mbështeten gjatë kryerjes së aplikimeve për regjistrimin e pronarëve përfitues</p>	<p>6M I 2024</p>	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë			
<p>2. Zhvillimi i një trajnime të organizuar me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të subjekteve raportuese dhe grupet e interesit me qëllim njohjen e praktikave ndërkombëtare në procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.</p>	<p>- Hartimi i një Raporti apo Manuali orientues që evidentojnë praktikat më të mira, ku subjektet të mbështeten gjatë kryerjes së aplikimeve për regjistrimin e pronarëve përfitues.</p>	<p>6M II 2024</p>	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë			

ANGAZHIM 4
FUSHA: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI

ANGAZHIMI 4: Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Republika e Shqipërisë, deri në vitin 2021 nuk kishte një mekanizëm i cili mund të identifikonte se cilët janë pronarët përfitues të subjekteve të regjistruara në Shqipëri.</p> <p>Për këtë arsye, Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) rekomandoi ngritjen e një regjistri i cili do të bëjë të mundur regjistrimin e pronarëve real përfitues.</p> <p>Në kuadër të rekomandimeve ICRG/FATF dhe MONEYVAL, qeveria shqiptare në korrik të vitit 2020 miratoi ligjin me nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues” i cili parashikonte ngritjen e regjistrimit të parë në shqipëri, ku do të regjistroheshin të dhënat e pronarëve përfitues për subjektet raportuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 2021 u miratuan edhe aktet nënligjore që rregullonin procedurën dhe dokumentacionin shoqëruar që subjektet raportuese duhet të depozitonin.</p> <p>Përgjatë kësaj periudhe, subjektet raportuese, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kryen regjistrimet e të dhënave të pronarëve përfitues. Ndërkohë, në kushtet kur regjistri i pronarëve përfitues është populluar me të dhënat e subjekteve raportuese, Qendra Kombëtare e Biznesit angazhohet që në bashkëpunim me grupet e interesit, të piketojnë ato elementë të legjislacionit në fuqi, që mund të kenë nevojë për rishikim me qëllim lehtësimin e procedurave të regjistrimit.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Qendra Kombëtare e Biznesit		
Grupet e Interesit që mbështesin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)

angazhimin	MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Problematikat e hasura nga subjektet raportuese gjatë identifikimit të pronarit të tyre përfitues, të lidhura këto me nocionin e pronarit përfitues, procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Detyrimi për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues është një procedurë e re për të gjithë subjektet raportuese që operojnë në Shqipëri. Përballja e subjekteve raportuese me nocionin e ri të pronarit përfitues dhe zbatimin e njëprocedurë të re të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, sjell nevojën për një njohje të legjislacionit në fuqi me qëllim zbatimin e saktë të tij dhe ndërmarrjen e ndryshimeve nëse është e nevojshme.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Janë organizuar takime me grupet e interesit, ku është diskutuar për vështirësitë që hasen nga ana e subjekteve raportuese në kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Konsultimi me grupet e interesit me qëllim evidentimin e vështirësive që subjektet raportuese hasin në përditshmërinë e tyre në kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e legjislacionit.

Marrja në konsideratë e sugjerimeve/rekomandimeve dhe analizimi i problematikave që subjektet hasin, me qëllim rivefutimin në legjislacion nëse është e nevojshme.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Rishikimi i legjislacionit dhe identifikimi i ndryshimeve të nevojshme me qëllim përmirësimin e procedurave të ndjekura për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
<p>1. Legjislacion që parashikon një procedurë të thjeshtë, të kuptueshme dhe të zbatueshme brenda afateve, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.institutet dhe procedurën që legjislacioni aktual në fuqi parashikon</p>	<p>Raport përmbledhës të sugjerimeve lidhur me ndryshimet e mundshme ligjore.</p>	<p>2024</p>	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektori Privat,etj)
			MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë
<p>2. Takim konsultues me subjektet raportuese dhe grupet e interesit.</p>	<p>- Raport përmbledhës të sugjerimeve lidhur me ndryshimet e mundshme ligjore</p>		Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektori Privat,etj)
			MFE QKB AKSH DPT KLGJ	Shoqatat e biznesit GIZ	Përfaqësues të studiove ligjore Dhomat e tregtisë

ANGAZHIM 5

FUSHA: AKSESI NE DREJTËSI

ANGAZHIMI 5: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Drejtësisë është ministria përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e drejtësisë. Gjithashtu MD është edhe instiucioni lider për ndjekjen dhe raportimin lidhur me Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, si dhe Kriterin Politik.

Në përmbushje të detyrimeve funksionale, bazuar edhe në fushën e saj të përgjegjësisë, Ministria e Drejtësisë harton dhe ndjek zbatueshmërinë e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Strategjinë Ndërsektoriale për Drejtësinë për të Mitur 2022-2026, si dhe Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut 2019-2023.

Në dhjetor 2022, Qeveria Shqiptare filloi procesin e hartimit të planit të veprimit OGP (2022), 2023-2025, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), si një ndër instrumentet më të rëndësishëm në nivel global, me qëllim nxitjen e transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike, si dhe për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij.

Ky proces, filloi si iniciativë sipas Koordinatorit Kombëtar për OGP në Kryeministri dhe do të vijojë të udhëhiqet nga Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, si struktura përgjegjëse e koordinimit për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur në bashkëpunim me institucionet/strukturat përkatëse të OGP 2023-2025.

Plani i veprimit OGP realizohet çdo dy vjet dhe plani aktual është i 6-të i veprimit dhe i përket periudhës 2023-2025.

Një nga angazhimet prioritare të OGP-së, komponenti i “aksesit në drejtësi” paraqitet në fushën e II të prioriteteve me angazhimin “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi” dhe është direkt nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë

Angazhimi prioritar ka në përbërje të tij 2 (tre) masa prioritare, si përmenden:

5. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi
6. Edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi

Plani i veprimit për këtë angazhim prioritar ka në përbërje të tij 15 masa/aktivitete, për të cilat parashikohen marrja e produkteve konkrete, të matshme për periudhën e zbatimit, vitet 6M2 2023 – 2024 - 2025.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Transparenca, llogaridhënia dhe aksesit në drejtësi janë parimet kyçe operationale të njohura për qeverisje të mirë duke përbërë kështu shtyllën kryesore të demokracisë. E drejta e aksesit në

drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe mirëfunksionimin e drejtësisë në vend.

Aksesi në drejtësi shihet si një nga komponentët kyç të qeverisë shqiptare e ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND), Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion (SNKK), Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur (SNDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Aksesi në drejtësi vlerësohet si një nga parimet kryesore të sundimit të ligjit, ndaj dhe lidhet me OZHQ 16: “Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ai lidhet me nën-objektivat 16.3 “Promovim i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurim i aksesit të barabartë për drejtësi për të gjithë”, 16.6 “Zhvillim i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet” dhe 16.7 “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet” të OZHQ. Ministria e Drejtësisë në përmbushje të misionit dhe funksionit të saj, ka ndërmarrë me sukses realizimin e iniciativave të domosdoshme dhe masave të propozuara në strategjitë e saj, sidomos ato që lidhen direkt me aksesin në drejtësi.

Në këtë kuadër, është ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (aksesi në drejtësi).

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efçente dhe efektive. Ligji nr.111/2017 është një ndër ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi përmes të cilit u reformua i gjithë sistemi i ndihmës juridike duke ofruar një frymë të re, në përputhje me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në zbatim të ligjit janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të cilat synojnë të rregullojnë kuadrin ligjor të detajuar për çdo fushë specifike të ndihmës juridike. 13 akte nënligjore në fushën e ndihmës juridike kanë sjellë një serë risish dhe procedurash të reja. Shërbimi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me ndryshimet e reja, është ndarë në 3 forma duke synuar zgjerimin e llojit të shërbimeve ligjore falas, konkretisht:

- Ndihmë juridike parësore (duke përcaktuar qartë ofruesit e këtij shërbimi me synimin për të rrjetëzuar dhe shtrirë këtë shërbim në të gjithë territorin);
- Ndihmë juridike dytësore (ofruar nga avokatët e miratuar nga DhASH); dhe
- Përyjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin më të mëdha.

Gjithashtu aksesi në drejtësië shihet qartazi i lidhur me rolin e Dhomës Ndërkombëtare të Ndërmjetësve si dhe me Qendrën e Parandalimit të Krimeve për të Rinjtë dhe të Miturit.

Në zbatim të Vendim nr. 314, datë 15.5.2019 “Për Organizimin, Funkzionimin, si dhe Përcaktimin e Rregullimeve Specifike lidhur me Strukturën dhe Organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, ndryshuar me VKM Nr. 656, datë 10.10.2022

Qendra si fushë përgjegjësie ka parandalimin e krimeve të të miturve dhe të rinjve. Qendra ushtron veprimtarinë parandaluese edhe nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore Qendra ka nisur rritjen e ndërgjegjësimit për publikun e gjerë dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi përmes Edukimit Ligjor.

Lidhur me këtë pikë QPKMR ka iniciuar disa programe, më konkretisht:

Fushatë ndërgjegjësuere në shkolla, është një fushatë e iniciuar nga QPKMR në kuadër të edukimit ligjor të të miturve dhe të rinjve mbi drejtësinë penale për të mitur.

Në përbërje të kësaj fushate janë të angazhuar stafi i QPKMR, të cilët në bazë të një kalendari aktiviteteve të shtrirë në të gjithë territorin e vendit, organizojnë takime periodike në mënyrë që të miturit të njihen me të drejtat e tyre në sistemin e drejtësisë penale për të mitur dhe me parimet e drejtësisë miqësore.

Informacionet mbi të miturit do të merren nëpërmjet diskutimeve, lojërave, simulimeve si dhe ndarjen e eksperiencave nga njerëz të ndryshëm.

Qëllimi i kësaj fushate është informimi i të miturve në kuadër të njohjes së tyre me parimet e drejtësisë penale për të mitur, si dhe programet parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese që Ministria e Drejtësisë bashkë me QPKMR harton.

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve ligjore janë hartuar manuale, broshura, revista nga ana e QPKMR- së për ti ardhur në ndihmë jo vetëm të miturve por edhe mësuesve, oficerëve të sigurisë në shkolla, prindërve dhe çdo profesionisti apo qytetari që është i interesuar për këtë lloj informacioni.

Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm në rrjetet sociale dhe faqen web si dhe janë shpërndarë kopje fizike nëpër institucione dhe organizata që kanë në fokus të miturit dhe të rinjtë si dhe në shkollat ku është zhvilluar deri më tani edukimi ligjor.

3. Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me rregulloren e OGP, dhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 “Për ngritjen dhe Funkcionimin e Komunitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisjen e Hapur”, ka iniciuar, kryer dhe përfunduar procesin e hartimit të Planit të Veprimit Për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023 – 2025, për angazhim prioritar: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.*

Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit është zhvilluar sipas këtyre fazave dhe në përputhje me afatet e kalendarit të propozuar dhe të miratuar nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

Propozimi dhe kërkesa për propozime e angazhimeve prioritare:

Në funksion të përcaktimit të qëllimit primar të politikës për institucionin dhe fushën e veprimit u hartua dhe u shpërnda për plotësim dhe miratim nëpërmjet konsultimit publik pyetësori –sondazh

(anketa) për përcaktimin e angazhimeve prioritare të Ministrisë së Drejtësisë në PKV 2023-25 (dhjetor 2022). Pyetëtori kërkonte kontributin konkret mbi rolin dhe përfshirjen e OSHC-ve dhe të grupeve të interesit. Pyetëtori (anketa) u shpërnda via email, u publikua në faqen e internetit të OGP Albania dhe gjithashtu të Ministrisë së Drejtësisë. Për këtë qëllim u hartua edhe një raport konsultimi.

Kjo fazë u shoqërua e komunikime të shtuara me OSHC dhe grupet e interesit via email, telefon dhe ëbsite të Ministrisë së Drejtësisë si dhe të OGP Albania.

Hartimi i angazhimeve prioritare/ konsultimi dhe dakordësimi i tyre:

Rezultatet dhe kontributet e marra në përfundim të afatit për plotësim të sondazhit (anketës) u diskutuan dhe dakordësuan me zhvillimin e dy takimeve (12 dhe 17 janar 2023) të cilat konfirmuan përfshirjen e grupeve të interesit, organizatave të shoqërisë civile, akademisë, ministrive të linjës si dhe çdo të interesuari në hartimin dhe konsolidimin e komponentëve të planit kombëtar të OGP, për angazhimin: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.*

Paketa e plotë e raportimit të kësaj faze (pyetëtori - raportet e konsultimit, agjendat e takimeve - takimet e zhvilluara dhe angazhimet prioritare të propozuara) janë dorëzuar pranë sekretariatit teknik të Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

Hartimi, konsultimi dhe dakordësimi i masave/produkteve të PV për angazhimin:

Ministria e Drejtësisë, si institucion udhëheqës i angazhimit prioritar: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi*, dhe pas marrjes së miratimit në takimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur (9 shkurt 2023) me pjesëmarrjen e zvmministrit të Drejtësisë (anëtar i Komitetit), u vijua me procesin e krijimit, hartimit dhe dakordësimin e masave/aktiviteteve dhe të produkteve konkrete të angazhimit të ndërmarrë.

MD përgatiti një draft-plan veprimi, sipas formatit të dërguar nga sekretariati teknik pranë Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, dhe ka zhvilluar dy takime (21 dhe 24 shkurt 2023) me grupet e interesit dhe OSHC-të mbi propozimet dhe angazhimin e tyre në masa specifike në bashkë-bërjen e planit të veprimit.

Drafti dërguar nga MD fillimisht përmbante masat e propozuara nga qeveria, me afatet e zbatimit. Në takimin e datës 21 shkurt 2023, drafti u shtua edhe me propozime të OSHC-ve, të ciat u dakordësuan në takimin e datës 24 shkurt 2023. Kjo fazë e procesit ka përdorur mjete të komunikimi si, via email, telefon, website, sid he shoqëruar me postera informimi publik në rrjetet sociale të MD.

Paketa e plotë e raportimit të kësaj faze (drafti i planit të veprimit - raportet e konsultimit, agjendat e takimeve - takimet e zhvilluara janë dorëzuar pranë sekretariatit teknik të Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

4. Angazhimet

Në kuadër të hartimit të Planit të Veprimit të OGP 2023 – 2025, janë realizuar disa takime me organizatat e shoqërisë civile, me Ministrinë e Linjës, me institucionet në varësi të ministrive të linjës, me akademikë dhe aktorë të cilët japin kontributin e tyre të vyer në komponentin e aksesit në drejtësi.

Politika e Komponentit nr 2. “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi”, është propozuar duke pasur në konsideratë politikën dhe qëllimin madhor të Qeverisë Shqiptare “ Ndërtimi i një qeverie të hapur që i siguron qytetarëve të saj akses në drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie”.

Në përfundim të procesit të bashkë-bërjes dhe konsultimit me OSHC-të, PVK konsistoi në 2 masa/aktivitete (milestone) kryesore, përkatësisht

1.1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

1.2. Edukimi i Publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

Politika kryesore e aksesit në drejtësi, e formuluar më së miri dhe e qartë, mundëson përcaktimin e drejtë të milestone dhe adoptimin e masave konkrete dhe të realizueshme në përmbushje të saj.

Sipas fushës së veprimit dhe përgjegjësisë, Ministria e Drejtësisë është institucion përgjegjës ose në bashkëpunim me institucione të tjera. Aksesit në drejtësi nuk mund të shihet i realizuar dhe në përputhje me parimin e sundimit të ligjit nëse ai nuk është transparent dhe llogaridhënës. Si rrjedhojë, si transparanca ashtu dhe llogaridhënia janë përfshirë në draftin e planit të veprimit me objektiva specifike dhe masa konkrete. Të treja elementët të zbatimit në konform me ligjin, të ndërthurrura në zbatimin e masave të tyre, mundësojnë realizimin me sukses të kësaj të drejte themelore universale të qytetarëve në një shoqëri demokratike.

ANGAZHIM 5
FUSHA: AKSESI NE DREJTËSI

ANGAZHIMI 5: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi

Vendi	Ministria e Drejtësisë		
Emërtimi i angazhimit	“Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi”.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Akresi në drejtësi vlerësohet si një nga parimet kryesore të sundimit të ligjit, ndaj dhe lidhet me OZHQ 16: “Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. . UNDP e ka përcaktuar aksesin në drejtësi si “mundësia e qytetarëve për të kërkuar dhe siguruar një mjet juridik përmes institucioneve formale apo jo formale të drejtësisë, dhe në përputhje me standartet themelore të të drejtave të njeriut” (2005).</p> <p>Ministria e Drejtësisë në të përgjegjësisë së saj funksionale ndërmerr angazhimin të krijojë, udhëheqë zbatimin, koordinojë dhe lehtësojë masa dhe aktivitete së bashku me OSHC dhe grupe interesi për të rritur dhe siguruar angazhimin: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.</p> <p>Masa dhe aktivitete specifike janë planifikuar për zbatim, me vehte dhe në bashkë-zbatim qeveri-OSHC dhe me një përfshirje të posaçme të strukturave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Drejtësisë		
Grupet e Interesit që mbështesin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektori Privat, etj)

angazhimin	Ministria e Drejtësisë/AMSHC	OSHC	<i>Partenerë të tjerë</i>
Periudha e implementimit	2023 - 2025		

Identifikimi i problemit

2. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Ky angazhim ka si qëllim përmirësimin dhe funksionimin e mekanizmave të duhur si elementë shumë të rëndësishëm për të mundësuar aksesin e publikut, funksionimin efikas dhe eficient të aksesit në drejtësi.

Si një parim i gjerë, që përfshin në vetvete disa të drejta, kur flasim për aksesin në drejtësi duhet të mbajmë parasysh të drejtën që kanë individët për të pasur akses në drejtësi.

Qëllimi i këtij komponenti është sigurimi i një panorame të qartë të sfidave që hasin dhe prekin çdo ditë qytetarët lidhur me aksesin në drejtësi, me fokus të veçantë qytetarët me vulnerabël dhe rrjedhimisht nevojave që kanë qytetarët në mënyrë që t'u garantohet akses më cilësor në drejtësi përmes nismave advokuese që lidhen me këto sfida.

Komponenti “Aksesi në drejtësi” synon adresimin e problematikave të faktorëve strukturorë dhe institucionalë, përfshirë këtu kompleksitetin dhe kostot e proceseve ligjore të cilët pengojnë qasjen në drejtësi veçanërisht për grupet vulnerabël dhe grupet e marginalizuara. Një nga parimet dhe obligimet kryesore të udhëheqjes së mirë është transparenca dhe llogaridhënia e cila ndikon drejtpërsëdrejti në besueshmërinë e qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë.

Forcimi i efikasitetit, transparencës dhe paanësisë në gjykata është paraqitur si një sfidë e rëndësishme e cila kërkon krijimin e mekanizmave të thjeshtë dhe sa më pak burokratik për të siguruar shërbime të drejta, transparente, efektive, jodiskriminuese dhe të përgjegjshme që promovojnë aksesin në drejtësi për të gjithë qytetarët.

3. Cilat janë shkaqet e problemit?

Mungesa e kapaciteteve të nevojshme (buxhetore, strukturale, njerëzore) kanë qenë disa nga pengesat në mungesën e aksesit të plotë në drejtësi.

- Rritja e transparencës tek shërbimet në kategoritë në nevojë, se si ofrohen këto shërbime nga Drejtoria e Ndihmës Juridike (DNJF);
- Rritja e Ndërgjegjësimi të qytetarëve mbi aksesin në drejtësi;
- Informimi i qytetarëve mbi këtë mekanizëm, për akses dhe rrugët e ndjekjes;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me DNJF, të nevojshëm që qytetarët të ndërgjegjësohen dhe të njihen më tepër me konceptin e mekanizmave të aksesimit të drejtësisë.

Përshkrimi i Angazhimit

7. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ky komponent ka gjetur shtrirje të gjërë duke u materializuar dhe ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND), Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe masat e tjera të ndërmara nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje/politikë të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Me inicimin e Reformës në Drejtësi, një reformë e thellë që po prek në tërësi çdo element të sistemit aktual të drejtësisë, u iniciua edhe një reformim i sistemit të ndihmës juridike, duke ofruar

një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe si njëmekanizëm lehtësues që përdoret për të rritur aksesin në drejtësi për grupet që nuk kanë mundësi financiare për të paguar tarifat ligjore pranë organeve/gjykatave dhe njëkohësisht për të mundësuar këshillim ose mbrojtje ligjore. Programet e ndihmës juridike falas synojnë të sjellin sistemin e drejtësisë më afër nevojës së qytetarëve. Për këtë arsye ky komponent është përqëndruar në sigurimin e mjeteve juridike efektive por edhe të arritshme dhe të përbalueshme për zgjidhjen e problematikave.

Në këtë kuadër duhet theksuar se pavarësia e sistemit gjyqësor dhe integriteti i tij, janë një parakusht thelbësor për të siguruar që nuk ka diskriminim në administrimin e drejtësisë. Në përgjigje të nevojave dhe problematikave u synua ndërmarrja e angazhimeve duke përfshirë një qasje të trefishtë mbi aksesin, transparencën dhe llogaridhënien. Puna e realizuar në kuadër të këtijkomponenti ka vijuar me prioritet me qëllim identifikimin e sfidave dhe përmirësimin e hapave të mëtejshëm për një proces zbatueshmërie efektiv.

Prioriteti aktual mbi aksesin në drejtësi, do të vazhdojë me synimin për të përmirësuar këtë komponent dhe për të arritur një qeveri transparente në përputhje me praktikatat më të mira dhe standardet europiane.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Nga takimet e zhvilluara në kuadër të hartimit të OGP-së, oshc, aktorët pjesëmarrës shprehën dakordësinë në mënyrë unanime mbi komponentin e aksesit në drejtësi ku paraqitet në fushën e II të prioritetëve me angazhimin “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi”. Zgjedhjet e propozuara nga oshc, institucionet dhe aktorët pjesëmarrës ishin rreth fushatave sensibilizuese me tema të veçanta për qytetarët rreth mekanizmave të aksesit në drejtësi. Takime, forume, fushata, përditësime informacioni online në shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, hartimi i manuale specifike për qytetarët dhe grupet e interesit mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi. Më poshtë vijohet më konkretisht rreth masave konkrete ku oshc dhe institucionet janë pjesë e këtij procesi dhe angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale; Përgatitja e informacioneve me gjuhën e shenjave për shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijët nga çdo institucion dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të institucionit; Promovimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkollë dhe në komunitet; Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre; Organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese në terren në zona ku ka fëmijë më të riskuar për të qenë në kontakt/konflikt me ligjin; Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për informimin e fëmijëve dhe prindërve për mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas, me fokus grupet më të dobëta të fëmijëve; Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj; Aktivitete informuese dhe zhvillimi i programeve edukative në shkollat 9- vjeçare dhe të mesme, si dhe pranë qendrave multidisiplinare mbi drejtësinë penale për të miturit.

Përditësimi i informacionit online, me një gjuhë miqësore për fëmijët për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijë nga çdo institucion; Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme; Përgatitja e metodikave të ndërmjetësimit të konflikteve në shkollë; Zhvillimi i aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese dhe promovuese me nxënësit dhe mësuesit për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në shkollë; Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese me fëmijë dhe prindër për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin e konflikteve në komunitet; Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë; Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit.

3.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Administrimi i mirë i një shteti fillon së pari me garancitë që duhet të ketë çdo individ për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore. Gjithashtu, mbrojtja dhe garantimi i këtyre të drejtave nëpërmjet aksesit në institucionet e së drejtës përbën një nga parimet themelore Kushtetuese dhe Konventore, të cilit i është dhënë rëndësi e veçantë që me krijimin e institucioneve të para të së drejtës.

Prioriteti aktual mbi aksesin në drejtësi, do të vazhdojë me synimin për të përmirësuar këtë komponent dhe për të arritur një qeveri transparente në përputhje me praktikatat më të mira dhe standardet europiane.

Ndër rezultate të arritshme dhe të pritshme për këtë komponent vijnë si më poshtë;

- 100 fushata sensibilizuese mbi ligjin e NJF.
- Fushata informuese dhe ndërgjegjësuese në terren në zona ku ka fëmijë më të riskuar për të qenë në kontakt/konflikt me ligjin.
- 100 fushata të organizuara për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe prindërve për mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas, me fokus grupet më të dobëta të fëmijëve.
- 10 forume të organizuara me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj.
- 70 aktivitete informuese nëpër shkollat 9 – vjeçare dhe të mesme si dhe pranë qendrave

multidisiplinare mbi drejtësinë penale për të miturit.

- Materiale të hartuara që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme.
- Metodika të përgatitura të ndërmjetësimit të konflikteve në shkollë.
- Aktivitete të zhvilluara për ndërgjegjësim të nxënësve dhe mësuesve mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkolla.
- Aktivitete të zhvilluara për ndërgjegjësim dhe informim të fëmijëve dhe prindërve për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësim në komunitet.
- Nevoja prioritare të vlerësuara të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
2.1.1 Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale.	100 fushata sensibilizuese mbi ligjin e NJF.	6M II 2023	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			DNJF		
2.1.2 Përgatitja e informacioneve me gjuhën e shenjave për shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijët nga çdo institucion dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të institucionit.	Informacione të përgatitura, publikuara në web të institucionit	2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			QPKMR, DNJF, DHKN	MD/OSHC	
2.1.3 Promovimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkolla dhe në komunitet.	Programe të promovuara në 3 shkolla	6M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			DHKN	MD/OSHC	
2.1.4 Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.	3 Fushata informuese dhe ndërgjegjësuese	2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MD/DNJF		
2.1.5 Organizimi i fushatave informuese dhe	100 fushata		Udhëheqësi		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		

ndërgjegjësuese në terren në zona ku ka fëmijë më të riskuar për të qenë në kontakt/konflikt me ligjin.	ndërgjegjësuese dhe informuese	6M II 2023 - 2024	Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DNJF	MD/OSHC	
2.1.6 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për informimin e fëmijëve dhe prindërve për mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas, me fokus grupet më të dobëta të fëmijëve.	100 fushata të organizuara për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe prindërve për mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas, me fokus grupet më të dobëta të fëmijëve.	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DNJF	MD/OSHC	
2.1.7 Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj.	10 forume të organizuara	6M II 2023- 2024	Udhëheqësi		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DNJF	OSHC	
2.1.8 Aktivitete informuese dhe zhvillimi i programeve edukative në shkollat 9- vjeçare dhe të mesme, si dhe pranë qendrave multidisiplinare mbi drejtësinë penale për të miturit.	70 aktivitete informuese nëpër shkollat 9 – vjeçare dhe të mesme	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			QPKMR/A LTRI	ALTRI	

2.1.9 Përditësimi i informacionit online, me një gjuhë miqësore për fëmijët për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijë nga çdo institucion.	Informacion i përditësuar dhe publikuar	2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			QPKMR, DNJF, DHKN	MD, OSHC	

2.1.10 Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme.	Materiale të hartuara	6M II 2023	Udhëheqësi		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DNJF	OSHC	
2.1.11 Përgatitja e metodikave të ndërmjetësimit të konflikteve në shkollë.	Metodika të përgatitura	6 M II 2023 – 6 M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DHKN	OSHC	
2.1.12 Zhvillimi i aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuere dhe promovuese me nxënësit dhe mësuesit për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në shkolla.	2 Aktivitete të zhvilluara për ndërgjegjësim të nxënësve dhe mësuesve mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkolla	6 M II 2023 – 6 M I 2025	Udhëheqësi		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DHKN	MD/OSHC	
2.1.13 Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me fëmijë dhe prindër për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin e konflikteve në komunitet.	2 Aktivitete të zhvilluara për ndërgjegjësim dhe informim të fëmijëve dhe prindërve për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësim në komunitet	6 M II 2023 – 6 M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DHKN	OSHC	
2.1.14 Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës	Nevoja prioritare të vlerësuara	2024	Udhëheqësi		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj)
			DNJF	OSHC	

së tyre të veprimtarisë.					
2.1.15 Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit.	Materiale të hartuara, të publikuara dhe të shpërndara për qytetarët	2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			DNJF	OSHC	

ANGAZHIM 6

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 6: Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness)

1. Pjesa hyrëse

Në botën moderne të globalizuar, suksesi ekonomik dhe cilësia e lartë e jetës arrihen në vendet që kanë prioritet përdorimin e teknologjisë drejt përmirësimit të shoqërisë nëpërmjet zgjerimit të njohurive dhe përmirësimit të shërbimeve publike dhe ofrimit të tyre. Zhvillimi i shoqërisë së informacionit në Shqipëri është një objektivi i përbashkët në të gjithë sektorin publik, akademinë, organizatat joqeveritare (OJQ), organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe sektorin privat. Arritja e këtij objektivi kërkon një koordinim dhe harmonizim të fortë ndërmjet të gjithë sektorëve dhe aktorëve. Prandaj, për një vend të vogël si Shqipëria, zhvillimi i ekonomisë së bazuar në dije, administrata publike efikase dhe efektive dhe përfshirja e të gjithë qytetarëve në organizimin e jetës publike, kanë një rëndësi të veçantë.

Në Shqipëri, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) po përdoren gjithnjë e më shumë si një mjet për përmirësimin e transformimit të jetës së përditshme, organizimit të punës, tregjeve ekonomike nëpërmjet mundësive dhe modeleve të reja të biznesit, pjesëmarrjes dhe ndërveprimit qytetar me qeverinë dhe drejt modeli qeverisje sa më të hapur dhe transparent. Në këtë këndvështrim, vëmendje e veçantë i kushtohet lehtësimit të të dhënave të hapura në administratën publike, me qëllim që të dhënat dhe burimet e informacionit të krijuara nga administrata publike të bëhen lehtësisht të aksesueshme për shoqërinë, duke krijuar kështu një parashtrim për promovimin e ideve, shërbimeve dhe produkteve të reja inovative.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Shqipëria, në rrugën e saj drejt shoqërisë së informacionit, ka bërë një progres të konsiderueshëm duke i dhënë prioritet investimeve në infrastrukturën e centralizuar, të cilat kanë mundësuar standardizimin e shërbimit publik, uljen e kostove të mirëmbajtjes, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve publike ndërsa kryhen proceset e sigurimit të cilësisë. Shqipëria ka qenë e para në rajonin e saj që ka zhvilluar dhe zbatuar një Platformë Qeveritare të Ndërveprueshmërisë. Kjo Platformë e Ndërveprueshmërisë Qeveritare ofron arkitekturën bazë që mundëson shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit në kohë reale ndërmjet institucioneve të administratës publike në mënyrë të sigurt dhe të besueshme. Platforma e ndërveprueshmërisë ka qenë një hap i domosdoshëm për të thjeshtuar shërbimet që shteti ofron për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, si dhe reduktimin e numrit të dokumenteve që kërkohen nga qytetarët apo biznesi për të marrë shërbime publike.

Progresi transformues i Shqipërisë është përshpejtuar drejt dixhitalizimit të plotë të shërbimeve publike me Qeverinë e Shqipërisë duke i dhënë përparësi zgjerimit të ofrimit të shërbimeve publike për të lehtësuar gjithnjë e më shumë shpërndarjen online, ku Qeveria e Shqipërisë është e vendosur t'i kthejë institucionet në shërbim të fokusuar plotësisht tek qytetarët dhe e ka përqendruar plotësisht vëmendjen në shndërrimin e sporteve fizike në ato elektronike. Portali kombëtar E-Government, e-Albania, është e vetmja pikë kontakti e cila vepron si platforma kryesore për institucionet qeveritare për të ofruar shërbimet e tyre dhe për rrjedhojë funksionon e vetmja pikë aksesit për qytetarët 24/7. Portali, i cili aktualisht ofron 1227 shërbime

elektronike, është i lidhur me Platformën e Ndërveprueshmërisë Qeveritare e cila është arkitektura bazë dhe thelbësore që lejon ndërveprimin ndërmjet 57 sistemeve elektronike të institucioneve publike. Portali e-Albania u mundëson qytetarëve të mbajnë mend vetëm një lidhje portali për gjetjen e shërbimeve publike në internet nëpërmjet një ndërfaqeje lehtësisht të aksesueshme që ofron shërbime elektronike cilësore dhe të shpejta për qytetarët dhe bizneset.

Që nga fundi i vitit 2020 të gjitha aplikimet për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset po bëhen vetëm online nëpërmjet portalit e-Albania. Deri në fund të vitit 2020, në portalin e-Albania ofrohen më shumë se 1200 shërbime publike ose rreth 95% e të gjitha aplikacioneve për shërbime publike. Të gjitha dokumentet shoqëruese të lëshuara nga shteti mblidhen nga punonjësit publikë, duke përdorur sisteme elektronike të dedikuara të zhvilluara posaçërisht për këtë qëllim dhe të vetmet dokumente që aplikantët ngarkojnë si pjesë e aplikimit të tyre online janë dokumente të lëshuara private ose vetëdeklaruese. Gjatë vitit 2022, një tjetër moment historik u regjistrua në revolucionin dixhital në rrugën e shërbimeve publike në Shqipëri. Për të gjitha shërbimet, aplikimet e të cilave po dorëzohen përmes portalit e-Albania, lëshimi i dokumentit përfundimtar ofrohet vetëm online nga data 1 maj 2022, me vlerë të plotë ligjore (e-vulosur ose e-nënshkruar).

Nga ana tjetër, qeveria ka zbatuar edhe sisteme shumëfunksionale dhe të centralizuara ku çdo institucion ka modulën e tij të sistemit të përshtatur për nevojat e tij specifike. Sistemet e trashëgimisë janë përditësuar vitet e fundit dhe shumë të tjera janë zhvilluar rishtazi. Investime të konsiderueshme janë bërë në dixhitalizimin e arkivave fizike, përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe zhvillimin e platformave të dedikuara për qarkullimin e dokumenteve elektronike të vlefshme ligjore, pajisjen e aktorëve përkatës me vulë apo nënshkrim elektronik etj.

Angazhimet

1. Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesimi në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).
2. Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë E-Albania.
3. Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb për portalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”)
4. Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve (citizen feedback) për shërbimet elektronike.

ANGAZHIM 6

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 6: Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness)

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Një portal i hapur i të dhënave është një ndërfaqe e bazuar në ueb që i mundëson kujtdo të aksesojë, të përdorë dhe të rishpërndajë të dhënat e ngarkuara në të. Portalet e të dhënave të hapura publikojnë të dhëna që kanë karakteristikat teknike dhe ligjore që lejojnë qytetarët, bizneset, organizatat joqeveritare, organizatat e shoqërisë civile, studiuesit dhe gazetarët të kenë akses në grupet e të dhënave dhe të dhënave të grupeve të të dhënave, kryesisht në formën e të dhënave numerike për t'u përdorur lirisht.</p> <p>Portali i të dhënave të hapura në Shqipëri (https://opendata.gov.al/) ofron aktualisht të dhëna të hapura nga disa sektorë – për shembull: shëndetësia, thesari, doganat, arsimi, biznesi – etj. Ky angazhim do të përmirësojë shkallën e vëllimit dhe cilësisë së të dhënave të hapura të disponueshme në portalin e të dhënave të hapura të qeverisë. Disa organe publike janë të angazhuar në mënyrë aktive me iniciativën, por kërkohet më shumë angazhim për të sjellë organe të tjera publike në bord për t'i vënë të dhënat e tyre të disponueshme si të dhëna të hapura. Kërkohet gjithashtu promovim më i madh i portalit në mesin e përdoruesve të mundshëm. Ky angazhim do të vërë në dispozicion të dhëna të reja nga institucione publike shtesë, si dhe do të zhvillojë strategji për të përmirësuar kuptimin e qytetarëve për përdorimin dhe aplikimin e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe për të rritur aksesin për qytetarët.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)
	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Konceptet e transparencës së qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies publike janë reciproke mbështetëse dhe shpesh shërbejnë si bazë për besimin e qytetarëve te qeveria, e cila nga ana e saj nxit pjesëmarrjen qytetare dhe publike. Prandaj, adresimi dhe ngritja e nivelit të transparencës në të gjitha institucionet publike është thelbësore për Shqipërinë, ku banorët kanë ndjerë prej kohësh se qeveria e tyre shfaq mungesë transparence.

Do të duhet më shumë bashkëpunim, përfshirje dhe përkushtim nga institucionet publike për të vepruar në mënyrë transparente dhe për ta bërë më të lehtë për qytetarët aksesin në informacionin dhe të dhënat e qeverisë në mënyrë që të ndryshojë kjo pikëpamje.

Të dhënat e hapura krijojnë një bazë transparente dhe të përgjegjshme për një vendimmarrje më të mirë dhe përmirësojnë ofrimin e shërbimeve publike, duke forcuar qeverisjen dhe besimin në institucionet publike dhe përgjegjësinë e qeverive për të mbështetur sundimin e ligjit.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Mungesa e transparencës mes linjave të ministrive, keqkuptimi i publikut, që na çon në pjesëmarrje të ulët të publikut dhe rënie të 'besimit në qeveri'.

Çfarë do të thotë kjo?

Siç mund ta shohim, ka mungesë angazhimi nga institucionet publike për të bashkëpunuar dhe kuptuar me të vërtetë se çfarë janë dhe çfarë përfaqësojnë Open Data, si dhe për të përshkruar dhe përcaktuar se cilat të dhëna janë më të dobishme për sitin e të dhënave të hapura.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Aktualisht, portali ofron më shumë se 91 grupe të dhënash në fushat e shëndetësisë, thesarit, buxhetit, doganave, arsimit, biznesit dhe shumë më tepër.

Ministritë dhe institucionet që kanë publikuar informacione në portal janë:

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Evropës dhe e Punëve të Jashtme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Brendshme

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik

Agjencia Kombëtare e Diasporës

Qendra Kombëtare e Biznesit

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Rritja e numrit të grupeve të të dhënave të aksesueshme përmes portalit të të dhënave të hapura forcon qeverisjen dhe besimin në institucionet publike, përforcon detyrimin e qeverive për të respektuar sundimin e ligjit dhe siguron një bazë transparente dhe të përgjegjshme për të përmirësuar vendimmarrjen dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike .

Sigurimi që të dhënat në portalin e të dhënave të hapura përmbushin normat e miratuara globalisht për publikimin e të dhënave të hapura, si më poshtë:

1. hapet si parazgjedhje
2. në kohë dhe gjithëpërfshirëse
3. të aksesueshme dhe të përdorshme
4. të krahasueshme dhe të ndërveprueshme
5. lehtëson angazhimin e qytetarëve

do të ndihmojë në ndërtimin e një kulture të hapur brenda administratës publike, do të përforcojë respektin e qeverisë për sundimin e ligjit dhe rrjedhimisht do të ndihmojë në ndërtimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike.

Ky angazhim do të vërë të dhëna të disponueshme dhe do të zhvillojë mënyra të reja për ndarjen e të dhënave të qeverisë (pika 1) që nuk kanë qenë më parë të disponueshme për publikun, duke rritur kështu llogaridhënien e institucioneve publike ndaj qytetarëve. Kjo rritje e transparencës së vendimeve dhe proceseve të qeverisë mund të ndihmojë në promovimin e llogaridhënies dhe rritjen e debatit publik. Meqenëse Portalet e të Dhënave të Hapura ndihmojnë në përmirësimin e rrjedhës së informacionit brenda dhe ndërmjet institucioneve publike, zgjerimi i të dhënave të hapura mund të lehtësojë gjithashtu përmirësimin e koordinimit dhe vendimmarrjes brenda dhe ndërmjet institucioneve publike që do të promovojnë më tej llogaridhënien dhe besimin publik.

Për t'u siguruar që zgjerimi i portalit përmbush objektivat e angazhimit, do të kryhet një vlerësim gatishmërie dhe do të hartohen fushata ndërgjegjësimi së bashku me institucionet që ofrojnë të dhëna të hapura gjatë vitit 2023, në mënyrë që të familjarizoë dhe të edukojë qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mbi gamën e plotë të aplikimeve të të dhënave të hapura dhe të shpjegojë se si portali mund të përdoret prej tyre për aplikacione të ndryshme.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Një analizë e detajuar e të dhënave aktuale të hapura të disponueshme brenda administratës publike

Kryerja e një Vlerësimi të Gatishmërisë për të Dhënat e Hapura do të ndihmojë në identifikimin dhe publikimin e një inventari të grupeve të të dhënave nga ministritë/agjencitë e përzgjedhura të linjës në Portalin e të Dhënave të Hapura. Bazuar në standardet aktuale të të dhënave të hapura në fuqi, çdo institucion apo ministri do të vlerësohet për të parë nëse zotëron të dhëna të hapura brenda sistemeve të tij elektronike në përdorim.

- Një Portal i të Dhënave të Hapura i përmirësuar dhe më miqësor për përdoruesit
Portali i të Dhënave të Hapura do t'i nënshtrohet një ridizajnimi dhe përmirësimi për të përmirësuar aksesueshmërinë dhe përdorshmërinë duke përdorur mjetet dhe

teknologjinë më të fundit të fundit për të mundësuar procedurat e mëposhtme:

1. Mbledhja e të dhënave
2. Transformimi i të dhënave
3. Projekcioni i të dhënave që përfshin publikimin e të dhënave në portal në një sërë formatesh të redaktueshme
4. Dizajnimi i të dhënave
5. Të dhënat tona përfshijnë lojëra, vizualizim, lidhje të mediave sociale, etj.
6. Përdorimi i metodave të ndryshme për të aksesuar të dhënat.

Portali Open Data do të rrisë aksesin e palëve të interesuara në mundësinë e shkarkimit të të dhënave.

Përdorimi më i mirë i të dhënave nga palët e interesuara.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Vlerësimi i gatishmërisë së të dhënave të hapura (ODRA)			Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
			Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës	
			Ministria e Financave , dhe Ekonomisë	Shoqata e para dhe tetraplegjikëve të Shqipërisë	
MD Ministria e Drejtësisë	Shoqata ‘ Ndhmoni Jetën’				
MM Ministria e Mbrojtjes	Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë				
MB Ministria e Brendshme	ANAD Instituti “Visum”				
MSh Ministria e Shëndetësisë	CARITAS Down Syndrome Albania Partnerë				

		Ministria e Arsimit dhe e Sportit	për Fëmijët Fondacioni "Se bashku:
		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK
		Ministria e Bujqësisë, dhe Zhvillimit Rural	Shoqata 'Gruaja dhe Fëmijët'
		Ministria e Infratrakturës dhe Energjisë	Qendra 'Alternativa'
		Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	Shoqata e personave me dëmtime fizike ALTRI
		Ministër i Shtetit për Standartet e Shërbimeve	Medpak World Vision Save the Children
		Dhe të gjitha Insitucionet në varësi. Lista përfundimtare do përcaktohet mbas ODRA-s.(Open Data Readiness	Partnerë për Fëmijët MJAFIT

			Assessment)		
Rritja e numrit dataseteve të aksesueshme përmes portalit të të dhënave të hapura, përmirësimi dhe promovimi i portalit			Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
			Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme		
			Ministria e Financave , dhe Ekonomisë		
			MD Ministria e Drejtësisë		
			MM Ministria e Mbrojtjes		
			MB Ministria e Brendshme		
			MSh Ministria e Shëndetësisë		
			Ministria e Arsimit dhe e Sportit		
			Ministria		

		<p>e Turizmit dhe Mjedisit</p> <p>Ministria e Bujqësisë, dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Ministria e Infratrakturës dhe Energjisë</p> <p>Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes</p> <p>Ministër i Shtetit për Standartet e Shërbimeve dhe të gjitha Insitucionet në varësi.</p> <p>Lista përfundimtare do përcaktohet mbas ODRA-s.(Open Data Readiness Assessment)</p>		
--	--	--	--	--

ANGAZHIM 7

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 7: Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë E-Albania.

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë E-Albania.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Ngjarjet e jetës janë ngjarje që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e një qytetari/palësh të interesuar dhe që garantojnë ndërgjegjësimin ose përfshirjen e qeverisë. Një ngjarje e jetës mund të jetë lindja e një fëmije, ndryshimi i statusit të punësimit, një dëmtim ose sëmundje serioze, një blerje shtëpie, një krim, një fatkeqësi natyrore ose ndjekja e një arsimimi universitar. Ka shumë më tepër shembuj të ngjarjeve të jetës që përfshijnë gamën e shërbimeve qeveritare në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ngjarjet e jetës krijojnë nevojën për shërbime qeveritare që shpesh përfshijnë agjencitë dhe nivelet e qeverisjes. Për shembull, kur ndodh një fatkeqësi natyrore, burimet lokale, shtetërore dhe qeveritare mund të nevojiten për të ndihmuar të lënduarit, për të rivendosur sigurinë, për të rindërtuar infrastrukturën dhe për të rinovuar ekonomitë lokale.</p> <p>Në të gjitha këto raste, vjen në ndihmë një pikë e vetme kombëtare kontakti. Duke qenë se e-Albania është portali kombëtar i e-Government, që vepron si porta e vetme dixhitale e marrjes së shërbimeve publike, ky angazhim do të synojë hartimin e funksionaliteteve të reja për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, përvojës së përdoruesit dhe ndërfaqes. Kjo përfshin riorganizimin sipas ngjarjeve të jetës dhe pro-aktivitetin e shërbimeve. Shërbimet publike elektronike proaktive do t'u përgjigjen ngjarjeve të jetës që kërkojnë burokraci minimale.</p> <p>Nëpërmjet shërbimeve proaktive dhe të bazuara në ngjarje të jetës, ky angazhim do të ndihmojë shërbimet publike që të kontaktojnë drejtpërdrejt me njerëzit në vend që të presin që ata të vijnë në qeveri.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

- Shërbimet elektronike në e-Albania ndahen në kategori, gjë që nuk është gjithmonë e lehtë dhe intuitive për përdoruesit për të gjetur shërbimin e duhur.

- Pritjet gjithnjë në rritje të përdoruesve

Përvoja e përdoruesit dhe inovacioni i kompanive më të mira të teknologjisë dhe startup-eve janë ato që pret publiku nga shërbimet e tyre qeveritare: ato duhet të jenë të thjeshta për t'u përdorur, të personalizuar, të padukshme dhe të lëvizshme. Strategjia jonë për krijimin e shërbimeve me në qendër përdoruesin duhet të vijë nga aftësia jonë për të qenë të shkathët dhe për të pasur një menaxhim efektiv të produktit. Ne do t'u drejtohem njerëzve kur qeveria mund të ndihmojë në vend që të presim që ata të vijnë tek ne përmes programeve proaktive dhe të bazuara në ngjarje të jetës.

- Shpërndarja e vlerës.

Si një komb i vogël, ne duhet të përdorim shpikjen për të kompensuar disavantazhin tonë të madhësisë. Qeveria duhet të veprojë si një platformë për sektorët e korporatave dhe jofitimprurëse, duke përdorur të dhëna dhe teknologji për të çuar përpara përfshirjen sociale, kujdesin shëndetësor dhe arsimin, ndërsa na përgatit për çështje si tranzicioni në një ekonomi më të gjelbër dhe një popullsi në plakje. Ndërsa përgatitemi për dekadën e ardhshme të qeverisjes dixhitale, ne do të ruajmë burimin tonë më të vlefshëm: besimin dhe besimin e përdoruesve tanë, i cili nga ana e tij inkurajon adoptimin pothuajse universal të shërbimeve dhe infrastrukturës dixhitale.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka zbatuar më shumë se 1227 shërbime online në portalin e qeverisë e-albania. Niveli i përdorimit të teknologjisë së informacionit nga përdoruesit në Shqipëri është shumëdivers, duke nisur nga shumë faktorë si mosha, njohuritë e përdorimit të teknologjisë së informacionit etj.

Këto shërbime aktualisht janë të ndara vetëm me kategorizim, gjë që e bën shumë të vështirë për përdoruesin gjetjen e shërbimit specifik të kërkuar. Duhet të theksojmë gjithashtu se mënyra se si është formuluar titulli dhe përshkrimi i shërbimit anon më shumë drejt formulimit zyrtar dhe për rrjedhojë qytetarët e kanë të vështirë të gjejnë një shërbim specifik.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

e-Albania vepron si një pikë ballore për institucionet qeveritare për të ofruar shërbimet e tyre, duke funksionuar si një pikë aksesi e vetme për qytetarët për marrjen e shërbimeve qeveritare online, si dhe informacionin mbi shërbimet publike 24/7. Duke ofruar më shumë se 1200 shërbime elektronike, portali ka përmirësuar aksesin e informacionit për shërbimet publike, nivelin e ndërgjegjësimit të publikut për procedurat e ofrimit të shërbimeve publike dhe më e rëndësishmja ka vepruar si një katalizator i fuqishëm në uljen e radhëve në pritjet e agjencive publike, reduktimin e

korruptionit dhe burokracisë, sigurimin e barazisë së qytetarëve, uljen e kohës për marrjen e shërbimeve dhe promovimin e transparencës së qeverisë.

Të gjitha 1227 shërbimet elektronike të ofruara në portal i dedikohen një game të gjerë përdoruesish, nga qytetarët e papunë, shoferët, pronarët e pronave, nxënësit, të moshuarit, shqiptarët jashtë vendit, bizneset, punonjësit e shoqërisë civile etj. Këto shërbime klasifikohen gjithashtu në kategori (shëndet, ekonomi, arsim, etj.) dhe janë gjithashtu të kërkueshme përmes shiritit të kërkimit.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është angazhuar për të ridizajnuar dhe riorganizuar platformën e-Albania bazuar në modelin e ngjarjeve të jetës. Gjatë vitit 2023, do të bëhet një analizë e thellë për të identifikuar ngjarjet e mundshme të jetës që do të zbatohen. Pas kësaj analize, do të punohet për fillimin e zbatimit të ngjarjeve të jetës dhe parashikimin e të gjitha ndryshimeve administrative, ligjore dhe teknike përkatëse në ofrimin e e-shërbimeve përkatëse dhe infrastrukturës së tyre mbështetëse. Këto zhvillime do të tregojnë gjithashtu një përmirësim të përgjithshëm të proceseve të brendshme për ofrimin e shërbimeve elektronike. Njëkohësisht, parimet e harmonizimit dhe koordinimit do të zbatohen në mënyrë të barabartë për proceset e biznesit dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet agjencive qeveritare për t'u mundësuar njerëzve të menaxhojnë një ngjarje të jetës. Synimi i politikës do të vendosë shiritat mbrojtës për ofrimin e shërbimit, duke çuar në vendimet se kur të harmonizohen dhe kur të koordinohen

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Riorganizimi i shërbimeve elektronike në përputhje me modelin e ngjarjeve të jetës do t'i ndihmojë përdoruesit të gjejnë më shpejt shërbimet elektronike që u nevojiten dhe do të prodhojë shërbime më efektive, efikase, të orientuara nga njerëzit, që do të plotësojnë kërkesat e tyre dhe do të rrisin kënaqësinë e tyre me shërbimet publike.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Identifikimi i ngjarjeve të mundshme të jetës që do të zbatohen në portalin e-Albania	Dokument Analize	6 M II 2023	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OS HC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
			Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Brendshme Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Ministria e Financave dhe Ekonomisë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) Drejtoria e		

			<p>Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)</p> <p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)</p> <p>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)</p> <p>Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)</p> <p>Ministria e Mbrojtjes</p> <p>Qendra e Personel Rekrutimit (QPR)</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</p>		
--	--	--	--	--	--

			Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor		
Implementimi i të paktën një Ngjarje jete në portalin e-Albania deri në 2024	Një kategori Ngjarje Jete e implementuar	2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OS HC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
			Ministria e Arsimit dhe Sportit		
			Ministria e Brendshme		
			Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)		
			Ministria e Drejtësisë		
			Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve		
			Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
			Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)		
			Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)		

		<p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)</p> <p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)</p> <p>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)</p> <p>Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)</p> <p>Ministria e Mbrojtjes</p> <p>Qendra e Personel Rekrutimit (QPR)</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</p> <p>Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor</p>		
--	--	---	--	--

ANGAZHIM 8

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 8: Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb për portalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”)

Vendi	Shqipëri
Emërtimi i angazhimit	Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb për portalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”)
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.276 datuar më 12.5.2021 me “Aprovimin Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025”, Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me ridizajnimin e faqeve të internetit të institucioneve publike për t'i bërë ato të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>Aktualisht, disa përmirësime teknike janë bërë në faqet e internetit të ministrive, duke u lejuar atyre me aftësi të kufizuara t'i qasen më lehtë.</p> <p>Masat e parashikuara në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025, lidhen më gjerësisht me përmirësimet në kuadrin ligjor si dhe me përmirësimet teknike, si zhvillimi/përshtatja e standardeve për sigurimin e aksesit në internet, për të siguruar që personat me aftësitë e kufizuara kanë akses të barabartë në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e tyre.</p> <p>Në vijim, do të kryhen zbatime teknologjike në e-albania për të përshtatur portalin me të gjitha tiparet e kërkesave të individëve me kapacitet për të garantuar akses të barabartë.</p> <p>Që nga viti 2019, të gjitha faqet zyrtare të internetit të ministrive kanë funksione të veçanta të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara për të lehtësuar aksesin në informacion mbi shërbimet e ofruara nga institucionet publike si:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Zmadhimi (Ndhmon kategorinë e personave që kanë shikueshmëri të kufizuar)2. Kontrasti (Ndhmon kategorinë e personave disleksikë)3.

	<p>Navigimi në TAB (Ndihton kategorinë e paraplegjikëve)</p> <p>Gjithashtu, portali qeveritar e-Albania i mundëson çdo qytetari të aplikojë online për 1225 shërbime publike dhe shpeshherë të kryejë shërbimin e tyre online ose të tërheqë dokumente me vlerë të plotë ligjore pa qenë nevoja të largohet nga shtëpia. Këta janë vetëm hapat e parë, por premtues, për përfshirjen dhe aksesin e të gjithëve në informacionin publik dhe shërbimet publike.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Platforma e-Albania ofron më shumë se 1225 shërbime online, siç kemi raportuar më parë. Kjo nënkupton që

Platforma e-Albania trajton 95% të të gjitha kërkesave për shërbime publike. Portali e-Albania ofron shërbime elektronike të shkëlqyera dhe të shpejta për njerëzit dhe bizneset, duke i lejuar qytetarët të kujtojnë vetëm një portal kur kërkojnë shërbime publike online. Për të ndihmuar popullsinë dhe për të ofruar shërbime për të gjithë, ka gjithmonë hapësirë për zhvillim dhe prezantim të ideve të reja. Nëpërmjet kësaj, ne shpresojmë të komunikojmë qëllimet tona për:

rritjene aksesit të shërbimeve elektronike të platformës e-Albania për personat me aftësi të kufizuara.

Veprimet e planifikuara në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara janë më qartë të rëndësishme për përmirësimet e kuadrit ligjor si dhe përmirësimet teknike, si zhvillimi/përshtatja e standardeve për garantimin e aksesit në internet, për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtja e tyre.

Në vijim, zbatimet teknike në e-albania do të zbatohen për të përshtatur portalin me të gjitha nevojat e personave me aftësi për të ofruar akses të barabartë.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Duke qenë se e-Albania është portali kryesor që ofron shërbime publike për këdo nëçdo kohë, është përgjegjësia jonë ta përfundojmë këtë detyrë dhe të mos lëmë askënd pas. Është e nevojshme që shërbimet dhe platforma të jenë të aksesueshme për të gjithë, përfshirë edhe ata që kanë aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit po bashkëpunon me institucionet për individët me aftësi të kufizuara për ta bërë këtë qëllim realitet në të ardhmen e afërt. Procesi i hartimit dhe zbatimit të funksionaliteteve dhe standardeve që do të lehtësojnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara ka nisur në kuadër të përmirësimit të standardeve për aksesin në ueb të faqeve të internetit të qeverisë, si dhe për platformën qeveritare e-Albania dhe shërbimet e saj elektronike, duke mbështetur dhe duke ndihmuar në pavarësinë e tyre, pjesëmarrjen në punësim, lëvizshmërinë, teknologjinë dhe komunikimin.

Konkretisht, Plani i Veprimit është:

- Përshtatja e standardeve ndërkombëtare për të siguruar akses në TIK në portalet dhe sportelet qeveritare.

- Marrja e masave që pajisjet dhe shërbimet publike të jenë të aksesueshme për personat me dëmtime të shikimit, me probleme dëgjimi, vështirësi në lëvizje, si dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale duke përdorur:

- a) simbol universal;
- b) programe që lejojnë personat me dëmtime në shikim të lexojnë;
- c) pajisje zanore;
- d) ofrojë aplikacione që lejojnë përdoruesit me probleme vizuale të zmadhojnë tekstin dhe madhësinë e ikonës;
- e) të jetë i pajisur me lexues dhe printera të kodit Braille (në një numër të arsyeshëm).

- Zbatimi i standardeve të aksesueshmërisë në portalin <https://e-albania.al> dhe të gjitha portalet e tjera interaktive publike. Një theks i veçantë do t'i kushtohet komunikimit emergjent/emergjent.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb për portalet qeveritare. Mbështetja e zbatimit të Direktivës, për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve dhe palëve të interesuara dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira në fushën e aksesit në internet.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Në vijim të shkresës nr.244 Prot., datë 30.09.2021, me temë“Bashkëpunimi për standardet në rritjen e aksesueshmërisë” nga Instituti i Studentëve të Verbër, i cili ka shprehur gatishmërinë për t'u përfshirë në këtë proces, si dhe në bazë të Këshillit. Vendimi

i Ministrave nr.673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, dhe VKM nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025”, procedojmë si më poshtë:

Në kuadër të përmirësimit të standardeve për aksesueshmërinë në ueb të faqeve qeveritare si dhe për platformën qeveritare e-Albania dhe shërbimet e saj elektronike, është e nevojshme nisja e procesit për hartimin dhe zbatimin e funksionaliteteve dhe standarde që do të lehtësojnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara, duke promovuar dhe ndihmuar në pavarësinë e tyre, përfshirjen në punësim, lëvizje, teknologji dhe komunikim

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesin në ueb për portalet qeveritare në bazën ligjore shqiptare	Baza e re ligjore në fuqi për të mundësuar zhvillime teknike në përputhje me standardet e BE-së		Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës Shoqata e para dhe tetraplegjikëve të Shqipërisë Shoqata ‘Ndihmoni Jetën’ Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ANAD Instituti “Visum” CARITAS Down Syndrome Albania				

			Partnerë për Fëmijët Fondacioni "Se bashku: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK Shoqata 'Gruaja dhe Fëmijët' Qendra 'Alternativa' Shoqata e personave me dëmtime fizike ALTRI Medpak World Vision Save the Children Partnerë për Fëmijët MJAFT		
			Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)

--	--	--	--	--	--

ANGAZHIM 9

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 9: Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve (citizen feedback) për shërbimet elektronike

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve (citizen feedback) për shërbimet elektronike.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Feedback-u i qytetarëve do të mbledhë komentet e përdoruesve mbi efektivitetin e shërbimeve elektronike duke përdorur zgjidhjet më të fundit CivicTech me një kosto minimale, si dhe do të analizojë automatikisht komentet për t'u dhënë anëtarëve të stafit informacion të saktë mbi atë që duhet përmirësuar.</p> <p>Feedback-u i qytetarëve mundëson përfshirje qytetare dhe angazhim më të informuar ndërmjet qeverive dhe qytetarëve. Gjithashtu siguron një kuadër të hapur dhe të përgjegjshëm për vendimmarrje më të mirë dhe rrit besimin e publikut.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Që nga viti 2013, Qeveria e Shqipërisë është përpjekur të rikrijë ofrimin e shërbimeve publike për të përmbushur më mirë nevojat e qytetarëve, për të përmirësuar kënaqësinë e qytetarëve dhe për të përmirësuar aksesin ndaj grupeve të marginalizuara. Qeveria shqiptare, si promotore e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e ktheu platformën e-Albania në një histori suksesi dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rikthejë besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Qeveria transformoi shërbimet institucionale në dispozicion të plotë për qytetarët dhe bizneset dhe ka fokusuar plotësisht vëmendjen e saj në konvertimin e sporteve fizike vetëm në ato online. Për sa i përket ndikimit, kjo është përkthyer në:

- reduktimin e kostove të marrjes së shërbimeve,
- thjeshtimi i procedurave burokratike,
- reduktimi i kohës për të marrë shërbime,
- përmirësimi i transparencës dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Për të marrë reagime të vazhdueshme nga qytetarët dhe bizneset që përdorin shërbimet elektronike në portalin e-Albania, është zbatuar një mekanizëm për vlerësimin e yjeve gjatë aplikimit për shërbimet elektronike. Nëpërmjet këtij funksioni, përdoruesit mund të japin vlerësimin e tyre me një rezultat nga 1 deri në 10 yje dhe të shkruajnë një koment për të shpjeguar përvojën e tyre më gjerësisht në portal. Megjithatë, të dhënat nuk janë analizuar në mënyrë adekuate për t'i ofruar institucioneve publike të dhëna të sakta se çfarë mund të përmirësohet në ofrimin e shërbimeve të tyre.

Tani shërbimet ofrohen ekskluzivisht online dhe qytetarët mund t'i marrin ato vetëm përmes këtij kanali. Kjo tregon se ne duhet të forcojmë procedurat tona për mbledhjen e komenteve të qytetarëve për vlerësimet e shërbimeve elektronike në mënyrë që të përmirësojmë cilësinë e shërbimit publik.

Objektivi parësor është sigurimi i kriterëve të vlerësimit për një vlerësim efektiv, fleksibël dhe reflektues të sistemeve të qeverisjes elektronike nga këndvështrimi i qytetarëve. Miratimi i standardeve të tilla do të ndihmonte në përmirësimin e të kuptuarit të qeverisë për elementët që ndikojnë në përdorimin publik të shërbimeve të qeverisjes elektronike. Për më tepër, kërkesat mund të përdoren për të ofruar reagime të rëndësishme për hartimin e përpjekjeve të ardhshme të qeverisjes elektronike.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni kyç që mundëson shërbimet publike elektronike për qytetarët dhe bizneset, do të ndërmarrë iniciativa për të forcuar ndërveprimin e publikut me institucionet nëpërmjet mekanizmit më të fundit të feedback-ut duke përdorur GovTech. Si rezultat, besimi i publikut dhe efikasiteti i punës do të përmirësohet.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Më poshtë janë disa nga pasojat e kësaj mungese:

1. Pasiguria e qytetarëve për atë që kërkojnë.
2. Informacion i pamjaftueshëm.
3. Komunikimi i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve dhe publikut të gjerë

Qytetarët kanë mundësinë të japin komente kur shërbimet ofrohen vetëm online, por analiza e vlerësimeve të tyre bëhet me dorë, gjë që nuk jep rezultatet më të mira të mundshme për korrigjimin e shqetësimeve.

Aspektet teknike ose procedurale të ofrimit të shërbimeve që duhen përmirësuar

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Për të marrë reagime të vazhdueshme nga qytetarët dhe bizneset që përdorin shërbimet elektronike në portalin e-Albania, në fund të aplikacionit apo shërbimeve elektronike është zbatuar një mekanizëm vlerësimi me yje. Nëpërmjet këtij funksioni, përdoruesit mund të japin vlerësimin e tyre me një rezultat nga 1 deri në 10 yje dhe të shkruajnë një koment tregimtar për të shpjeguar përvojën e tyre më gjerësisht në portal.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Mbledhja e komenteve të faqes në internet nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme. I gjithë qëllimi për ta bërë këtë është t'u ofrohet qytetarëve qasje më të lehtë në shërbime duke përmirësuar efikasitetin operacional për qeverinë.

Mbledhja e komenteve

Mbledhja e komenteve mund të bëhet vetëm në internet. Kjo mund të përfshijë krijimin e sondazheve brenda faqes për qytetarët ku ata mund të japin komente për shërbime të caktuara.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Kjo do të ndihmojë përdoruesit dhe do të prodhojë vlerë, duke forcuar gjithashtu sigurinë midis qytetarëve dhe qeverisë. Kjo zgjidhje e integruar do të sigurojë gjithashtu qëndrueshmëri në aspektin e teknologjisë, funksionalitetit dhe sigurisë për përdoruesit e emailit.

Duam të nënvizojmë se kjo do të na ndihmojë shumë në përmirësimin e shërbimeve online duke i krijuar ato për të përmbushur nevojat e qytetarëve.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Takime me përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Start-upeve të cilët mbulojnë dhe çështje të digjitalizimit.	Përmirësime në portal nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm		Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et)
			Ministri a për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës	X
			Ministri a e Financa ve, dhe Ekonomisë	Shoqata e para dhe tetraplegjikëve të Shqipërisë	
MD Ministri a e Drejtësisë	Shoqata ‘ Ndhmoni Jetën’				
MM Ministri a e Mbrojtjes	Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë				
MB Ministri a e Brendshme	ANAD				
MSh	Instituti “Visum”				
	CARITAS				
	Down Syndrome Albania				

		Ministri a e Shëndet ësisë	Partnerë për Fëmijët	
		Ministri a e Arsimit dhe e Sportit	Fondacioni "Se bashku: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK	
		Ministri a e Turizmit dhe Mjedisit	Shoqata 'Gruaja dhe Fëmijët'	
		Ministri a e Bujqësis ë, dhe Zhvillim it Rural	Qendra 'Alternativ a' Shoqata e personave me dëmtime fizike	
		Ministri a e Infratru kturës dhe Energjis ë	ALTRI Medpak World Vision	
		Ministër Shteti për Mbrojtje n e Sipërma rrjes	Save the Children Partnerë për Fëmijët	
		Ministër i Shtetit për Standart et e Shërbim eve	MJAFT	
		Të		

			gjitha institucionet të cilat ofrojnë shërbime online në e-Albania		
			Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)

ANGAZHIM 10

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 10: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH, si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Mbrojtjes ndër objektivat e saj ka nxitjen e inovacionit në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes për rritje të efikasitetit në procese, sisteme dhe mjete, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike dhe përmirësimin e performancës së sistemeve të MM/FA sipas standardeve të NATO-s si dhe përmirësimin nëpërmjet inovacionit të shërbimit të komunikimit, monitorimit, zbulimit apo planifikimit në strukturat e sigurisë në vend dhe ekosistemit të start-upeve në sektorët e lidhur.

Nëpërmjet ofrimit të infrastrukturës së nevojshme për krijimin e lidhjeve midis shkencës dhe industrisë, Qendra e Inovacionit në Ministrinë e Mbrojtjes, do t'i përgjigjej nevojave të ekosistemit të teknologjisë dhe inovacionit në sektorë si mbrojtja, mbrojtja civile, siguria kibernetike si dhe më gjerë.

Qendra e Inovacionit (Hub) në Ministrinë e Mbrojtjes konsiderohet një komunitet ku njerëzit mund të bashkëpunojnë lehtësisht.

Misioni i Qendrës është të sjellë disa zgjidhje të para për problemet që has ky sektor, duke përfshirë problemet që mund të lindin në nivel NATO.

Qendra e Inovacionit është e fokusuar në zhvillimin e ideve të reja dhe startup-eve duke inkurajuar inovacionin dhe sipërmarrjen, duke stimuluar kërkesën në fushat e sigurisë kombëtare, mbrojtjes civile dhe sigurisë kibernetike, dhe duke ndërtuar lidhje ndërmjet aktorëve të rëndësishëm të ekosistemit, si akademia, industria, think-tanket, OJQ dhe organizata joqeveritare.

Qendra e Inovacionit do të jetë e hapur për publikun, pra nuk ndodhet në të njëjtin vend me Ministrinë e Mbrojtjes, por do të vendoset pranë Muzeut të ri të Forcave të Armatosura. Është shumë i përshtatshëm sepse ky vend është në mes të natyrës dhe komunitetet kryesore, si akademia, industria dhe ushtria mund të bashkëjetojnë lehtësisht së bashku.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Ministria e Mbrojtjes përfshihet për herë të parë në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Në datën 8 janar 2023 Ministri Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i SHPFA gjeneral brigade Kingji dhe drejtori i AKMC, Çako prezantuan në një konferencë për mediat dhe organizata të shoqërisë civile arritjet gjatë vitit 2022 si dhe objektivat e projektet e reja për vitin 2023.

Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), Aleanca Kombëtare e ushtarakëve të Shqipërisë (AKUSH), Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Xhenier të Shqipërisë, Ushtarët e Dëmtuar dhe të Aksidentuar gjatë Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak, Organizata e Veteranëve të LANC të Popullit Shqiptar (Komiteti i veteranëve), Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL), Organizata Kombëtare e Familjeve të LANC-it dhe Dëshmorëve të Tjerë të Atdheut si dhe ekspertë të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes, në një trajtim të veçantë, ftoi të pranishmit në bashkëpunim aktiv dhe dhënie kontributi në realizimin e tyre, duke theksuar nevojën e bashkëpunimit të ngushtë me shoqërinë civile veçanërisht në hartimin e dokumenteve strategjike të mbrojtjes dhe sigurisë dhe vendosjen e objektivave strategjike, të cilat do të jetësohen përgjatë këtij viti.

Në datën 13 janar Ministria e Mbrojtjes shpalli për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupe interesi dhe publikun e gjerë, pyetësin paraprak për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur. (16 organizata, 2 akademike, 13 institucione)

Ky pyetësor u hartua nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes, në konsultim me Drejtorinë e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit.

Pas miratimit të angazhimit prioritar, pas vlerësimit të rezultateve të pyetësorit, në datën 24 shkurt 2023 u organizua nga Ministria e Mbrojtjes takimi/konsultimi online me organizata të shoqërisë civile mbi aktivitetet e propozuara nga MM në zbatim të angazhimit të ndërmarrë, si dhe mbi propozimet e tyre lidhur me këtë angazhim.

Paraprakisht, nëpërmjet email-it organizatat ishin njohur me draftin e aktiviteteve, i cili iu dërgua për konsultim dhe sugjerime 12 organizatave, si dhe ishin rikujtuar për datën e zhvillimit të takimit.

Drafti i aktiviteteve u hartua nga Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak J-9 në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe u konsultua me struktura të tjera të varësisë të MM-së.

Në këtë takim morën pjesë tre organizata: Shoqata Kombëtare për teknologjinë e informacionit

dhe komunikimit (ALBICT), Dhoma Ekonomike e Gruas dhe Oficina.

Gjatë takimit u prezantua draft Plani i Aktiviteteve në zbatim të angazhimit prioritar të MM-së, dhe u diskutua lidhur me bashkë-angazhimin e këtyre shoqatave në përmbushje të prioritetit. Propozimet e MM-së gjetën miratimin e pjesëmarrësve si dhe propozimet e organizatave u pasqyruan në Planin e Aktiviteteve të paraqitur nga MM-ja.

4. Angazhimet

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik

ANGAZHIM 10

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 10: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH, si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut janë me rëndësi sepse lehtësojnë veprimtarinë e institucioneve publike dhe bashkëpunimin e tyre me qytetarët në fushën e Mbrojtjes dhe sigurisë, rrit mundësinë për rekrutime cilësore në këtë fushë, mundëson angazhime transparente dhe efektive.</p> <p>Nëpërmjet ofrimit të infrastrukturës së nevojshme për krijimin e lidhjeve midis shkencës dhe industrisë, Qendra e Inovacionit në Ministrinë e Mbrojtjes, do t'i përgjigjej nevojave të ekosistemit të teknologjisë dhe inovacionit në sektorë si mbrojtja, mbrojtja civile, siguria kibernetike si dhe më gjerë.</p> <p>Qendra e Inovacionit (Hub) në Ministrinë e Mbrojtjes konsiderohet një komunitet ku njerëzit mund të bashkëpunojnë lehtësisht.</p> <p>Misioni i Qendrës është të sjellë disa zgjidhje të para për problemet që has ky sektor, duke përfshirë problemet që mund të lindin në nivel NATO.</p> <p>Qendra e Inovacionit është e fokusuar në zhvillimin e ideve të reja dhe startup-eve duke inkurajuar inovacionin dhe sipërmarrjen, duke stimuluar kërkesën në fushat e sigurisë kombëtare, mbrojtjes civile dhe sigurisë kibernetike, dhe duke ndërtuar lidhje ndërmjet aktorëve të rëndësishëm të ekosistemit, si akademia, industria, mendimi. -tanke, OJQ dhe organizata joqeveritare.</p> <p>Qendra e Inovacionit do të jetë e hapur për publikun, pra nuk ndodhet në të njëjtin vend me Ministrinë e Mbrojtjes, por do të vendoset pranë Muzeut të ri të Forcave të Armatosura. Është shumë i përshtatshëm sepse ky vend është në mes të natyrës dhe komunitetet kryesore, si akademia, industria dhe ushtria mund të bashkëjetojnë lehtësisht së bashku.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Mbrojtjes		
Grupet e Interesit që mbështesin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektori Privat, etj)

angazhimin	Ministria e Mbrojtjes	Shoqata Kombëtare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (ALBICT), Dhoma Ekonomike e Gruas dhe Oficina.
Periudha e implementimit	2023-2025	

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Nëpërmjet këtij angazhimi synohet:

1. Njohja e publikut të gjerë me zhvillimet e reja në Forcat e Armatosura, hapat në inovacionin teknologjik që po ndërmeret Mbrojtja, dhe ndërveprimi me aktorë të interesuar në këtë fushë.
2. Nxitja e inovacionit në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes përmjet efektivitetit të proceseve, sistemeve dhe jetesipasstandardeve NATO-s.
3. Pjesëmarrja në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe vendimeve në lidhje me mbrojtjen dhe inovacionin në fushën e sigurisë, të një sërë aktorëve, qofshin institucione shtetërore apo media, grupe interesi dhe shoqëri civile në përgjithësi, duke garantuar që politikën dhe vendimet të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat strategjike, dhe që problemet të mund të identifikohen që në një fazë të hershme.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Mungesa e një kulture inovative brenda strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Forcave të Armatosura (FA).

Për vetë natyrën e institucionit, publiku përballet me mbrojtjen dhe sigurinë vetëm në raste emergjence dhe nuk e njeh mire veprimtarinë institucionale të saj. Kontaktet e Ministrisë së Mbrojtjes me publikun e gjerë janë të limituara.

Mungesa e informimit vihet re edhe në numrin e ulët të kandidatëve që zgjedhin Forcat e Armatosura si alternativë për edukimin apo punësimin e tyre të ardhshëm.

Numri rekrutimeve për vitet 2020-2022 ka patur trendin si vijon: 49.64%; 58.71%; 55.71% të vendeve vakante në pozicionin e ushtarit aktiv dhe trendin 113.33%; 116.00%; 77.50% të vendeve vakante në pozicionin e oficerit të rinj.

Përshkrimi i Angazhimit

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Është rritur transparencja institucionale nëpërmjet thjeshtësisimit të gjuhës së komunikimit me publikun e gjerë, organizimin e fushatave të komunikimit duke përdorur gjerësisht rrjetet sociale, publikimit proaktiv lidhur me organizimin dhe funksionimin e Institucionit; intensifikimi i fushatave të rekrutimit.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

- *Hapja e Qendrës së Inovacionit;*
- *Intensifikimi i komunikimit me publikun e gjerë në të gjithë format (të drejtëpërdrejtë apo online nëpërmjet platformave dhe aplikacioneve) në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë;*
- *Rritja e bashkëpunimit me akademitë në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.*

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Ngritja dhe forcimi i Qendrës së Inovacionit;
- Ngritja dhe forcimi i Qendrave të reja të rekrutimit;
- Publik i gjerë më i informuar, Rritje e transparencës,
- Nxitja e inovacionit në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes për rritje të efikasitetit në procese, sisteme edhe mjete;
- Rritjen e sigurisë kibernetike dhe përmirësimin e performancës së sistemeve të MM/FA sipas standardeve të NATO-s;
- Përmirësimi nëpërmjet inovacionit të shërbimit të komunikimit, monitorimit, zbulimit apo planifikimit në strukturat e sigurisë në vend;
- Fuqizimi i kapaciteteve të përpunimit dhe analizës së imazherisë satelitore, Fotogrametrisë dhe Gjeodezisë;
- Fuqizimin e ekosistemit të start-upeve në sektorët e lidhur.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Zhvillimi i ideve inovative në bashkëpunim me aktorët dhe programet më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare të inovacionit, dhe aktoret e shoqërisë civile.	Hapja e Qendrës së Inovacionit në Siguri dhe Mbrojtje (QISM) në Ministrinë e Mbrojtjes	6 M II 2023	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
Ministria e Mbrojtjes	Shoqata Kombëtare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (ALBICT); Dhoma Ekonomike e Gruas; Oficina.				
Rritjen e informimit të qytetarëve mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik.	2 Fushata komunikimi/informimi të MM-së dhe FARSH-it mbi veprimtarinë e Mbrojtjes	2024- 6 M I 2025	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)

		Ministria e Mbrojtjes	Shoqata Kombëtare për teknologjinë e informacion it dhe komunikimi t (ALBICT); Dhoma Ekonomike e Gruas; Oficina; Shoqatat e Ushtarakëve në Rezervë dhe Pension	Media
--	--	-----------------------------	--	-------

ANGAZHIM 11

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 11: Ngritja e Bazës së të Dhënave për organizatat rinore

1. Pjesa hyrëse

Qeveria Shqiptare synon vendosjen e rinisë në qendër të zhvillimit të vendit dhe rritjes së mundësive, shërbimeve dhe mbështetjes së gjithanshme të tyre. Për përparimin e këtyre përpjekjeve është krijuar një portofol i dedikuar ministri shteti për rininë dhe fëmijët, përgjegjës ndër të tjera, për të nxitur dhe lehtësuar bashkëveprimin ndërqeveritar, të pushtetit vendor, donatorëve, organizatave rinore dhe vetë të rinjve. Organizatat e shoqërisë civile janë aktorë të rëndësishëm që plotësojnë hapësirat e pa mbuluara nga institucionet shtetërore në çështjet e rinisë dhe mund të rrisin efektivitetin e politikave dhe programeve shtetërore përmes ndikimit dhe lidhjeve të tyre në territor. Shteti e ka njohur këtë rol dhe vetë Ligji për rininë ka përcaktuar dy tipologji OJF-sh, “organizata rinore” dhe “organizata për të rinjtë”, që kanë mundësi të përfitojnë nga granti shtetëror për rininë, për të mbështetur veprimtarinë e tyre në përfaqësimin, mbrojtjen dhe avancimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse. Nga ana tjetër, ligji për rininë ka përcaktuar ngritjen e disa strukturave të posaçme si Këshilli Kombëtar i Rinisë, Këshillat Rinore Vendore dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, që i mundësojnë të rinjve dhe përfaqësuesve të ojf-ve rinore dhe për të rinjtë, të përfshihen në mënyrë të strukturuar në konsultimin e politikave dhe nismave rregullatore në fushën e rinisë.

Ministri i shtetit për rininë dhe fëmijët ka synuar dhe siguruar ndërmarrjen e proceseve gjithëpërfshirëse të konsultimit me aktorët shoqërorë për nismat kryesore të lidhura me rininë. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe plani i saj i veprimit u miratuan me vendimin Nr.692, datë 26.10.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2029” si instrumentet kryesore për përgatitjen dhe financimin e politikave rinore integruese në vend. Gjatë këtij procesi, MSHRF angazhoi dhe mori mendimet e mbi 1500 të rinjve, përfaqësuesve të 45 organizatave rinore dhe për të rinjtë, punonjësve rinor dhe aktorëve të tjerë që mbështesin dhe punojnë me rininë, duke i kthyer këto aktorë nga zbatues në bashkë autorë të vendimmarrjes më të rëndësishme për këtë fushë.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, ka përcaktuar detyrimin për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë, si një instrument i nevojshëm për të siguruar informacion të përditësuar në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend, si edhe për të mbështetur procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka parashikuar gjithashtu nevojën prioritare për ngritjen së këtij instrumenti, përmes një masë të veçantë: *Nr. 1.3.3. Në përputhje me ligjin nr.75, datë 04.11.2019 “Për Rininë” zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për të rinjtë duke përfutuar edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.*

Kuadri ligjor për ngritjen Bazës së të Dhënave për Rininë është miratuar nga Këshilli i Ministrave përmes vendimit Nr. 833, datë 24.12.2021 “Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore”.

Përshirja e angazhimit për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë në Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023-2025 dhe zbatimi i tij në bashkëpunim me OSHC-të rinore dhe për të rinjtë do të sigurojë ngritjen e një baze të dhënash që i shërben në mënyrë të përshtatshme institucioneve shtetërore në proceset vendimmarrëse dhe aktorëve të

jashtëm në punën e tyre, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien publike në fushën e rinisë.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Ministri i shtetit për rininë dhe fëmijët në përputhje me kompetencat e veta inicioi dhe udhëhoqi procesin e bashkëbërjes me organizatat e shoqërisë civile rinore dhe për të rinjtë të angazhimeve prioritare në fushën e rinisë në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2023-2025. Megjithatë ngritja e bazës së të dhënave për rininë përbën angazhimin e parë formal në fushën e rinisë në raport me historikun e nismës së PQH-së në Shqipëri, fryma dhe procesi i bashkëkrijimit me aktorët e jashtëm përbëjnë një praktike të rrënjësuar në veprimtarinë e MSHRF.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe organizatat e shoqërisë civile rinore dhe organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë ndërmorën procesin e bashkë-bërjes për nismat në fushën e rinisë që do propozoheshin angazhime të Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, të PQH-së, në përputhje me rregulloren e OGP dhe parashikimet e urdhrin nr. 177, datë 28.10.2022, të Kryeministrit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komunitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisjen e Hapur”.

Ky proces u zhvillua sipas këtyre fazave:

4- Harimi dhe konsultimi i propozimeve për angazhimet prioritare për fushën e rinisë.

Bazuar në vlerësimin mbi objektivat e nismës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur, MSHRF identifikoi dy angazhime potenciale për tu përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit 2023-2025, përkatësisht: *Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”* dhe *Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë*.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatiti pyetësoin për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar dhe e publikoi për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupet e interesit dhe publikun e gjerë në faqen zyrtare elektronike të institucionit.

Pyetësori i cili qëndroi i hapur gjatë javës së tretë të janarit 2023 i dha mundësi publikut dhe partnerëve të jashtëm të shpreheshin lidhur me përshtatshmërinë e propozimeve për Rishikimin e Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe Ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë dhe për të propozuar angazhime të tjera në fushën e rinisë për përfshirje në Planin Kombëtar të Veprimit të 2023-2025.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë organizuan në datë 12 dhjetor 2022, në ambientet e Kryeministrit një takim të dedikuar me përfaqësuesit e 24 organizatave të shoqërisë civile rinore dhe për të rinjtë me qëllim diskutimin e nevojave dhe

sugjerimeve të shoqërisë civile lidhur me procesin e ngritjes së bazës së të dhënave për rininë dhe mundësinë e përfshirjes së kësaj nisme si angazhim i ri në Planin Kombëtar të Veprimit të PQH-së 2023-2025.

Në përfundim të procesit të propozimit dhe konsultimit të prioriteteve për fushën e rinisë me organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë/rinore përmes takimeve fizike dhe përpunimit të të dhënave të pyetësorit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i propozoi *Ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë* si angazhim prioritar për tu përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit për PQH-në 2023-2025, në takimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur mbajtur më 9 shkurt 2023.

5. Ngritja e grupit të punës dhe dakordësimi i kalendarit të aktiviteteve.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi më datë 20 janar 2023 takimim me përfaqësuesit e AKR dhe organizatave të shoqërisë civile që konfirmuan angazhimin e tyre në grupin e përbashkët të punës për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë dhe përcollën sugjerimet e tyre për elementët e këtij instrumenti. Ky takim shërbeu për diskutimin e hapave dhe aktiviteteve të ardhshme për vijimin e procesit dhe kontributin që pritet nga OSHC e angazhuara.

Paketa e plotë e raportimit të këtyre fazave (drafti i planit të veprimit - raportet e konsultimit, agjendat e takimeve) –janë dorëzuar pranë sekretariatit teknik të Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

6. Angazhimet

Në përfundim të procesit të propozimit dhe konsultimit të prioriteteve për fushën e rinisë me organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë/rinoreu përcaktua *Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë* si angazhimi prioritar në fushën e rinisë në Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur PQH-në 2023-2025.

ANGAZHIM 11

FUSHA: PROMOVIMI I TRANSFORMIMIT DIGJIITAL DHE INOVACIONIT

ANGAZHIMI 11: Ngritja e Bazës së të Dhënave për organizatat rinore

Vendi	Shqipëria
Emërtimi i angazhimit	Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Këshilli i Ministrave përmes vendimit Nr. 833, datë 24.12.2021 “Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore”, i ka hapur rrugë ngritjes së Bazës së të Dhënave për Rininë si regjistër elektronik për rininë (RER) që do administrohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe do të ndërlidhet me bazat e tjera shtetërore si: Regjistri gjyqësor për regjistrimin e OJF-ve, të dhënat e pronarëve përfitues, regjistrin tatimor, sistemi i informacionit të planifikimit të integruar (SIPI). Të dhënat e grumbulluara nga RER-i do të përdoren nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre institucionale për vlerësimin periodik të situatës së të rinjve në vend dhe hartimin dhe monitorimin e politikave rinore në vend bazuar mbi evidenca.</p> <p>Vendimi parashikon në të njëjtën kohë që të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në vend dhe diasporë, si dhe organizata Kombëtare Përfaqësuese për Rininë do të mund të regjistrohen në bazën e të dhënave për rininë dhe do të mund të aksesojnë si lexues të dhënat në RER përmes një kërkesë për informacion publik pranë AKR-së. Këto individë apo organizata do mund të përdorin të dhënat nga RER-i për të mbështetur kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme të zbatuara në fushën e rinisë duke lehtësuar punën dhe rritur cilësinë e kontributit të tyre dhe duke nxitur në të njëjtën kohë transparencën dhe llogaridhënien publike sa i takon realizimit të angazhimeve të institucioneve qendrore dhe vendore për mbështetjen e të rinjve.</p> <p>Shërbime të tjera publike që parashikohen të ndërlidhen me bazën e të dhënave për rininë përfshijnë menaxhimin e procesit të aplikimeve në thirrjet vjetore të AKR-së nga organizatat rinore/për të rinjtë për grantin shtetëror të rinisë, menaxhimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës nga MSHRF, etj.</p>
Udhëheqësi i angazhimit	Ministri i shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
	Agjencia Kombëtare e Rinisë; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.	KRK, Epoka e Re, Scidev, ANYN, Roma Active Albania, Rrjeti Zëri i të Rinjve.	
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, rregullon kriteret për përcaktimin e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinor dhe ndërton kuadrin për angazhimin e tyre për konsultimin e politikave me ndikim tek të rinjtë dhe për mbështetjen nga shteti të veprimtarisë së tyre për aktivizimin rinor. Aktualisht nuk ka një bazë shteruese të dhënash mbi organizatat e shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për tu konsideruar organizate rinore apo për të rinjtë dhe për rrjedhojë bëhet e vështirë përfshirja e tyre në konsultimin e politikave rinore apo mbështetja e veprimtarisë së tyre.

Gjithashtu, gjenerimi i informacionit të vlefshëm për të orientuar vendimmarrjen në nivel qendror dhe vendor lidhur me politikën, programet dhe nismat që ndërmerren në fushën e rinisë kërkon pikësëpari grumbullim të dhënash të besueshme dhe përpunim të tyre bazuar në metoda të testuara, duke kërkuar angazhimin dhe kontributin nga aktorë të ndryshëm, ku duhet përfshihen si institucionet shtetërore ashtu dhe organizatat e shoqërisë civile rinore/për të rinjtë, rrjetet dhe organizatat përfaqësuese rinore dhe vetë të rinjtë në vend.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, ka përcaktuar detyrën për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë duke synuar krijimin e një instrumenti që do të përdoret nga institucionet shtetërore dhe aktorët e jashtëm për të grumbulluar dhe shkëmbyer informacion dhe të dhëna në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend, si edhe për të mbështetur procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

Këshilli i Ministrave përmes vendimit Nr. 833, datë 24.12.2021 “Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore”, i ka hapur rrugë ngritjes së Bazës së të Dhënave për Rininë si regjistër elektronik për rininë (RER) që do administrohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Ndërsa VKM ka përcaktuar kategoritë dhe nivelin e aksesit të përdoruesve dhe qëllimin e përdorimit të të dhënave në RER, ai ka lënë të hapur aspektet e lidhura me llojin dhe sasinë e të dhënave që do grumbullohen në RER dhe mënyrën e përpunimit të këtyre të dhënave për ti shërbyer më pas institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe aktorëve të jashtëm në punën e tyre.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Përgjithësisht në Shqipëri, të dhënat që shërbejnë për vlerësimin e situatës së të rinjve apo ndikimit të politikave dhe programeve për të rinjtë grumbullohen në mënyrë ad-hoc, sipas qëllimeve të veçanta që kanë institucionet shtetërore apo aktorët e jashtëm, shkëmbehen pak dhe janë vështirësisht të disponueshme dhe të përdorshme nga të rinjtë dhe shoqëria e gjerë. Gjithashtu, informacioni i prodhuar ndodh të cenohet nga dyshimet për saktësinë dhe verifikueshmërinë e burimit të të dhënave dhe mund mos merret parasysh nga vendimmarrësit. Në kushte aktuale është shumë e vështirë sigurimi i të dhënave të përditësuara dhe të përpunueshme për të informuar proceset vendimmarrëse të lidhura me rininë.

Aktualisht nuk është ngritur ende baza e dhënave mbi organizatat e shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për tu konsideruar organizate rinore apo organizatë për të rinjtë dhe nuk mund të bëhet angazhimi i strukturuar i tyre në konsultimin e politikave, programeve apo nismave rinore apo mbështetjen e veprimtarisë së tyre nga shteti sipas ligjit.

Përshkrimi i Angazhimit

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Kuadri ligjor për ngritjen Bazës së të Dhënave për Rininë përmes miratimit nga Këshilli i Ministrave përmes vendimit Nr. 833, datë 24.12.2021 “Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore”. Aktualisht nuk ka asnjë pengesë për ngritjen e një baze të dhënash që përmbush kërkesat ligjore dhe i shërben vendimmarrjes së informuar, transparencës dhe llogaridhënies lidhur me politikën, programet dhe nismat në fushën e rinisë.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë në përputhje me parashikimin e Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” dhe VKM Nr. 833, datë 24.12.2021, si një instrument që do të përdoret për të grumbulluar dhe shkëmbyer informacion dhe të dhëna në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend, si edhe për të mbështetur procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

Zbatimi i këtij angazhimi në bashkëpunim me OSHC-të rinore dhe për të rinjtë për të siguruar një vlerësim të gjithanshëm mbi llojin dhe sasinë e të dhënave që do grumbullohen në RER dhe mënyrën më të përshtatshme të përpunimit të këtyre të dhënave, për ti shërbyer institucioneve shtetërore në proceset vendimmarrëse dhe përmirësimit të punës të aktorëve të jashtëm, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien publike në fushën e rinisë.

Pas ngritjes së Bazës së të Dhënave për Rininë do të zhvillohet në bashkëpunim me OSHC-të rinore dhe për të rinjtë një fushatë kombëtare me fokus prezantimin dhe popullimin e saj nga të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në të gjithë vendin.

5. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë synon këto rezultate:

1. Të sigurojë informacion dhe të dhëna të besueshme, të përditësuara dhe të përpunueshme në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend, si edhe të mbështesë vendimmarrjen për fushën e rinisë në nivel qendror dhe vendor bazuar mbi evidenca.
2. Të përcaktojë listën organizatave të shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për tu konsideruar organizatë rinore apo organizatë për të rinjtë dhe që do të përshihen në konsultimin e politikave, programeve apo nismave rinore dhe përfitimin nga shërbimet publike të digjitalizuara për to, si p.sh. aplikimi në thirrjet vjetore të AKR-së për grantin shtetëror të rinisë.
3. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e veprimtarisë në fushën e rinisë të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore përmes vënies në dispozicion të të dhënave të databazës tek të rinjtë apo organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme të zbatuara prej tyre.
4. Të lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe ndërtimin e nismave të përbashkëta në fushën e rinisë.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Finalizimi i arkitekturës së databazës sa i takon të dhënave që do të grumbullohen dhe funksionaliteteve të saj. (mars 2023);	Arkitektura e databazës së rinisë dhe funksionalitetet e saj të finalizuara dhe të miratuara.	6 M II 2023	Udhëheqësi: MSHRF		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria AKR	OSHC-të Epoka e Re, Scidev, KRK, ANYN, Roma Active Albania, Rrjeti Zëri i të Rinjve.	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
Finalizimi i termave të referencës për ngritjen e databazës dhe shpallja e tenderit.	ToR për ngritjen e databazës së rinisë të miratuara. Tenderi për databazën e rinisë i shpallur.	6 M II 2023	Udhëheqësi: MSHRF		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria AKR AKSHI	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
Ngritja dhe testimi i databazës së rinisë.	Databaza e rinisë e ngritur dhe e testuar nga përdoruesit.	6 M I 2024	Udhëheqësi: MSHRF		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria AKR AKSHI	OSHC-të Epoka e Re, Scidev, KRK, ANYN, Roma Active Albania, Rrjeti Zëri i të Rinjve.	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j) Kompania e tenderuar

Përgatitja dhe zbatimi i një fushate komunikimi për popullimin e databazës në nivel kombëtar.	Fushata e komunikimit për popullimin e databazës nga organizatat rinore/për të rinjtë e dizenuar dhe e zbatuar në nivel kombëtar.	6 M II 2024	Udhëheqësi: MSHRF		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			AKR	OSHC-të Epoka e Re, Scidev, KRK, ANYN, Roma Active Albania, Rrjeti Zëri i të Rinjve.	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
AKR		Kompania e tenderuar.			

ANGAZHIM 12

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 12: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore

1. Pjesa hyrëse

Shërbimet publike financohen nga fondet e tatimpaguesve dhe shpërndarja e këtyre fondeve përcaktohet përmes buxhetit dhe ciklit fiskal. Rritja e përgjegjësisë mbi buxhetin dhe ciklit fiskal parandalon humbjet dhe korrupsionin dhe siguron që vendimet dhe shpenzimet buxhetore të pasqyrojnë interesat e publikut. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut përgjatë buxhetit dhe ciklit fiskal është veçanërisht e rëndësishme për qeverinë shqiptare. Në mënyrë që transparenca fiskale të lehtësojë fuqizimin e qytetarëve për të kontrolluar financat publike do të duhet të promovohet llogaridhënia e financave publike, publikimi i dokumenteve/ informacioni dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore, transparencën e të ardhurave dhe mbi financat publike

Një element shumë i rëndësishëm në këtë proces është bashkë-hartimi i planit të veprimit 2023-2025 me grupet e interesit / Organizatat e Shoqërisë Civile dhe bashkë-implemtimi i angazhimeve të ndërmarra.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Transparenca fiskale, si në buxhetin e qeverisë, të ardhurat publike dhe financat publike, ka qenë gjithnjë e më shumë në fokus për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) të Shqipërisë 2019-2022, kuadri udhëzues për zbatimin e të gjitha reformave qeveritare të MFP, transparenca fiskale është një nga prioritetet dhe është një nga shtatë objektivat specifike të strategjisë. Gjithashtu do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet dhe në Strategjinë e re të MFP-së.

Midis viteve 2010 dhe 2021 rezultati i OBI në Shqipëri është rritur nga 33 në vitin 2010 në 52 nga 100 të mundshëm në vitin 2021. Gjithsesi, përpjekjet për të përmirësuar transparencën fiskale do të vazhdojnë në mënyrë të konsiderueshme për të përmbushur synimet e nevojshme.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Pas marrjes së njoftimit për fillimin e procesit për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023-2025, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në datën 09.12.2022, është zhvilluar takimi me grupin e punës. Qëllimi i takimit ishte për të shpjeguar procesin e hartimit të Planit të Veprimit të OGP 2023-2025 dhe për të përcjellë propozimet për vitin 2024 dhe 2025.

Një element shumë i rëndësishëm në këtë proces është bashkë-hartimi i planit të veprimit 2023-2025 me grupet e interesit / Organizatat e Shoqërisë Civile dhe përfshirja e angazhimeve të propozuara nga ana e tyre. Për këtë qëllim u përgatit pyetësori për marrjen e mendimit nga publiku i gjerë për përcjelljen e propozimeve. Pyetësori u përcoll elektronikisht në datën 10 janar 2023, tek 56 Organizata të Shoqërisë Civile dhe grupe të tjera të interesit. Gjithashtu, pyetësori është publikuar në websit-in e MFE url: <https://financa.gov.al/shpallje-njoftimesh/> dhe është përcjellë për publikim dhe në faqen zyrtare të OGP Albania. Afati për dërgimin e kontributeve ishte data 18 janar 2023, në adresën pfm.unit@financa.gov.al.

Përsa më sipër dhe me qëllim angazhimit të OSHC-ve u organizuan dy takime konsultuese. Takimi i parë

konsultues u zhvillua në datën 12 janar 2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim njoftimin e përfaqësuesve të grupit të interesit dhe OSHC-ve për fillimin e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2023- 2025 për OGP dhe ftesën për OSHC-të për bashkë-bërjen e Planit të Veprimit 2023-25 duke përcjellë prioritetet/ide/angazhime për tu bërë pjesë e këtij plani veprimi. Takim i dytë konsultues u zhvillua në datën 17 janar, online në platformën Teams. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi prioritetet dhe angazhimet që përfaqësuesit e OSHC-ve dhe grupeve të interesit sugjerojnë të bëhen pjesë e Planit të Veprimit 2023-25 të OGP-së si edhe adresimi i tyre te institucionet përgjegjëse respektive.

Pyetësi u plotësua nga 4 Organizata të Shoqërisë Civile, konkretisht nga ‘Albanian Initiative for Development’, ‘Instituti i Politikave të Qëndrueshme’, ‘Sustainable Finance and Innovation Centre’ dhe ‘Save the Children’.

Pas miratimit të angazhimeve prioritare nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi procesin për hartimin e analizës së situatës, problematikave specifike dhe identifikimin e aktiviteteve specifike që do të duhet të kryhen sipas afateve kohore për çdo angazhim. Për fushën 4: Transparenca fiskale, për të cilën institucion udhëheqës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur u miratuan tre angazhimet prioritare si në vijim:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

Në kuadër të rolit tepër të rëndësishëm dhe kyç të Organizatave të Shoqërive Civile dhe grupeve të interesit në procesin e bashkë-hartimit të planit të veprimit 2023-25 për OGP-në, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 21 shkurt 2023, u kërkua angazhimi dhe kontributi i OSHC-ve për të identifikuar aktivitetet specifike për secilin angazhim prioritar të miratuar që do të jenë pjesë e Plani të Veprimit të OGP-së 2023-2025. Gjithashtu, OSHC-ve iu përcoll ftesa për pjesëmarrje në takim për të diskutuar për këtë qëllim.

Takimi konsultues u zhvillua në datën 23 shkurt 2023. Në takim morën pjesë përfaqësues nga 4 OSHC, konkretisht nga ‘Albanian Initiative for Development’, ‘Instituti i Politikave të Qëndrueshme’, ‘Save the Children’, ‘Gender Alliance for Development Center’ dhe përfaqësues nga disa drejtori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Zhvillim pozitiv në këtë proces ishte pjesëmarrja në takim e ‘Gender Alliance for Development Center’, organizatë e cila nuk ishte pjesë deri në këtë fazë.

Propozimet nga OSHC-të janë reflektuar në Planin e Veprimit të OGP 2023-2025, për fushën 4: Transparenca fiskale me udhëheqës Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

4. Angazhimet

Për fushën 4: Transparenca fiskale, për të cilën institucion udhëheqës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur u miratuan tre angazhimet prioritare si në vijim:

4. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
5. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave
6. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

ANGAZHIM 12

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 12: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur 2021, Shqipëria ka shënuar 52/100 pikë në fushën e transparencës buxhetore, që është nën pragun e përcaktuar nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit. Një rezultat transparence prej 61 pikë ose më lart tregon se një vend duket se publikon materiale të mjaftueshme për të mbështetur debatin publik të informuar mbi buxhetin. Në këtë kuadër, organizatat e shoqërisë civile duhet të kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve për grupet e synuara për të ushtruar rolin e tyre si qytetarë aktivë ndaj institucioneve publike përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike në mënyrë efikase dhe efektive, siç thuhet në Ligjin Organik të Buxhetit në Shqipëri.</p> <p>Objektivi kryesor është ndërtimi i kapaciteteve të brezave të rinj (të rinjtë dhe adoleshentët) dhe stafi i OJQ-ve në fushën e proceseve buxhetore, aktorëve të përfshirë etj., për t'i mbajtur institucionet publike përgjegjëse ndaj mënyrës se si i përdorin fondet publike. Nëpërmjet një sërë sesionesh trajnimi, ne synojmë shkëmbimin e informacionit dhe ngritjen e kapaciteteve në fushën e buxhetimit.</p> <p>Transparenca, pjesëmarrja e publikut dhe mbikëqyrja legjislative në zhvillimin e buxheteve krijojnë rezultate më të mira dhe janë çështjet kryesore për të përmirësuar më mirë aksesin e qytetarëve në dokumentet fiskale. Rritja e llogaridhënies mbi buxhetin dhe ciklin fiskal parandalon humbjet dhe korrupsionin dhe siguron që vendimet dhe shpenzimet buxhetore të reflektojnë interesat e njerëzve.</p> <p>Nëpërmjet transparencës, pjesëmarrjes publike dhe mbikëqyrjes legjislative, kjo hapje mund të ndihmojë në luftimin e korrupsionit. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut përgjatë buxhetit dhe ciklit fiskal është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Grupet e Interesit që mbështesin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)

angazhimi	MFE	Albanian Initiative for Development Save the Children National Office
Periudha e implementimit	2023 – 2025	

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur 2021, Shqipëria ka shënuar 52/100 pikë në fushën e transparencës buxhetore, që është nën pragun e përcaktuar nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit. Një rezultat transparence prej 61 pikë ose më lart tregon se një vend duket se publikon materiale të mjaftueshme për të mbështetur debatin publik të informuar mbi buxhetin. Në këtë kuadër, organizatat e shoqërisë civile duhet të kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve për grupet e synuara për të ushtruar rolin e tyre si qytetarë aktivë ndaj institucioneve publike përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike në mënyrë efikase dhe efektive, siç kërkohet në Ligjin Organik të Buxhetit në Shqipëri.

Përvoja e viteve të fundit ka nënvizuar nevojën për të kuptuar më mirë madhësinë dhe natyrën e risqeve fiskale dhe implikimet e tyre. Të qenit më të vetëdijshëm për risqet fiskale mund t'i lejojë qeveritë të vendosin politika për buxhetimin e tyre më me kujdes dhe të ndërmarrin hapa, aty ku është e përshtatshme, për të kufizuar ekspozimin e tyre ndaj goditjeve. Kuptimi më i mirë i risqeve fiskale, transparenca më e madhe dhe praktikatat efektive të menaxhimit të rrezikut mund të ndihmojnë gjithashtu në mbështetjen e besueshmërisë dhe sigurisë në treg. Politikbërësit duhet të marrin parasysh edhe risqet fiskale kur formulojnë objektivat fiskalë.

Përfshirja e treguesve kryesorë të performancës në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit nga ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore, synon të përmirësojë procesin e përgjithshëm të monitorimit duke rritur transparencën buxhetore.

Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me transparencën fiskale ka qenë prej kohësh një sfidë; megjithatë, përpjekjet për t'u angazhuar, konsultuar dhe bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe palët e interesuara kanë qenë një fokus në rritje i qasjes së MFE-së.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Qëllimi i Deklaratës së Riskut Fiskal (DRF) është të japë një pasqyrë të shkurtër të risqeve fiskale më të rëndësishme dhe domethënëse me të cilat po përballet qeveria shqiptare. Siç theksohet nga Vlerësimi i Transparencës Fiskale 2015, Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike të Shqipërisë njih nevojën për të menaxhuar risqet fiskale. Kjo ka sjellë nevojën për monitorimin e risqeve kryesore fiskale me të cilat po përballet

qeveria shqiptare. Që atëherë, ka lindur nevoja që Njësia e Riskut Fiskal (NjRF)/Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit (DMB), të bashkëpunojë me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë drejt rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të Deklaratës së Riskut Fiskal.

Faktori kryesor që shkaktoi këtë problem ishte pamundësia për të monitoruar performancën e përgjithshme të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore. Për përmirësimin e procesit të monitorimit dhe rrjedhimisht rritjen e transparencës buxhetore, u propozua përditësimi i Udhëzimit për monitorimin e buxhetit për përfshirjen e Treguesve Kyç të Performancës (Key Performance Indicators - KPI) në procesin e monitorimit.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ka pasur përmirësime, pasi NjRF/DMB u asistua dhe me Asistencë Teknike në progres po punon për një udhëzues metodologjik të përhershëm të DRF-së. Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë udhëzime metodologjike për përgatitjen e një deklarate të riskut fiskal (SNRF) për Qeverinë e Shqipërisë. Qëllimi është që deklarata të mbulojë të gjitha risqet fiskale të rëndësishme dhe domethënëse.

Deri më tani, fushat kryesore në të cilat po punohet për zgjidhjen e problemit janë:

Progresi i bërë në krijimin e formateve (template) të reja për Udhëzuesin e ri për monitorimin e buxhetit, që përfshijnë Tregues Kyç të Performancës (KPI) në raportet Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar/Moduli i Monitorimit të Portofolit të Buxhetit dhe Programit (AFMIS/BPPM), të krijuara dhe dorëzuara në MFE nga Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore gjatë procesit të monitorimit të buxhetit.

Transparenca buxhetore ka qenë një fokus gjithnjë e më i rëndësishëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Në Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) të Shqipërisë 2019-2022, kuadri udhëzues për zbatimin e të gjitha reformave të qeverisë për MFP-në, transparenca fiskale është prioritare dhe është një nga shtatë objektivat specifike të strategjisë.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Miratimi i Udhëzimit të ri të përhershëm për Deklaratën e Riskut Fiskal”, i cili do të jetë një përmirësim i Udhëzimit ekzistues për Deklaratën e Riskut Fiskal dhe ku do të zgjerohet numri i risqeve fiskale të monitoruara, në varësi të situatës së çdo viti buxhetor. Për më tepër, pas miratimit të Udhëzimit të ri në vitin 2022, faza e zbatimit të këtij Udhëzimi do të jetë Viti Fiskal 2023-2024.

Zgjidhja kryesore për të cilën po punohet është hartimi i modeleve të reja të Udhëzuesit për monitorimin e buxhetit që përfshin Treguesit Kyç të Performancës (KPI-të), që do të gjenerohen përmes Modullit SIMFSH/MPBP (AFMIS/BPPM).

Oftohen mundësi formale për OSHC-të/OJQ-të që të angazhohen në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Miratimi i Udhëzimit të ri të përhershëm për Deklaratën e Riskut Fiskal” në vitin 2022 dhe zbatimi i këtij udhëzimi do të përmirësojë deklaratën ekzistuese të riskut fiskal.

Nëpërmjet zbatimit të Udhëzimit të ri për monitorimin e buxhetit synohet të përmirësohet më tej procesi i përgjithshëm i monitorimit të buxhetit. Qëllimi kryesor i përfshirjes së Treguesve Kyç të Performancës (KPI-ve) gjatë këtij procesi është matja e progresit të bërë nga ML/IB drejt qëllimeve dhe objektivave specifike. Për më tepër, kuptimi dhe vlerësimi i KPI-ve do të ndihmojë në përmbushjen e angazhimit që Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Buxhetore kanë për shpenzime të përgjegjshme dhe transparencë.

Angazhim më i strukturuar dhe në kohë me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit.

Komentet/refleksionet nga Qeveria dhe OSHC/OJQ.

Angazhimi					
Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Forcimi i mbikëqyrjes financiare dhe menaxhimit të risqeve fiskale në mënyrë që të kemi një Deklaratë të Risqeve Fiskale të përmirësuar me më shumë risqe fiskale të monitoruara dhe të zbutura nëse është e nevojshme	Një Deklaratë e Risqeve Fiskale e përmirësuar	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi:Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit/NjRF		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S ektori Privat,et j)
			Ministritë e Linjës / Institucionet Buxhetore / NSH-të / Avokatura e Shtetit		
Monitorimi i procesit të ekzekutimit të buxhetit sipas	Formatet (template) e reja të Udhëzuesit për monitorimin e	6 M II 2023	Udhëheqësi:Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		

treguesve kryesorë të performancës	buxhetit, që përfshin KPI-të, të jenë miratuar		Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			Institucionet e Qeverisë Qëndrore		
OSHC-të / OJQ-të Seancat dëgjimore të PBA-së	Komentet/reflektimet nga Qeveria dhe OSHC/OJQ-të	2024	Udhëheqësi: MFE		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			MFE		
Seria e seminareve me OSHC-të me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi risqet fiskale dhe se si ato mund të ndikojnë në zbatimin e buxhetit.	Dokument shpjegues (memorandum) përshkruar mbi risqet fiskale dhe trajtimin e tyre, bazuar në praktikat më të mira nga vendet e OECD, për shpërndarje tek palët e interesuara.	6 M II 2023-2024	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			MFE	Albanian Initiative for Development	
Sesione trajnimi me të rinjtë dhe adoleshentët, nxënësit e shkollave profesionale dhe stafin e OJQ-ve mbi proceset buxhetore dhe transparencën.	Të rinjtë, studentët dhe stafi i OSHC-ve kanë njohuritë dhe mjetet për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në konsultimet publike për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			MFE	Save the Children in Albania, National Office	

Monitorimi i zbatimit të buxhetimit gjinor për programet e deklaruara	Raport monitorimi vjetor	6M II 2023 2024 6M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim	Parlamenti
Monitorimi i buxhetimit te Strategjise Kombetare per Barazine Gjinore 2021- 2027	Raport monitorimi 3 vjecar	2024 6M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim	Parlamenti
Monitorimi i buxhetimit gjinor ne nivel lokal	Raport monitorimi nje vjecar per 3 bashki	2024 6M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim	Parlamenti
Ngritje kapacitetesh per stafet lokale te bashkive ne lidhje me buxhetimin gjinor	10 Trajnime	2024 6M I 2025	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MFE	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim	Parlamenti

ANGAZHIM 13

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 13: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar për futjen graduale të një sistemi modern të kontabilitetit të sektorit publik bazuar në standardet ndërkombëtare. Kontabiliteti publik në Shqipëri bëhet aktualisht mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (accruals). Kjo nismë synon të rrisë cilësinë e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh nevojën e qartë për reformimin e raportimit financiar në të gjithë Shqipërinë. Kjo reformë përfshin:</p> <p>a) Zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP);</p> <p>b) Zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MEF) dhe aftësive profesionale të kontabilitetit për praktikuesit e kontabilitetit publik.</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit të ministrive të linjës dhe njërive të qeverisjes vendore në lidhje me Menaxhimin e Aseteve</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj) Bashkitë do të përfshihen në këtë proces
	MFE	Albanian Initiative for Development Save the Children	
Periudha e implemetimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Bashkitë janë niveli më i afërt i qeverisë me qytetarët dhe si të tilla janë potencialisht në gjendje të adresojnë nevojat e komuniteteve të tyre më mirë se qeveria qendrore. Duke marrë parasysh avantazhin informativ të bashkive ndaj qeverisë qendrore, ato potencialisht mund të përshatnin më mirë ofertën e të mirave dhe shërbimeve publike sipas nevojave dhe preferencave të qytetarëve. Reformat e decentralizimit të ndërmarrura në Shqipëri mes viteve 2015 dhe 2018 synojnë forcimin e qeverisjes vendore, nëpërmjet zhvillimit të kushteve dhe kapaciteteve për të ofruar shërbime vendore cilësore dhe efikase. Tatimi mbi pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet mbi to është një burim i konsiderueshëm dhe i qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor. Edhe pse të ardhurat e mbledhura ndër vite nga tatimi mbi pasuritë e paluajtshme përgjithësisht kanë pasur një tendencë në rritje, çështjet që lidhen me të drejtat e pronësisë dhe mungesa e një kadastro fiskale, ndër të tjera, nuk lejojnë realizimin e plotë të potencialit të kësaj takse. Pas reformimit të plotë të kësaj takse si me ligjin nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, bazuar në komunikimet mediatike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të gjitha bashkitë pritej të aplikojnë taksën në pronat e paluajtshme në bazë të metodologjisë së re në vitin 2019. Aktualisht jo çdo bashki e ka ndërmarrë këtë hap, për shkak të problemeve me mbledhjen e të dhënave të nevojshme për aplikimin e kësaj metodologjie. Në terma strukturorë, të ardhurat nga taksa e ndërtesave përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave totale nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme. Objektivi ynë kryesor është të asistojmë Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë gjatë trajnimeve me stafin e Bashkive si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e mbledhjes së tatimit në pronë për njësitë vendore.

Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar për futjen graduale të një sistemi modern të kontabilitetit të sektorit publik bazuar në standardet ndërkombëtare. Kontabiliteti publik në Shqipëri bëhet aktualisht mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Kjo nisimë synon të rrisë cilësinë e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh nevojën e qartë për reformimin e raportimit financiar në të gjithë Shqipërinë. Kjo reformë përfshin:

- a) Zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP);
- b) Zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MEF) dhe aftësive profesionale të kontabilitetit për praktikuesit e kontabilitetit publik.

Ky angazhim mbështetet nga një projekt i Bankës Botërore, i cili ka si objektivi zhvillimin e një udhërrëfyesi për zbatimin e kontabilitetit aktual në sektorin publik dhe mbështetjen e fazave të hershme të kësaj reforme, duke përfshirë ndërtimin e aftësive thelbësore teknike. Në përputhje me strategjinë e MFP-së të Shqipërisë (2019-2022), objektivat kryesorë të projektit janë si më poshtë:

- a) Hartimi i udhëzuesit kombëtar, marrëveshjeve institucionale dhe planit afatgjatë të veprimit për kalimin nga korniza ekzistuese e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik, në përputhje me zhvillimin e sistemit të thesarit (AGFIS) në AFMIS.
- b) Paraqitja e pasqyrave financiare në përputhje me standardin e përzgjedhur SNKSP.
- c) Përmirësimi i cilësisë së raportimit kontabël, statistikor dhe financiar të evidentuar nga

vlerësimi i PEFA.

d) Përmirësimi i kapaciteteve teknike të Njesisë së Raportimit Financiar të MFE-së.

e) Zbatimi i rregullave të Kontabilitetit Publik dhe Njësia Qendrore e Harmonizimit (përgjegjëse për metodologjinë e Kontabilitetit Publik) në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të sektorit publik.

f) Zhvillimi i një kualifikimi të qëndrueshëm të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare; dhe përmirësimi i të kuptuarit dhe aplikimit të standardeve përkatëse të kontabilitetit nga praktikuesit dhe auditorët e sektorit publik.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është për shkak të ekzistencës së disa problemeve, të identifikuar gjatë analizës së boshllëqeve si:

- Mungesa e përcaktimit të saktë të numrit të njësive të sektorit publik të kontrolluar;
 - Kuadri ligjor për kontabilitetin dhe raportimin financiar të sektorit publik ishte kompleks, i fragmentuar dhe i paqartë;
 - Mungesa e arsimit dhe formimit profesional në fushën e financave dhe kontabilitetit të sektorit publik;
 - Mungesa e një kodi etike për kontabilistët e sektorit publik;
 - Sistemi buxhetor konfuz;
 - Funkionimi i pjesshëm i sistemit AGFIS (Sistemi i Informacionit Financiar të Qeverisë), pavarësisht se përdoret në pjesën më të madhe të sektorit publik;
- Mungesa e një regjistri të konsoliduar të pasurive për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme në Shqipëri (mungesa e një metodologjie të caktuar për matjen dhe inventarizimin e aseteve).

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Gjatë këtyre viteve janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- Rishikimi i proceseve të biznesit që do të mundësonte raportimin sipas SNKSP;
- Rishikimi i Planit Kontabël;
- Vlerësimi i Funkcionalitetit të AGFIS për të trajtuar kontabilitetin dhe raportimin sipas bazës së kontabilitetit aktual të SNKSP;
- Udhëzim për Bilancet e Hapjes.
- Përgatitja e udhëzimeve kontabël të të drejtave dhe detyrime të konstatuara (accrual) lidhur me:
 - Inventarin
 - Të drejta & detyrime të konstatuara (accruals) dhe shpenzime
 - Dispozitat
 - Asetet jomateriale
 - Përfitimet e punonjësve
 - Pronat, Impiantet dhe Pajisjet
 - Të ardhurat
 - Instrumentet financiare

- Raportimin dhe prezantimin
- Konsolidimin

- Trajnimi i programit të trajnerëve për raportimin financiar dhe kontabilitetin e sektorit publik bazuar në SNKSP (28 pjesëmarrës).
- Pilotimi i trajnimit për herë të parë të stafit të financave dhe kontabilitetit në institucionet e qeverisë qendrore për kontabilitetin dhe raportimin financiar të sektorit publik bazuar në SNKSP. (100 kontabilistë nga rreth 20 institucione të ndryshme).
- Trajnimi i stafit të financave dhe kontabilitetit për kontabilitetin dhe raportimin financiar të sektorit publik bazuar në SNKSP (400 kontabilistë).

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Kontabiliteti publik në Shqipëri aktualisht bëhet mbi bazën cash me elementë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (accrual) në lidhje me aktivet dhe detyrimet. Në këtë drejtim, ne do të ndjekim miratimin e pjesshëm të SNKSP.

Miratimi i pjesshëm i SNKSP: Parimet e Kontabilitetit të Pranuara në Përgjithësi (PKPP) e sektorit publik kombëtar është modifikuar dhe/ose lëshohet PKPP e re e sektorit publik që është në përputhje me pjesët e zgjedhura të SNKSP-ve të përzgjedhura.

Ka shumë arsye pse kjo është qasja e preferuar, duke përfshirë arsyet si mëposhtë:

1. Ekziston një listë me konsistenca dhe mospërputhje ndërmjet PKPP-ve të sektorit publik shqiptar dhe SNKSP për secilin standard. Gjithashtu, jo të gjitha standardet IPSAS janë relevante për kontekstin shqiptar dhe jo të gjitha pjesët e një standardi janë të zbatueshme në kontekstin shqiptar.
2. Qasja aktuale u ofron kontabilistëve parime konkrete, specifike dhe të qarta të kontabilitetit për të siguruar kuptim të qartë të kërkesave dhe për të shmangur çdo mospërputhje në zbatimin e standardeve të kontabilitetit. Disa nga SNKSP-të origjinale nuk janë në përputhje me qasjen e vendit vendor dhe pritshmëritë kulturore në lidhje me rastet e kontabilitetit.

Rritja e ndërgjegjësimit të ministrive të linjës dhe njësive të qeverisjes vendore në lidhje me Menaxhimin e Aseteve. Kjo është e rëndësishme për disa arsye:

- Menaxhimi i duhur i asetëve mund t'i ndihmojë institucionet të marrin vendime të informuara për shpërndarjen e burimeve, të përmirësojnë saktësinë e raportimit financiar dhe të reduktojnë rrezikun e mashtrimit dhe gabimeve.
- Praktikat e duhura të menaxhimit të asetëve mund t'i ndihmojnë institucionet buxhetore të pajtohen me rregulloret dhe standardet që lidhen me raportimin financiar, vlerësimin e asetëve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit.
- Menaxhimi efektiv i asetëve mund t'i ndihmojë institucionet t'i japin përparësi investimeve në infrastrukturë, të zgjasin jetën e asetëve ekzistuese dhe të planifikojnë zëvendësimin e asetëve në fund të jetës së tyre të dobishme.
- Praktikat e shëndosha të menaxhimit të asetëve mund të rrisin transparencën dhe llogaridhënien në institucionet buxhetore. Kjo mund të ndihmojë palët e interesuara të kuptojnë se si institucioni po i përdor asetet dhe burimet e tij dhe të sigurojë që fondet publike po përdoren në mënyrë efektive dhe efikase.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Transparencë dhe llogaridhënie më e madhe e vendimeve financiare të marra nga juridiksionet për donatorët, qytetarët dhe investitorët;
- Informacion i plotë për të suportuar një vendimmarrje më të mirë;
- Një inventar i plotë i aktiveve dhe stoqeve, i cili u mundëson njësive të vlerësojnë nëse këto po përdoren në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike për të ofruar shërbime publike;
- Kuadri i raportimit të qeverisë i njohur ndërkombëtarisht është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e stabilitetit financiar të një vendi dhe atraktivitetit për investime, duke mbështetur vlerësime më të drejta dhe më të sakta të kredisë dhe duke inkurajuar investimet e huaja direkte;
- Qeverisja e financave publike do të përmirësohet përmes transparencës dhe llogaridhënies më të madhe që kërkohet nga dhënia e informacioneve shpjeguese të pasurive dhe në veçanti të detyrimeve të qeverisë.
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për institucionet buxhetore lidhur me menaxhimin e aseteve do të përmirësojë performancën financiare dhe operacionale, do të sigurojë përputhjen me rregulloret dhe standardet, do të adresojë sfidat e vjetërimit të infrastrukturës dhe do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien.

Angazhimi					
Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Trajnime të përbashkëta me stafin e bashkive dhe grupeve komunitare për rëndësinë e mbledhjes së tatimit në pronë për bashkinë	Stafi i bashkisë është i trajnuar dhe ka njohuritë dhe mjetet e nevojshme për taksën. Grupet komunitare janë të vetëdijshme për rëndësinë e mbledhjes së tatimit mbi pronën nga bashkia e tyre.	6M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MFE		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së pasurisë	Save the Children in Albania National Office	
			Bashkitë		
Miratimi i akteve ligjore dhe	Udhëzimet e miratuara	2024	Udhëheqësi: MFE		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		

standardeve të kontabilitetit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP).			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)		
			MFE				
Përgatitja dhe zbatimi i metodologjisë për inventarizimin dhe vlerësimin e asetëve të sektorit publik.	Metodologjia e miratuar	2024	Udhëheqësi: MFE				
			<u>Aktorët e Interesit</u>				
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)		
			MFE				
Rritja e ndërgjegjësimit të ML-ve dhe NJQV-ve në lidhje me Menaxhimin e Aseteve	Aktivitete ndërgjegjësuese të zhvilluara	2024	Udhëheqësi: MFE				
			<u>Aktorët e Interesit</u>				
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)		
Inventari i plotë i asetëve publike regjistrohet në Sistemin e Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare (SIFSHF) nga ato Institucione Buxhetore (IB) që kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem.	Gjithsej 15 Institucione Buxhetore kanë regjistruar asetet publike në SIFSHF (AGFIS)	2024	Udhëheqësi: MFE				
			<u>Aktorët e Interesit</u>				
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)		
			Institucione t Buxhetore me akses të drejtëpërdrejtë në AGFIS				

Inventari i plotë i aseteve publike regjistrohet në Excel për Institucionet Buxhetore (IB-të) të cilat nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në AGFIS	Regjistrimi i aseteve publike në Excel		Udhëheqësi:MFE			
			Aktorët e Interesit			
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)	
			Institucione t Buxhetore të cilat nuk kanë akses të drejtpërdr ejtë në AGFIS			

ANGAZHIM 14

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 14: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) në Shqipëri parashtron një axhendë reformash ambicioze për të gjithë qeverinë. Do të përgatitet një strategji e re për MFP.</p> <p>Krijimi i një mekanizmi dedikuar edukimit financiar publik me qëllim të shpërndarjes së njohurive/edukimit për publikun e gjerë, Organizatat e Shoqërisë Civile, studentët, akademikët si dhe nëpunësit civilë në nivel qendror apo vendor lidhur me shtyllat kryesore të Financave Publike.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj)
	MFE	<p>Institute for Sustainable Policies</p> <p>Sustainable Finance and Innovation Centre</p> <p>Albanian Initiative for Development</p>	
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Drejtorja për Menaxhimin e Reformave Ekonomike, Financave Publike dhe Mbështetjes Buxhetore Sektoriale kërkon Asistencë Teknike për të përgatitur dokumentin e ri të strategjisë së MFP.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) në Shqipëri parashtron një axhendë reformash ambicioze për të gjithë qeverinë, jo vetëm për Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë. Ai ka një rëndësi të konsiderueshme, pasi jo vetëm që hap terrenin për rikthimin e financave publike në trajektoren afatgjatë të qëndrueshmërisë, duke krijuar kështu parakushtet për rritjen ekonomike, por gjithashtu përbën një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me botën. Banka, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimi Evropian. Për më tepër, është një kusht i përgjithshëm për disbursimin e të gjitha kësteve të instrumentit të mbështetjes buxhetore në Shqipëri.

Duke qenë se viti 2022 ishte viti i fundit për zbatimin e Strategjisë së MFP 2019-2022, ekziston nevoja që të përgatitet dhe miratohet Strategjia e re e MFP-së në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e qëndrueshme e zbatimit të reformave të ndërmarra të MFP-së dhe të ndërmerren angazhime të reja duke synuar mbështetjen e një strategjie më të zhvilluar. ekonomi me shërbime më të mira për qytetarët; rritjen e përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe disiplinës fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike. Në këtë drejtim nevojitet bashkëpunim me OSHC-të për hartimin e Strategjisë së re të MFP-së dhe për përgatitjen e metodologjisë së raportit të monitorimit.

Për më tepër, është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi i publikut të gjerë, OCO-ve, akademikëve, studentëve etj., në lidhje me menaxhimin e financave publike.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Duke qenë se Strategjia aktuale e Menaxhimit të Financave Publike mbulon periudhën 2019-2022, Strategjia e re e MFP-së duhet të përgatitet. Gjithashtu është e rëndësishme të ofrohen trajnime mbi menaxhimin e financave publike për të ndihmuar individët që punojnë në qeveri të përmirësojnë të kuptuarit e praktikave të menaxhimit financiar, duke përfshirë buxhetimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar. Kjo mund të çojë në praktika më të mira të menaxhimit financiar dhe fondet publike menaxhohen në mënyrë efektive, efikase dhe transparente, praktika më të mira të menaxhimit financiar, rritje të llogaridhënies, vendimmarrje më të mirë, pajtueshmëri me rregulloret dhe përmirësim të ofrimit të shërbimeve.

Përshkrimi i Angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Transparenca buxhetore ka qenë një fokus gjithnjë e më i rëndësishëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) të Shqipërisë 2019-2022, kuadri udhëzues për zbatimin e të gjitha reformave të qeverisë për MFP, transparenca e financave publike është prioritet dhe është një nga objektivat specifike të strategjisë. Konkretisht, pjesë e shtyllës 5 është komponenti 'Angazhimi i qytetarëve', i cili synon të ofrojë mundësi formale për publikun që të angazhohet në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit.

2. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Të krijohet një mekanizëm/strukturë e dedikuar për edukimin financiar publik me qëllim të shpërndarjes së njohurive/edukimit për publikun e gjerë, Organizatat e Shoqërisë Civile, studentët, akademikët si dhe nëpunësit civilë në nivel qendror apo lokal në lidhje me shtyllat kryesore të Financave Publike: kuadri makroekonomik; buxhet i integruar mirë dhe planifikimi i investimeve; mobilizimi i të ardhurave; Ekzekutimi efikas i buxhetit, transparenca e financave publike, kontrolli i brendshëm efektiv; dhe Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike. Sa më sipër, është e rëndësishme ngritja e kësaj platforme për të ndihmuar individët të zgjerojnë njohuritë e tyre bazë dhe të kuptojnë termat bazë financiare, karakteristikat e shërbimeve dhe produkteve financiare, si dhe të kenë një qëndrim dhe sjellje pozitive në menaxhimin e financave, kursimet, investimet, etj. Vendimet e mirëinformuara mund të merren vetëm nëse individët janë në gjendje të kuptojnë veçoritë e produkteve dhe shërbimeve financiare.

2. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Strategjia e re e MFP-së dhe raportet e monitorimit do të përgatiten. Janë zhvilluar aktivitete trajnuese për Menaxhimin e Financave Publike.

OJQ-të mund të kontribuojnë duke organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese për grupin e synuar. Instituti për Politika të Qëndrueshme është angazhuar në projekte për edukimin financiar për nxënësit e shkollave të mesme në Tiranë. Projektet e tyre kanë informuar gjimnazistët për aspekte të ndryshme të edukimit financiar, që lidhen me të ardhurat, shpenzimet, buxhetimin, sigurinë e financave personale, huamarrjen etj.

Prandaj, OJQ-të mund të kontribuojnë duke informuar publikun e gjerë dhe grupet specifike të synuara mbi konceptet e menaxhimit të financave publike. Informacioni mund të shpërndahet përmes seminareve, trajnimeve, broshurave informative fizike dhe elektronike, krijimit të spoteve informative për financat publike, trajnimit të mediave dhe gazetarëve për çështjen e sipërpërmendur të financave publike, informimit të studentëve, grupeve vulnerabël, ndihmës për aktet. që ndahen për konsultim publik, duke rritur kapacitetin e publikut për të dhënë opinionin e tyre për projektet në fushën e financave publike.

OJQ-të mund të ndihmojnë MEF-in në hartimin e një plani veprimi për rritjen e transparencës fiskale dhe rritjen e angazhimit publik në këto çështje.

Angazhimi				
Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit	
Suporti për MFE-në në hartimin e Strategjisë së re të MFP-së dhe Raporteve të Monitorimit të MFP-së	Strategjia e re e MFP e përgatitur Raporti i Monitorimit i përgatitur	6M II 2023-6M I 2025	Udhëheqësi: MFE	
			<u>Aktorët e Interesit</u>	
			Qeveria	OSHC-të
			MFE/MFP	Institute for Sustainable Policies
Seminare me OSHC-të (mundësisht organizatorinore) të fokusuar në Sondazhin e Buxhetit të Hapur në Shqipëri 2021, rritja e kapaciteteve në lidhje me sistemin e MFP dhe seanca këshillimi fiskal për target audiencat e synuara (SME, start-up, etj) dhe Organizimi i një seri podcast për të trajtuar aspekte të ndryshme të politikave fiskale.	Aktivitete ndërgjegjësuese të zhvilluara	2024 - 6M I 2025	Udhëheqësi: MFE	
			<u>Aktorët e Interesit</u>	
			Qeveria	OSHC-të
			MFE/MFP	Albanian Initiative for Development Institute for Sustainable Policies Sustainable Finance and Innovation

				Centre			
				Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim			
Trajnim i grave ne biznes ne lidhje me financat publike dhe funksionimin e tyre. Rendesine e pageses se taksave	Modul trajnimi	6M II 2023-2024-6M I 2025	Udhëheqësi: MFE				
			<u>Aktorët e Interesit</u>				
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)		
			MFE/MFP	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim	Parlamenti		

ANGAZHIM 15

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 15: Rritja e transparencës për kontratat publike

1. Pjesa hyrëse

Sistemi i Prokurimit Publik në Shqipëri rregullohet nga Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe akte të tjera nënligjore. Ky ligj përcakton se procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mos-diskriminimit dhe konkurrencës (Neni 3).

Dispozitat e LPP rregullojnë të gjithë procesin e prokurimit nga planifikimi dhe përgatitja, zhvillimi i procedurës së prokurimit publik deri te lidhja dhe implementimi i kontratës. Ligji parashikon se procesi i prokurimit zhvillohet në rrugë elektronike.

Të gjitha njoftimet për prokurimet publike, dokumentat e tenderit, manualët, udhëzimet, rekomandimet dhe dokumenta të tjerë publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (www.app.gov.al)

Që nga viti 2009, të gjitha procedurat e prokurimit në Shqipëri zhvillohen në mënyrë elektronike nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) duke garantuar transparencë për procedurat e prokurimit dhe përdorim eficient të fondeve publike.

Sa i takon koncesioneve dhe PPP-ve, ato zhvillohen në bazë të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe PPP-të”, i ndryshuar.

Një hap shumë i rëndësishëm për transparencë në këtë fushë është krijimi i Regjistrimit Elektronik për Koncesionet dhe PPP-të ku publikohen të gjitha kontratat e koncesioneve dhe PPP-ve.

Gjithsesi, nevoja për transparencë në kontratat publike dhe shpenzimin e fondeve publike është gjithnjë prezente dhe kërkon përpjekje dhe veprime të vazhdueshme për përmirësimin e sistemit në tërësi, përfshirë sistemet elektronike me qëllim garantimin e Standardeve për të dhëna/qeverisje të hapur.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Duke pasur parasysh Parimet dhe standardet e qeverisjes së hapur dhe garantimin e tyre në fushën e prokurimit publik në Shqipëri, ndër vite janë marrë një sërë masash në drejtim të rritjes së transparencës në këtë fushë.

Kështu, të gjitha procedurat e prokurimit në Shqipëri zhvillohen në mënyrë elektronike që nga viti 2009 në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), ku publikohen të gjitha njoftimet e kontratave, dokumentat e tenderit, njoftimet e fituesit dhe të nënshkrimit të kontratës të cilat mund të aksesohen lehtësisht nga çdo person i interesuar. Njëkohësisht, të gjitha këto njoftime publikohen edhe në Buletinin e njoftimeve publike të publikuar në faqen e APP.

Me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës dhe garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe të qendrueshëm, që nga viti 2017 janë marrë një sërë masash dhe reformash për përmirësimin e sistemit të prokurimit në tërësi, ku një vëmendje shumë e madhe i është kushtuar edhe uljes së numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të cilat duke qenë se u mungon elementi i transparencës konsiderohen si një flamur i kuq në kuadër të Standardeve të qeverisjes së hapur.

Në këtë kuadër, përveç ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të Autoriteteve kontraktore për

shmangien e përdorimit të këtyre procedurave dhe parashikimeve ligjore për detyrimin e tyre për të argumentuar nevojën për përdorimin e këtyre llojve procedurave, që nga viti 2018 këto procedura zhvillohen vetëm në rrugë elektronike duke krijuar mundësi për monitorim më të mirë të tyre.

Këto masa kanë rezultuar shumë efektive duke reduktuar ndjeshëm përdorimin e këtyre llojve procedurave nga 31.8% në 2017 në 3.4% në vitin 2021.

Një ligj i ri për prokurimin publik (ligji 162/2020) është miratuar në fund të Dhjetorit 2020 dhe ka hyrë në fuqi në 31 Mars 2021, i cili transponon gjerësisht Direktivat e Bashkimit Europian 2014/24, 2014/25, 89/665 dhe 92/13. Në vijim të miratimit të ligjit të ri dhe hyrjes së tij në fuqi, legjislacioni në këtë fushë është plotësuar me akte nënligjore dhe masa të tjera zbatuese.

Gjithashtu, me miratimin e ligjit të ri, në Sitemin e Prokurimit Elektronik janë përmirësuar një sërë funksionalitetesh si dhe janë futur të reja. Një portal me të dhëna të hapura është përfshirë në faqen e APP duke garantuar akses mbi të dhënat e prokurimeve publike për këdo të interesuar që nga viti 2010.

Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të garantimit të një sistemi prokurimi eficient dhe të qendrueshëm është miratimi për herë të parë në Shqipëri i një Strategjie të dedikuar për prokurimin në vitin 2020 ku përfshihen objektiva dhe masa të detajuara të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të prokurimit, të cilat lidhen edhe me garantimin e transparencës, integritetit, qendueshmërisë dhe efikasitetit në këtë fushë.

Hapa pozitivë në drejtim të rritjes së transparencës janë ndërmarrë gjithashtu edhe në fusha të tjera të cilat janë të lidhura ngushtësisht me prokurimin si koncesionet dhe PPP-të dhe shqyrtimi i ankesave.

Në këtë kuadër, nga viti 2019 është ngritur regjistri elektronik i kontratave të koncesioneve dhe PPP-ve, i cili është një databazë ku publikohen të gjitha kontratat e koncesionit dhe PPP-ve në Shqipëri.

Nga ana tjetër, një sistem i ri për ankesat elektronike është ngritur nga KPP që prej vitit 2021 duke u mundësuar të gjithë personat e interesuar për të dorëzuar ankesa në mënyrë elektronike.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Plani i veprimit është hartuar duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga Partneriteti për Qeverisje të Hapur. Për këtë, janë zhvilluar konsultime edhe me institucione të tjera të përfshira në këtë fushë, sidomos ATRAKO si institucioni kryesor përgjegjës për koncesionet dhe PPP-të.

Një aktor tjetër shumë i rëndësishëm i konsultuar gjatë këtij procesi është edhe Komisioni i Prokurimit Publik, i cili është organi përgjegjës për procesin e rishikimit.

Duke pasur parasysh, rëndësinë për përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile në proces, plani i veprimit është konsultuar gjithashtu me Institutin Shqiptar të Shkencës si organizata kryesore e përfshirë në veprimtari monitoruese për sistemin e prokurimit publik dhe Standardet e Qeverisjes së Hapur.

4. Angazhimet

Duke pasur në konsideratë zhvillimet e ndodhura në vitet e fundit në fushën e prokurimit si edhe rekomandimet e dhëna nga institucione apo organizma të ndryshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të prokurimit në Shqipëri, një aspekt shumë i rëndësishëm i cili vazhdon të mbetet sfidëeshtë garantimi i transparencës në këtë proces.

Për këtë arsye angazhimi kryesor i identifikuar në këtë fushë në kuadër të Qeverisjes së hapur është:

- Rritja e Transparencës për kontratat publike

ANGAZHIM 15

FUSHA: TRANSPARENCA FISKALE

ANGAZHIMI 15: Rritja e transparencës për kontratat publike

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Rritja e Transparencës për kontratat publike		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Angazhimi për rritjen e transparencës për kontratat publike lidhet ngushtësisht me: 1. Rritjen e përdorimit të sistemit elektronik të ankesave 2. Publikimin sistematik të kontratave të koncesionit dhe PPP-ve në regjistrin e koncesioneve dhe PPP-ve; 3. Rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë.		
Udhëheqësi i angazhimit	Agjencia e Prokurimit Publik		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj) KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
	ATRAKO	Instituti Shqiptar i Shkencës	
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

2. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Megjithëse procedurat e prokurimit publik në Shqipëri zhvillohen në mënyrë elektronike që nga viti 2009, ka gjithnjë nevojë për përmirësim dhe rritje të transparencës.

Gjithashtu, bashkëpunimi me shoqërinë civile në këtë kontekst është shumë i rëndësishëm duke kontribuar për përmirësimin e disponibilitetit të të dhënave dhe të sistemit të prourimit në tërësi.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Çdo informacion që lidhet me prokurimin publik, publikohet në faqen e internetit të APP dhe është gjithashtu i disponueshëm në SPE.

Pavarësisht nga sa më sipër, vihet re një mungesë e përgjithshme njohurie dhe informacioni në publik se ku dhe si mund të aksesohet ky informacion duke krijuar perceptimin e gabuar se ka një mungesë transparence.

Për këtë arsye, është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit mbi këtë çështje.

Përshkrimi i Angazhimit

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Një sërë veprimesh të nënmarra tashmë nga Qeveria Shqiptare, ndikon ndjeshëm në rritjen e transparencës në prokurimin publik, konkretisht:

i. Zhvillimi elektronik i procedurave të prokurimit në SPE që prej 2009;

Sikurse u parashtrua edhe më sipër, që nga viti 2009, të gjitha procedurat e prokurimit në Shqipëri zhvillohen në mënyrë elektronike në SPE, duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël dhe, që prej vitit 2018, edhe procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Ky sistem është gjithnjë në përmirësim e sipër, sidomos, duke pasur parasysh ndryshimet ligjore të vitit 2020 dhe miratimin e ligjit të ri të prokurimit po edhe nevojën për garantimin e një sistemi prokurimi eficient, të qendrueshëm dhe transparent në Shqipëri.

ii. Krijimi i një regjistri për koncesionet dhe PPP-të;

Bazuar në nenin 14 “Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat: të Ligjit Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” parashikohet se Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat është një bazë të dhënash elektronike e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë.

Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat krijohet dhe mbahet nga “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)” në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, që nga viti 2019 kur është kirjuar ky regjistër nga ATRAKO çdo koncesion është i regjistruar dhe i publikuar në këtë regjistër.

iii. Futja e një portali të dhënash (open data) në faqen e APP;

Prej vitit 2021, në faqen e APP ka dhe një dritare open data ku mund të aksesohen lehtësisht të dhënat mbi të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga çdo autoritet kontraktor.

Këtu përfshihen të dhëna për të gjitha procedurat e prokurimit që nga viti 2010, të cilat mund të përdoren nga çdo i interesuar sipas nevojave të veta.

iv. Ngritja e një sistemi elektronik të ankesave për paraqitjen e ankesave në mënyrë elektronike

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik implementoi reformën më të rëndësishme të digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave. Kjo reformë, konsiston në dorëzimin në rrugë elektronike të ankesave dhe argumenteve, si dy shërbime të veçanta në portalin unik qeveritar e-albania.

Operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj kanë mundësi, që të dorëzojnë online të gjitha ankesat për procedurat e prokurimit public dhe koncesionet/partneritetet publike private.

Ky sistem, i krijuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ka mundësuar kryerjen në rrugë digjitale, të çdo detyre dhe procesi pune parashikuar nga ligji, si për Autoritetet Kontraktore ashtu dhe për Komisionin e Prokurimit Publik. ofron një transparencë të plotë bazuar në parimet open data, për të cilën Komisioni ka bashkëpunuar me Open Contracting Partnership.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës në kontratat publike duhet ndërmarrë masat e mëposhtme:

- i. Publikim sistematik i kontraatve të koncesioneve dhe PPP-ve në Regjistrin e Koncesioneve dhe PPP-ve;
- ii. Rritja e përdorimit të sistemit elektronik të ankesave nga autoritetet kontraktore dhe nga operatorët ekonomikë;
- iii. Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile për promovimin e standardeve të qeverisjes së hapur për kontratat publike.

3.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Publikimi i të gjitha kontratave të koncesioneve dhe PPP-ve;
- Rritja e numrit të përdoruesve për sistemit elektronik të ankesave;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
<ul style="list-style-type: none"> Publikimi sistematik i kontratave të koncesioneve dhe PPP-ve në regjistrin elektronik 	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha kontrata e koncesioneve dhe PPP-ve të publikuara 	6 M I 2024	Udhëheqësi: APP		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
			ATRAKO		
<ul style="list-style-type: none"> Nxitja e Standardeve dhe parimeve të kontraktimit të hapur (Open Contracting) Integrimi i mjeteve për vlerësimin e riskut Nxitja e strandardit të korporatave të hapura (open corporates_- kontrolli i integritetit per kontraktorët publikë 	<ul style="list-style-type: none"> Mekanizma, instrumenta për vizualisimin e prokurimit publik të njëjësive të qeverisjes vendore (https://openprocurement.al/en/tender/list) Mekanizma, instrumenta për vlerësimine riskut në procedurat e prokurimit dhe indeksi i flamujve të kuq në procesin e prokurimit (https://openprocurement.al/en/index/redflag) 	6 M II 2024	Udhëheqësi: APP		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
				Instituti Shqiptar i Shkencës	
<ul style="list-style-type: none"> Sistemi i dorëzimit dhe menaxhimit të Ankesave Elektronike; 	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e transparencës si mjet në luftën kundër korrupsionitNep ermjet publikimit të të dhënave në kohë 	6M II 2023 – 2024 – 6 M I 2025	Udhëheqësi: APP/KPP		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
			Institucionet Publike (Autoritet	Open Contracting Partnership	

	<p>reale të cilat aksesohen dhe në formatin 'JSON (një nga standardet më të larta të zbatimit të parimeve 'Open data);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ulja e kostove për palët e përfshira në proces kryesisht operatorët ekonomikë dhe jo vetëm (kosto karburanti, tarifa postare, fuqi, etj); - Efikasitet- në ofrmin e shërbimit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesës; - Akses dhe ndërveprim më të shpejtë me operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj dhe autoritete kontraktorë për: <ul style="list-style-type: none"> - Dorëzimin e ankesës - Kryerjen e të gjithë veprimeve të pagesës së tarifave financiare; - Dorëzimin e argumenteve pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit; - Marrjen e informacionit në kohë reale mbi 	<p>et Kontraktore, Subjektet Kontraktore)</p>		
--	---	---	--	--

	<p>ecurinë e procesit të shqyrtimit të ankesës.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të gjithë komunikimet në përputhje me ligjin e prokurimit publik autoritet kontraktor-operator ekonomik-Komision i Prokurimit Publik vetëm në formë elektronike (shqyrtimi i ankesës, dhënia e vendimit përfundimtar, njoftimi i palëve); – Kryerja e veprimeve procedurale të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Ankesave (veprimet procedurale të shortimit të dosjeve, caktimit të realatorëve, inspektorëve, komunikimin me palë të treta etj); – Akses nga personat me aftësi të kufizuar 			
--	---	--	--	--

<ul style="list-style-type: none"> - Faqja e re webit të Komisionit të Prokurimit Publik https://kpp.al/bazuar në parimin open data, të Open Contracting Partnership; 	<ul style="list-style-type: none"> - Transparencë dhe aksesshueshmëri për të gjithë aktorët përdorues të tij që të aksesojnë informacione të detajuara në lidhje me: <ul style="list-style-type: none"> - ankesat e depozituara, - vendimarrjen, - historikun e vendimarrjes në tre regjistrat e publikuar: <ul style="list-style-type: none"> - Regjistri i ankesave; - Regjistri i vendimeve; - Historiku i vendimeve; - statistika https://kpp.al/RaporteStatistikore - Raporte vjetore https://kpp.al/Raporte) - buletine mujore, - ecurinë e vendimmarrjeve të KPP-së të ankimuara në gjykatë, përfshirë vendimmarrjet e sistemit gjyqësor - Publikon të dhënat sipas Standardit të të dhënave të hapura kontraktuese (OCDS), për më shumë klikoni në linkun https://kpp.al/en/ 	<p>6M II 2023 - 2024</p>	
---	---	------------------------------	--

	AnkesaOCDS		
- Aktivitete me pjesëmarrje të	- Adresim të problematikave	6M II 2023	Udhëheqësi: APP/KPP <u>Aktorët e Interesit</u>

			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,Sektor
<p>palëve të interesit – Konferenca vjetore “sfidat e sistemit të prokurimit në Shqipëri me pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktorë, medias etj</p>	<p>të hasura nga palët në proces</p> <ul style="list-style-type: none"> – Shmangia dy herë e të njëjtit gabim nga autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë. 	2024	Institucionet Publike (Autoritetet et Kontraktore, Subjektet Kontraktore)	Open Contracting Partnership	
<ul style="list-style-type: none"> – Trajnime me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore/entitet kontraktore. Aspekti procedural dhe ligjor i paraqitjes së ankesave në sistemin e ankesave elektronike 	<ul style="list-style-type: none"> – Rritja e kapaciteteve të paleve të përfshira në proces 	2024			
<ul style="list-style-type: none"> – workshop me gjyqtarë nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata Speciale e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pjesëmarrës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Byroja Kombëtare e Hetimit, SIGMA - OECD 	<ul style="list-style-type: none"> – Kuptim më i mirë dhe rritja e kapaciteteve të paleve të përfshira për eliminimin e rreziqeve lidhur me integritetin problematike në procedurave të prokurimit publik. 	6M II 2023-2024			

ANGAZHIM 16

FUSHA: SHËRBIMET PUBLIKE

ANGAZHIMI 16: Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen

1.Pjesa hyrëse

Në kuadër të fazës së tretë për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur 2023-2025, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka punuar:

- Formatin për hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025
- Rendi i ditës dhe raporti konsultativ i marrë nga takimet

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, gjatë mbledhjes së Komitetit, prezantoi një angazhim specifik prioritar: “Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen”, në bazë të së cilës u plotësua Formatin e Planit të Veprimit 2023-2025.

Angazhimet e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes lidhen ngushtë me:

Ligjin “Për MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUPEVE”

Ligjin “Për DHOMAT E TREGTISË DHE INDUSTRIË”.

Gjithashtu thelbësore për përmbushjen e misionit të saj, MiSHMS ka angazhimin e saj në monitorimin e treguesve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen si dhe propozimin e mekanizmave institucional/ndërinstitucional në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka mbështetur dhe promovuar sipërmarrjen në Shqipëri, nëpërmjet transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asistencën e startupeve dhe sipërmarrjeve në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore në lidhje me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, përballë institucioneve publike; ndërmjetësimin e komunikimit dhe zhvillimin e partneriteteve të biznesit me institucionet publike.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Procesi i Bashkëbërjes

Në vijim të proceseve të lidhura me Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (OGP-Open Government Partnership), si edhe në ndjekje të shkresës me nr.prot.6493, dt. 22.11.2022, “Mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023-2025”, filluam procesin e bashkë-bërjes së planit të veprimit 2023-2025, të OGP.

Lidhur me procesin për këtë fazë u zhvillua një takim pune në datën 6 janar 2023, në Kryeministri, ora 10:30, me qëllim diskutimin dhe angazhimin tonë të plotë në këtë proces.

Sipas Planit të Punës, Procesi i Bashkëbërjes përfshinte (i) përgatitjen, (ii) shpërndarjen dhe (iii) publikimin e një pyetësori tematik, sipas fushave të përgjegjësisë, në përputhje me parimet e OGPsë, përmes të cilit identifikohen fushat prioritare/angazhimet prioritare/masat prioritare etj.

Me datë 10.01.2023 u përgatit pyetësori tematik, sipas fushave të përgjegjësisë të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përputhje me parimet e OGP – së përmes të cilit identifikohen fushat prioritare të MiSHMS.

Ky pyetësor u publikua në faqen e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe u shpërnda në çdo mënyrë zyrtare tek organizatat, grupet e interesit me të cilët ministria bashkëpunon.

<https://siper marrja.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/>

Publikimi u shoqërua edhe me një tekst, i cili përmbante adresën e kontaktit dhe afatin brenda të cilit do të dërgohej kontributi (afati fundor i mbylljes së marrjes së feedback, dt 18.01.2023).

Organizatrat, grupet e interesit u treguan të gatshëm të japin kontributin e tyre në plotësimin e pyetësorit brenda afatit të përcaktuar.

Dy propozimet e dhëna nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ishin:

Propozimi 1: Mbështetja dhe zhvillimi i startup - eve nëpërmjet ligjit të startup - eve

Propozimi 2: Përmirësimi i klimës së investimeve në vend, nëpërmjet ligjit të dhomave të tregtisë dhe industrisë

Të anketuarit ju përgjigjen pyetjeve si dhe dhanë propozimet e tyre për vendosjen e një angazhimi të ri në përmirësimin e klimës së investimeve në vend si dhe për vendosjen e një angazhimi të ri në fushën e startup – eve dhe inovacionit.

Sipas tyre një OSHC dhe/apo grup i interesuar mund të kontribuojë në propozimet që kane dhënë nëpërmjet:

1. Dhënia vetëm e idesë së propozimit
2. Implementimi
3. Ndërgjegjësimi

4. Financimi i një aktiviteti/iniciative konkrete

Gjithashtu me datë 18 Janar 2023, nga ora 11:00 deri në orën 13:00, u zhvillua takimi online në platformën Teams.

Në takim morën pjesë 58 përfaqësues të ekosistemit, të cilët u informuan mbi arsyen e takimit, u ndërgjegjësuam mbi pyetësin dhe qëllimin e nismës dhe dhanë opinionet dhe propozimet e tyre për secilën prioritet të MiSHMS.

Produkti final u finalizua dhe u dërgua zyrtarisht pranë Kabinetit të MSHSSH/Departamentit, me datë 19.01.2023.

Relacioni përmbledhës mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023 – 2025 përmbante:

1. Evidencën e takimit me OSHC-të për konsultimin e prioriteteve në kuadër të inicimit të procesit të PKV 2023-2025
2. Raportin lidhur me pyetësin tematik (përmbledhje informative mbi rezultatet e pyetësorit)
3. Listën e prioriteteve/fushave prioritare/angazhimeve

Kjo e fundit përfshinte 5 priorite/fusha prioritare/angazhime të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të shpjeguara si më poshtë:

1. Misioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.
2. Shqyrtimi, ndjekja dhe trajtimi i ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre.
3. Përpunimi dhe propozimi i përmirësimeve të nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional.
4. Promovimi i transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike.
5. Angazhimi i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen si dhe propozimi i mekanizmave

institucionalë/ndërinstitucionalë në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen, është gjithashtu themelor për përmbushjen e misionit të tij.

Mbledhja e Komitetit Shumëpalësh Mbi Partneritetin Për Qeverisje Të Hapur

Me datë 09.02.2023 u mbajt Mbledhja e Komitetit Shumëpalësh Mbi Partneritetin Për Qeverisje Të Hapur.

Çështjet e diskutuara sipas rendit të ditës ishin:

- Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve dhe të ftuarëve në Komitet.
- Konkluzionet Operacionale.
- Dokumenti i Prioriteteve.
- Raporti i Bashkë-bërjes për identifikimin e prioriteteve.
- Evidencat e procesit të bashkë-bërjes.

Në këtë mbledhje MiSHMS prezantoi një angazhim prioritar specifikisht:

“Promovimin dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen”.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile.

Hartimi i Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur

Në vijim të shkresës me nr.prot.6493, dt. 22.11.2022, “Mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023-2025”, me datë 16 shkurt 2023, ora 10.30, u zhvillua takimi, në sallën e Mbledhjeve (në Kryeministri).

Në takim u dhanë sqarime dhe u diskutua lidhur me plotësimin e formatit për Planin e Veprimit 2023-2025, sipas angazhimeve prioritare të miratuara nga Komiteti OGP.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, gjatë mbledhjes së Komitetit, prezantoi një angazhim prioritar specifikisht: “Promovimin dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen”, në bazë të së cilës u plotësua edhe Formatit i Planit të Veprimit 2023-2025.

Në kuadër të fazës së tretë për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 pranë ambienteve të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes u zhvilluan dy takime.

Takimi i parë u zhvillua ditën e Hënë datë 20/02/2023 orën 12:00 me përfaqësues nga Destil Creative Hub (OJF) dhe Akademia e Grave Sipërmarrëse në Shqipëri. Në këtë takim u diskutua mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2023-2025, si dhe ju vendos në dispozicion edhe formati i Planit të Veprimit. Takimi informues zgjati dy orë dhe Znj. Sonila Abdalli u tregua e gatshme të jap kontributin e saj edhe në fazën e tretë të këtij procesi.

Takimi i dytë u zhvillua online në platformën Teams më datë 23 Shkurt 2023, nga ora 10:00 deri në orën 12:00. Diskutuam me Znj. Sonila Abdalli lidhur me plotësimin e formatit për Planin e Veprimit 2023-2025, sipas angazhimeve prioritare të miratuara nga Komiteti OGP.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka realizuar disa aktivitete dhe takime me Destil Creative Hub, ku i fundit është ai i datës 19/12/2022 pranë ambienteve të Ministrisë.

Të pranishme në këtë takim ishin edhe Akademia e Grave Sipërmarrëse në Shqipëri një projekt që implementohet nga Destil Creative Hub.

Gjithashtu pjesë e diskutimit ishte edhe bashkëpunimi në vazhdimësi dhe realizimi i aktiviteteve të Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me qendrën Destil Creative Hub.

4. Angazhimet

“Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike drejt sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen”

ANGAZHIM 16

FUSHA: SHËRBIMET PUBLIKE

ANGAZHIMI 16: Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen

Vendi	Shqipëria		
Emërtimi i angazhimit	“Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike drejt sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen”		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Mbështetja dhe promovimi i sipërmarrjes në Shqipëri, nëpërmjet transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asistimi i startup-eve dhe sipërmarrjeve në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore në lidhje me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, përballë institucioneve publike; ndërmjetësimin e komunikimit dhe zhvillimin e partneriteteve të biznesit me institucionet publike.		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektori Privat, etj) Startup dhe Sipërmarrësit
	MiSHMS	Destil Creative Hub NGO	
Periudha e implementimit	2023 – 2025		

Identifikimi i problemit

4. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Deri në vitin 2022 nuk kishte pasur asnjë përfshirje të bazuar në fakte dhe të koordinuar të qeverisë në fushën e promovimit të sipërmarrjes, kështu që përpjekjet tona të fundit ishin të orientuara drejt zhvillimit të “Ligjit për start-up” në një qasje të përbashkët bashkëpunuese. Pas miratimit të ligjit dhe akteve nënligjore të tij, ekosistemi u mbështet me asistencë financiare në

total prej 300 milionë lekësh dhe këshillim falas në fushën ligjore dhe financiare nga qeveria, konkretisht nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Janë mbështetur financiarisht 29 startup dhe 29 lehtësues të ekosistemit të startup-eve.

Dialogu mes ekosistemit dhe qeverisë vazhdoi të lulëzojë, me misionin e MiSHMS për të pasur “një derë të hapur” për të gjithë aktorët e ekosistemit startup dhe kjo ndodhi fjalë për fjalë duke organizuar Javën Globale të Sipërmarrjes dhe aktivitetet e saj për të dytin vit brenda zyrave të MiSHMS. Takime me aktorë të ndryshëm, diskutime për tema të ndryshme nga përfshirja e qeverisë dhe politikëbërja, procesi i vlerësimit të aplikimeve për grante, pasaportat e startup-it dhe lehtësuesit si dhe prioritetet e thirrjes së radhës.

2.Cilat janë shkaqet e problemit?

Shkaku kryesor i problemit duket se ka qenë burokracia dhe përpjekjet e pakta të qeverisë për të mbështetur dhe promovuar startup-et dhe sipërmarrësit novatorë.

Këto ekosisteme janë shumë të shkathëta dhe me ritme shumë të shpejta, që do të thotë se ata punojnë me ritme të ndryshme dhe qasje të ndryshme në vend të administratës publike.

Përshkrimi i Angazhimit

5. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Zgjidhja e parë ka qenë ndryshimi i qasjes së ekipit të MiSHMS ndaj punës dhe bashkëpunimit me këtë ekosistem. Stafit është trajnuar dhe ka hulumtuar shumë në fushën e inovacionit dhe sipërmarrjes dhe është njohur me metodologjinë e "mendimit inovativ" që ishte mënyra më e shpejtë për të ndërtuar një urë besimi me ekosistemin.

Zgjidhja tjetër dorë për dorë ka qenë transparenca në formatin e aplikimit për thirrjen e parë, ku gjithçka ka qenë online, aplikimi, rezultatet dhe publikimi i përfituesve.

2.Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Ajo që bëme vitin e kaluar ishte mjaft progresive dhe e suksesshme, por ajo që propozojmë të bëjmë këtë vit do të ketë patjetër rezultate më të mira. Për thirrjen e hapur për grante për ekosistemin startup në 2023, ne po bashkëpunojmë me Agjencinë Kombëtare të TIK-ut për të zhvilluar një sistem online në e-albania. Sistemi do të veprojë si një bazë të dhënash për të gjitha aplikimet e pranuar si dhe një sistem vlerësimi për to. Komisioni i Vlerësimit do të ketë mundësinë të bëjë vlerësimin e tyre online dhe çdo aplikant do të dijë se sa pikë ka marrë dhe do të renditë automatikisht aplikimet me pikët më të larta.

3.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Me këtë praktikë ne synojmë të ofrojmë një proces plotësisht transparent për aplikantët dhe ekosistemin, duke zhvilluar dhe mirëmbajtur një sistem transparent online, i cili përveçse është inovativ, përputhet plotësisht me drejtimit dhe objektivat e OGP.

Rezultatet mund të maten duke filluar nga perceptimi i ekosistemit të transparencës së qeverisë deri tek një qasje më inovative e qeverisë për përdorimin e mjeteve dhe platformave online për të ndërvepruar me komunitetin.

Angazhimi					
Aktivitetet/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike drejt sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës përsipërmarrjen.	Promovimi i përpjekjeve të qeverisë nëpërmjet MiSHMS-së në ekosistemin startup shqiptar	6M I 2025	Udhëheqësi: MiSHMS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë
			AKSH I	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Startup Ekosistemi në Shqipëri
Zhvillimi i platformës në e-albania për aplikimet e thirrjes së hapur për grante për startup-et dhe lehtësuesit në 2023 1.1 Zhvillimi i sistemit të brendshëm që do të shërbejë si serveri kryesor për platformën në të cilën do të pranohen aplikimet për grante 1.2 Zhvillimi i sistemit të vlerësimit online i cili do të integrohet në platformë 1.3 Baza e të dhënave plotësisht operative e aplikantëve në platformën në e-albania 1.4 Mirëmbajtja e platformës dhe bazës së të dhënave të saj	1.1 Zhvillimi i sistemit të brendshëm që do të shërbejë si serveri kryesor për platformën në të cilën do të pranohen aplikimet për grante	6M II 2023	Udhëheqësi: MiSHMS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë
	1.2 Zhvillimi i sistemit të vlerësimit online i cili do të integrohet në platformë	1.2 Zhvillimi i sistemit të vlerësimit online i cili do të integrohet në platformë	6MI 2024	Udhëheqësi: MiSHMS	
				Aktorët e Interesit	
				Qeveria	OSHC-të
1.3 Baza e të dhënave plotësisht operative e aplikantëve në platformën në e-albania	1.3 Baza e të dhënave plotësisht operative e aplikantëve në platformën në e-albania	6M II 2024	Udhëheqësi: MiSHMS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë
			AKSH I	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Startup Ekosistemi në Shqipëri
			AKSH I	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Startup Ekosistemi në Shqipëri
			AKSH I	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Startup Ekosistemi në Shqipëri
			AKSH I	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Startup Ekosistemi në Shqipëri

				ICTS	
1.4 Mirëmbajtja e platformës dhe bazës së të dhënave të saj		6M I 2025	Udhëheqësi: MiSHMS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë
			AKS HI	Qendra Protik Qendra Metaverse DCH ICTS	Ekosistemi i startupeve

ANGAZHIM 17

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 17: Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) harton dhe zbaton politika dhe programe që përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale. MSHMS bëshkëpunon me institucionet dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të mirëqeverisjes dhe transparencës. Në kuadër të zbatimit të një sërë reformash të ndërrmara nga MSHMS OSHC-të janë identifikuar si partnerë mbështetës që në fazën e konceptimit, draftimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre. Përfaqësues të OSHC-ve janë anëtarë të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këto struktura kombëtare kanë në funksion të tyre kontekstin e partneritetit dhe gjithëpërfshirjes, duke trajtuar të gjitha angazhimet e përfshira në dokumentet politikë e strategjikë, aktet ligjore apo nënligjore si dhe projekt buxhetet përfshirë këtu edhe grupet e interesit.

Fondi Social është mekanizmi i cili i mundëson qeverisjes vendore mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit për ngritjen e shërbimeve sociale të munguara në komunitet. Përmes këtij mekanizmi janë ngritur 40 shërbimeve të reja në 26 Bashki dhe 6 qarqe, që mbulojnë pjesën më të madhe të territorit me shërbime sociale komunitare dhe të specializuara për të gjitha grupet në nevojë.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023 ka shërbyer si një mjet zhvillimi për të dhënë informacion mbi përparimin e bërë në një periudhë të caktuar kohe, problemet e hasura, përmirësimin e politikave të mbrojtjes sociale të Qeverisë dhe proceset e llogaridhënies, si edhe përmirësimin e bashkëpunimit të sektorit publik me atë jopublik.

Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 (AKKP) është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 659, më 03.11.2021. Vizioni i AKDF-swështë të krijojë një mjedis pozitiv për mirëqenien e fëmijëve përmes aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të të gjitha formave të dhunës dhe zhvillimit dixhital. Në hartimin e politikës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve angazhuan të gjithë spektrin e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Aktualisht, monitorimi afatmesëm i politikës po kryhet në konsultim të plotë me grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile. Në mënyrë të ngjashme, fëmijët janë përfshirë në proceset e hartimit dhe monitorimit të ADKF-së, duke përcjellë zërin e tyre mbi prioritetin e veprimeve. Është siguruar përfaqësimi i fëmijëve nga komunitete të ndryshme vulnerabël, duke përfshirë fëmijët në përkujdesje rezidenciale, fëmijët romë dhe egjiptianë dhe ata me aftësi të kufizuara.

“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030” është përgatitur në emër të Qeverisë

së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen ebarazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

MSHMS për hartimin dhe finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit LGBTIQ 2021-2027 është angazhuar për procesin e konsultimit përgjatë 8 muajve (janar-gusht 2021) nëpërmjet takimeve, ërkshopeve online, mbledhje të mendimeve dhe sugjerimeve, etj me institucione publike, institucione të pavaruara, këshillin e Evropës dhe organizata të shoqërisë civile.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Çdo strategji, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe projektbuxheti vjetor kalojnë në konsultim publik me organizatat apo grupet e interesit si përfaqësues të shoqërisë civile në kuadër të transparendës dhe partneritetit. Procesi i ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut e në mënyrë të veçantë të grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse është një produkt i cili gjendet i parashikuar në disa nga politikat, strategjitë dhe nismat e MSHMS të hartuara dhe që do të zbatohen në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

Kontributi i organizatave të shoqërisë civile është i fokusuar kryesisht në mbështetjen e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, Plani kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për grupet më vulnerabël për aksesin në shërbime të kujdesit shoqëror.

4. Angazhimet

Këto strategji dhe politika kanë të përfshira në matricën e veprimtarive aktivitete që synojnë angazhimin e institucioneve në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile në sigurimin e gjithëpërfshirjes në funksion të përmirësimit të aksesit të shërbimeve duke adresuar nevojat e grupeve vulnerabël.

AKDF 2021-2026 angazhohet të vendosë konsultimin me fëmijët si një instrument/mekanizëm i qëndrueshëm për të ushqyer monitorimin dhe hartimin e dokumentit me perspektivat e fëmijëve.

Gjithashtu, do të kërkohet angazhimi i organizatave të shoqërisë civile për hartimin e planeve të veprimit në përgjigje të rekomandimeve të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe CEDAW.

ANGAZHIM 17

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 17: Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut e në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies të forcohet në kontekstin e implementimit të Strategjive dhe Planeve të Veprimit për grupet vulnerabël nëpërmjet lehtësimin në aksesin për marrjen e shërbimeve publike, në partneritet me organizatat e shoqërisë civile, në cdo nivel qeverisjeje qëndror dhe vendor		
Udhëheqësi i angazhimit	MSHMS dhe OSHC-të		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
	MSHMS Ministritë e linjës Institucione të pavarura	OSHC përfaqësues në Këshillat Kombëtarë për • Shoqërinë civile • Barazinë gjinore • Të drejtat e Fëmijëve • Personat me AK • OSHC të tjera Partnerë strategjikë	
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Qasja në konsultimin publik dhe informacioni mbi shërbimet duhet të garantoj akses të barabartë për gjithë grupet vulnerabël.

Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut e në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse është një angazhim i parashikuar nga MSHMS në kuadër të zbatimit të jo vetëm politikave dhe strategjive por dhe si një qasje e shtuar për të rritur ndërveprimin me organizatat e shoqërisë civile duke kontribuar bashkarisht në rritjen e ndërgjegjësimit të një publiku ehd emë gjerë në zona urbane dhe rurale.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Grupet vulnerabël ndeshen me barriera, të cilat nuk i lejojnë aksesueshmëri në shërbimet gjithëpërfshirëse, si pasojë e kushteve socio-ekonomike, arsimimit, vendbanimit si dhe mungesës së infrastrukturës së nevojshme. Nevoja për të ndërgjegjësuar mbi një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror për cdo burrë, grua, djalë dhe vajzë, sistem që promovon zgjedhjen, pavarësinë dhe inkurajon pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri, sipas një qasjeje të barabartë për të gjithë qytetarët që kërkojnë shërbime të nevojshme në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

Përshkrimi i Angazhimit

2. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bashkëpunim në vijimësi me gjithë institucionet dhe shoqërinë civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Në zbatim të kuadrit ligjor dhe strategjik për barazinë gjinore, anti-diskriminimin, të drejtat e fëmijëve si dhe grupe të veçanta si Romët/Egjiptianët, Personat me Aftësi të Kufizuara, monitoron masa të cilat janë ndërinstitucionale dhe ka një bashkëpunim në vijimësi me shoqërinë civile.

Njëkohësisht, OSHC përfaqësohen me anëtarë në Këshillat Kombëtarë si: Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile; Barazinë Gjinore; Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve; Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuara, sipas përcaktimeve ligjore respektive.

Këshilli Kombëtar I Shoqërisë Civile I udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku shoqëria civile ka një pjesëmarrje në planifikimim buxhetimin dhe monitorimit e politikave kombëtare dhe vendore.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është një organ këshillimor për Qeverinë. Kjo strukturë ngrihet bazuar në Nenin 11 të Ligjit Nr.9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (LBGJ), VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore” dhe Urdhërit të Kryeministrit Nr. 239, datë 13.12.2017 “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”.

KKBGJ kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, dhe në përbërje ka 10

përfaqësues nga Qeveria dhe 3 përfaqësues të OJF-ve.

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës mblidhet në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar me VKM. Nr. 54, datë 31.01.2018. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, është një organ këshillimor dhe ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Këshilli përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) funksionon bazuar mbi Vendimin Nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” (i ndryshuar). Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët

- 10 anëtarë janë nga Ministrinë e linjës në nivel ministri.
- 7 përfaqësues të/për personat me aftësi të kufizuara,

Në kontekstin e transparencës, dokumentat strategjike, aktet ligjore dhe nënligjore, për të dy fushat e përgjegjësisë së MSHMS-së: shëndetësi dhe mbrojtjes sociale, kalojnë në procese konsultimi të hapur dhe janë të publikuara për të mundësuar njohjen dhe ndërgjegjësimin e aktorëve përgjegjës dhe shoqërisë civile.

Dokumentet strategjike në partneritet me organizatat e shoqërisë civile gjatë procesit të konsultimit kanë konfirmuar dhe adresuar nevojën për përfshirjen aktive të të dyja palëve për adresimin e nevojës në rritjen për ndërgjegjësimin e të gjithave grupeve vulnerabël për aksesin në shërbime të integruara aty ku ata jetojnë.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

- Publikimi dhe konsultimi me qytetarët dhe OSHC përfaqësuese të jetë i qëndrueshëm
- Përfaqësuesit e OSHC -ve duhet të trajnohen lidhur me advokimin për politikën dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse.
- Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese për të arritur të gjitha grupet vulnerabël në zona të ndryshme gjeografike me praktike dhe shërbime të dedikuara dhe në kohë reale.

5. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Sisteme të integruara dhe praktika të mira për transparencë me publikun dhe krijimi i sinergjisë midis institucioneve dhe shoqërisë civile.
- Rritja e aksesit në shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse pa barriera për grupet vulnerabël.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Promovimi modeleve pozitive mbi pjesëmarrjen duke mundësuar fuqizimin e grupeve vulnerabël.	Sesione informimi dhe sensibilizuese me shoqërinë civile dhe vetë komunitetet	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në mundësitë e përfitimit nga paketa e shërbimeve sociale të integruara përmes fushatave të komunikimit dhe informimit	Zhvillimi i sesioneve të informimit mbi skemën e shërbimeve të PAK, NE dhe shërbimeve të integruara për qytetarët	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
Ndërgjegjësimi aktorëve institucionalë	Takime dhe aktiviteteve	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		

për garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor, përfshirë mekanizmin për monitorimin e pavarur të Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve	orientuese për aktivizimin e mekanizmave për pjesëmarrjen e fëmijëve	<u>Aktorët e Interesit</u>		
		Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
		MSHMS ASHMDF	World Vision UNICEF Terre des hommes Save the Children Nisma ARSIS	Parlamenti, Bashkitë

ANGAZHIM 18

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 18: Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) harton politika dhe programe që përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale. MSHMS bëshkëpunon me institucionet dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të mirëqeverisjes dhe transparencës. Në kuadër të zbatimit të një sërë reformash të ndërmara nga MSHMS OSHC-të janë identifikuar si partnerë mbështetës që në fazën e konceptimit, draftimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre. Përfaqësues të OSHC-ve janë anëtarë të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këto struktura kombëtare kanë në funksion të tyre kontekstin e partneritetit dhe gjithëpërfshirjes, duke trajtuar të gjitha angazhimet e përfshira në dokumentet politike e strategjike, aktet ligjore apo nënligjore si dhe projekt buxhetet përfshirë këtu edhe grupet e interesit edhe në kuadër të fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve për kategoritë vulnerabël si fëmijët gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 (AKDF), Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, Plani Kombëtar i Veprimit LGBTIQ 2021-2027, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, Plani kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin janë përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

Këto dokumenta strategjike të hartuara dhe konsultura me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile kanë në fokus nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjike për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, produkte që synohen janë çdo burrë, grua, djalë dhe vajzë do të ketë mundësi të barabartë të përfitojë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror kryesisht në vëmendje të grupeve vulnerabël. Realizimi i këtyre produkteve përfshin një angazhim thelbësor që është fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve për kategoritë vulnerabël si fëmijët gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit, etj. Procesi i ngritjes së kapaciteteve është një proces i vazhdueshëm që targeton ndarjen e modeleve dhe praktikave të mira të ngritur nga OSHC-të dhe një vlerë e shtuar në bazë të ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë në bashkëpunim të ngushtë me profesionistët e shërbimit ofruesve publikë dhe aktorëve të tjerë institucionalë.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Çdo strategji, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe projektbuxheti vjetor kalojnë në konsultim publik me organizatat apo grupet e interesit si përfaqësues të shoqërisë civile në kuadër të transparendës dhe partneritetit. Procesi i ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut e në mënyrë të veçantë të grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse është një produkt i cili gjendet i parashikuar në disa nga politikat, strategjitë dhe nismat e MSHMS të hartuara dhe që do të zbatohen në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

Kontributi i organizatave të shoqërisë civile është i fokusuar kryesisht në mbështetjen e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, Plani kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin, etj me fokus fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve për kategoritë vulnerabel si fëmijët gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit, etj.

4. Angazhimet

Këto strategji dhe politika kanë të përfshira në matricën e veprimtarive aktivitete që synojnë angazhimin e institucioneve në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile në fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve për kategoritë vulnerabel si fëmijët gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit, etj.

ANGAZHIM 18

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 18: Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	MSHMS angazhohet që nëpartneritetin dhe ndërveprimin me organizatat e shoqërisë civile për fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit. Angazhimi në këtë partneritet sjell ndarjen modeleve pozitive të ngritjes së kapaciteteve me qasje kombëtre dhe ndërkombëtare.		
Udhëheqësi i angazhimit	MSHMS dhe OSHC-të		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
	MSHMS Ministritë e linjës Institucione të pavarura AMSHC	OSHC përfaqësues në Këshillat Kombëtarë për <ul style="list-style-type: none"> • Shoqërinë civile • Barazinë gjinore • Të drejtat e Fëmijëve • Personat me AK • OSHC të tjera Partnerë strategjikë OSHC	
Periudha e implementimit	2023-2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit si një angazhim i përbashkët i MSHMS me organizatat e shoqërisë civile synon të përmirësojë përgjigjen me shërbime profesionale dhe cilësore nga profesionistë të trajnuar. Modelet dhe praktikatat e mira të zhvillimit të kapaciteteve të profesionistëve që do të vihen në funksion të këtij partneriteti dhe rrisë mbështetjen e grupeve vulnerabël.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Krijimi i një force pune për një sistem të shërbimeve sociale është sfida kryesore e strategjive të sipërmendura. Ndërkohë qësynimi afatgjatëështë forcimi i të gjitha institucioneve që merren me trajnimin dhe përgatitjen e forcës së punës si dhe ngritjen e kapaciteteve në mënyrë të vazhdueshme.

Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti në shërbimet shoqërore nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe masave të tjera përfshin angazhimin e organizatave të shoqërisë civile dhe të praktikave dhe modeleve të tyre kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përshkrimi i Angazhimit

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bashkëpunim në vijimësi me gjithë institucionet dhe shoqërinë civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Në zbatim të kuadrit ligjor dhe strategjik për barazinë gjinore, anti-diskriminimin, të drejtat e fëmijëve si dhe grupe të veçanta si Romët/Egjiptianët, Personat me Aftësi të Kufizuara, monitoron masa të cilat janë ndërinstitucionale dhe ka një bashkëpunim në vijimësi me shoqërinë civile.

Njëkohësisht, OSHC përfaqësohen me anëtarë në Këshillat Kombëtarë si: Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile; Barazinë Gjinore; Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve; Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuar, sipas përcaktimeve ligjore respektive.

Këshilli Kombëtar I Shoqërisë Civile I udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku shoqëria civile ka një pjesëmarrje në planifikimim buxhetimin dhe monitorimit e politikave kombëtare dhe vendore.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është një organ këshillimor për Qeverinë. Kjo strukturë ngrihet bazuar në Nenin 11 të Ligjit Nr.9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (LBGJ), VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore” dhe Urdhërit të Kryeministrit Nr. 239, datë 13.12.2017 “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”.

KKBGJ kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, dhe në përbërje ka 10 përfaqësues nga Qeveria dhe 3 përfaqësues të OJF-ve.

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës mblidhet në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar me VKM. Nr. 54, datë 31.01.2018. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, është një organ këshillimor dhe ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Këshilli përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) funksionon bazuar mbi Vendimin Nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” (i ndryshuar). Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët

- 10 anëtarë janë nga Ministrinë e linjës në nivel ministri.
- 7 përfaqësues të/për personat me aftësi të kufizuara,

Në kontekstin e transparencës, dokumentat strategjike, aktet ligjore dhe nënligjore, për të dy fushat e përgjegjësisë së MSHMS-së: shëndetësi dhe mbrojtjes sociale, kalojnë në procese konsultimi të hapur dhe janë të publikuara për të mundësuar njohjen dhe ndërgjegjësimin e aktorëve përgjegjës dhe shoqërisë civile.

Dokumentet strategjike në partneritet me organizatat e shoqërisë civile gjatë procesit të konsultimit kanë konfirmuar dhe adresuar nevojën për fuqizim të kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabel si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit, etj.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

- MSHMS bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile për koordinimin e veprimeve në kuadër të të gjitha strategjive dhe planeve për të hartuar një plan të konsultuar dhe diskutuar për organizimin e një pakete trajnimesh për profesionistë kryesisht të angazhuar në ofrimin e shërbimeve për kategoritë vulnerabel.

5. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Forcimi i kapaciteteve në nivelet përgjegjëse drejt qasjeve që nxisin përgjigjen profesionale dhe mbështetëse përgjatë ofrimit të shërbimeve për kategoritë më vulnerabel;
- Ndërtimi i kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale dhe llogaridhënies; ngritja e moralit të stafit përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm, të zgjeruar dhe të rregulluar; dhe heqja e barrierave ekzistuese për praktikat e mira dhe aksesin e plotë në shërbime cilësore

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Përmirësimi i kapaciteteve të punonjësve nga sektorë të ndryshëm si kujdesi social, policia, media etj., në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara nga QKEV-ja për përmirësimin e mekanizmit të identifikimit, raportimit dhe referimit të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtje .	Trajnime në të gjithë Shqipërinë mbi bazën e moduleve të certifikuara	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
MSHMS ASHDMF SHSSH MB MAS MD	World Vision Terre des hommes UNICEF Save the Children Nisma ARSIS	Parlamenti i “Grupi i Deputetëve e Miqtë e Fëmijëve”			
Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve ofrues të shërbimeve sociale për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit, etj.	Trajnime në të gjithë Shqipërinë	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S sektori Privat,et j)
MSHMS SHSSH ASHDMF Policia e Shtetit Gjykatat NJVNR	World Vision Terre des hommes Unicef Save the Children	Parlamenti, Bashkitë			
Trajnimi i stafit të administratës shtetërore vendore përgjegjës për përfshirjen në dëgjesat publike të grave në të	Trajnime me punonjës	6 M II 2023-6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti,S

gjitha diversitetet e tyre (d.m.th. nga zonat rurale, nga pakicat etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuarit, nënat beqare, etj.)			ektori Privat,et j)
	MSHMS	World Vision Terre des hommes Save the Children	Parlament i, Bashkitë

ANGAZHIM 19

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 19: Forcimi i kuadrit monitorues përmes instrumentave dhe mekanizmave të monitorimit në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe dokumentat strategjikë për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) harton politika dhe programe që përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale. MSHMS bëshkëpunon me institucionet dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të mirëqeverisjes dhe transparencës. Në kuadër të zbatimit të një sërë reformash të ndërrmara nga MSHMS OSHC-të janë identifikuar si partnerë mbështetës që në fazën e konceptimit, draftimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre. Përfaqësues të OSHC-ve janë anëtarë të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këto struktura kombëtare kanë në funksion të tyre kontekstin e partneritetit dhe gjithëpërfshirjes, duke trajtuar të gjitha angazhimet e përfshira në dokumentet politike e strategjike, aktet ligjore apo nënligjore si dhe projekt buxhetet përfshirë këtu edhe grupet e interesit edhe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 (AKDF), Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, Plani Kombëtar i Veprimit LGBTIQ 2021-2027, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, Plani kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin janë përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

Këto dokumenta strategjike të hartuara dhe konsultura me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile kanë në fokus nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjike për të përfocuar mekanizmat monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Çdo strategji, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe projekt buxheti vjetor kalojnë në konsultim publik me organizatat apo grupet e interesit si përfaqësues të shoqërisë civile në kuadër të transparencës dhe partneritetit. Procesi i ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut e në mënyrë të veçantë të grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse është një produkt i cili gjendet i parashikuar në disa nga politikat, strategjitë dhe nismat e MSHMS të hartuara dhe që do të zbatohen në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

Kontributi i organizatave të shoqërisë civile është i fokusuar kryesisht në mbështetjen e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, Plani kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin, etj me fokus forcimin e bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta.

Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet dhe masat për një demokraci të qëndrueshme. Shërbimet shoqërore të ofruara përmes sektorit jo-publik -kryesisht të financuara nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë, OJF-të ndërkombëtare dhe organizatat lokale janë përpjekur të mbushin boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike. Bashkëpunimi i mirë midis një qeverie me mendësi të orientuar drejt shërbimit dhe një shoqërie civile aktive, kritike dhe konstruktive përbën një element të domosdoshëm për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe për garantimin e mbrojtjes sociale për të gjitha grupet. Dialogu dhe bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile janë në interesin e drejtpërdrejtë të çdo individi për mirëfunksionimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

4. Angazhimet

Forcimi i kuadrit monitorues përmes instrumentave dhe mekanizmave të monitorimit në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe dokumentat strategjikë për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale.

ANGAZHIM 19

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 19: Forcimi i kuadrit monitorues përmes instrumentave dhe mekanizmave të monitorimit në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe dokumentat strategjikë për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Forcimi i sinergjive midis institucioneve dhe OSHC-ve në proceset e forcimit të kuadrit monitorues.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	MSHMS angazhohet nëpërmirësimin dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe inspektimit për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, rajonal dhe qendror nëpërmjet zhvillimit të partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile.		
Udhëheqësi i angazhimit	MSHMS dhe OSHC-të		
Grupet e Interesit që mbështesin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)

angazhimin	MSHMS Ministritë e linjës Institucione të pavarura AMSHC	World Vision Terre des hommes UNICEF Save the Children
Periudha e implementimit	2023-2025	

Identifikimi i problemit

1.Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

MSHMS synon krijimin e sinergjive ndërmjet institucioneve dhe OSHC-ve për nxitjen dhe monitorimin e planeve të veprimit për grupet vulnerabël.

2.Cilat janë shkaqet e problemit?

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe tëangazhojnë organizatat e shoqërisë civile përgjatë gjithë procesit. Për shkak të mungesës së kohës metodologjive të unifikuara shpesh pjesëmarrja e aktorëve të tretë është e kufizuar dhe me mungesën e pjesëmarrjes përgjatë analizës së përbashkët të procesit. Krijimi i sinergjive midis OSHC-ve dhe MSHMS do të nxisë përfshirjen aktive në procesin e monitorimit.

Përshkrimi i Angazhimit

3.Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bashkëpunim në vijimësi me gjithë institucionet dhe shoqërinë civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Në zbatim të kuadrit ligjor dhe strategjik për barazinë gjinore, anti-diskriminimin, të drejtat e fëmijëve si dhe grupe të veçanta si Romët/Egjiptianët, Personat me Aftësi të Kufizuara, monitoron masa të cilat janë ndërinstitucionale dhe ka një bashkëpunim në vijimësi me shoqërinë civile.

Njëkohësisht, OSHC përfaqësohen me anëtarë në Këshillat Kombëtarë si: Këshilli Kombëtar

për Shoqërinë Civile; Barazinë Gjinore; Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve; Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuar, sipas përcaktimeve ligjore respektive.

Këshilli Kombëtar I Shoqërisë Civile I udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku shoqëria civile ka një pjesëmarrje në planifikimim buxhetimin dhe monitorimit e politikave kombëtare dhe vendore.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është një organ këshillimor për Qeverinë. Kjo strukturë ngrihet bazuar në Nenin 11 të Ligjit Nr.9970,datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (LBGJ), VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore” dhe Urdhërit të Kryeministrit Nr. 239, datë 13.12.2017 “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”.

KKBGJ kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, dhe në përbërje ka 10 përfaqësues nga Qeveria dhe 3 përfaqësues të OJF-ve.

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës mblidhet në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar me VKM. Nr. 54, datë 31.01.2018. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, është një organ këshillimor dhe ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Këshilli përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) funksionon bazuar mbi Vendimin Nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” (i ndryshuar). Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët

-10 anëtarë janë nga Ministrinë e linjës në nivel ministri.

- 7 përfaqësues të/për personat me aftësi të kufizuara,

Në kontekstin e transparencës, dokumentat strategjike, aktet ligjore dhe nënligjore, për të dy fushat e përgjegjësisë së MSHMS-së: shëndetësi dhe mbrojtjes sociale, kalojnë në procese konsultimi të hapur dhe janë të publikuara për të mundësuar njohjen dhe ndërgjegjësimin e aktorëve përgjegjës dhe shoqërisë civile.

Për shembull dokumentet strategjike në partneritet me organizatat e shoqërisë civile gjatë procesit të monitorimit janë shqyrtuar nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ku bëjnë pjesë dhe anëtarë të shoqërisë civile. Kështu, të gjitha raportet e hartuara nga stafi teknik i MSHMS/ASHMDF dhe grupi ndërministror, janë paraqitur pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për rekomandime.

Në të njëjtën kohë, raportet janë të hapura për shoqërinë civile. Një mekanizëm i qëndrueshëm i konsultimit mbi zbatimin e AKDF-së me fëmijët dhe prindërit janë ngritur për të siguruar kontributin e tyre të vazhdueshëm.

Raportet vjetore dhe afatmesëm të monitorimit dhe vlerësimit nga të gjithë dokumentet strategjikë do të paraqiten për rekomandime edhe pranë grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe komitetet drejtuese sektoriale. Çdo vit, raportet monitoruese do të shqyrtohen edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, Grupi Parlamentar “Miqtë e fëmijëve”.

6. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

- Dokumentet strategjikë përcaktojnë role, përgjegjësi si dhe korniza monitorimi të cilat orientojnë të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin me korrektësi dhe respektimin e standardeve të miratuara, duke garantuar një cilësi më të mirë për fëmijët, individin dhe familjen në nevojë.

3.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

- Forcimi i sinergjive midis institucioneve dhe OSHC-ve në proceset e forcimit të kuadrit monitorues
- OSHC-të dhe MSHMS ndërveprojnë vazhdimisht për zbatimin e metodologjive të monitorimit për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies

Angazhimi

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Shqyrtimi dhe koordinimi për adresimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve me përqendrim fëmijët të institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (CRC, CEDAË, UPR);	Takime koordinuese dhe monitoruese Raporte monitorimi	6 M II 2023- 6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
MSHMS ASHD MF	World Vision Terre des hommes UNICEF Save the Children Nisma ARSIS	Parlamenti “Grupi i Deputetëve e Miqtë e Fëmijëve”			
Monitorimi periodik i efektivitetit të CRM në vend dhe koordinimi efektiv i tyre me ato kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit	Raporte monitorimi	6 M II 2023- 6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, et j)
MSHMS	World Vision Terre des hommes Unicef Save the Children	Parlamenti, Bashkitë			
Monitorimi i efektivitetit të shërbimeve të specializuara mbështetëse cdo vit me një metodologji të	Raporte të monitorimit	6 M II 2023- 6 M I 2025	Udhëheqësi: MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, S

unifikuar					ektori Privat,et j)
			MSHM S	World Vision Terre des hommes Save the Children	Parlament i, Bashkitë

ANGAZHIM 20

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 20: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.

1. Pjesa hyrëse

Ministria e Arsimit dhe Sportit në fazën fillestare të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet Qeverisje të Hapur 2023–2025 ka kontribuar duke dërguar paraprakisht paketën e dokumentit të prioriteteve në kuadër të procesit të bashkëbërjes në Zbatim të Planit Kombëtar OGP 2023 – 2025. Gjithashtu u dërguan evidencat e gjithë procesit të ndjekur për identifikimin e e prioriteteve së bashku me shoqërinë Civile. Në Mbledhjen e Komitetit të OGP, të kryesuar Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, u dakordësuan angazhimet prioritare në 8 fusha/komponentë në kuadër të procesit të bashkëbërjes nga 12 institucione kontribuese.

MAS në fazën e parë organizoi 2 takime konsultative me Organizatat e Shoqërisë Civile, në formë hibride, një takim online dhe një në ambjentet e ministrisë për një bashkëbisedim të hapur. Publikim në faqen zyrtare të MAS të pyetësor/sondazhit për të siguruar që publiku të njoftohet për qeverisjen e hapur, OGP, procesin e planit të veprimit, afatet kohore dhe mekanizmat për pjesëmarrje në faza të ndryshme të bashkë-krijimit.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Organizatat e shoqërisë civile OSHC fillimisht u njoftuan nga MAS nëpërmjet postës elektronike në lidhje me procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet Qeverisje të Hapur 2023 -2025. Organizimi i takimit të parë online synoi të garantojë përfshirjen e grupeve të interesit, kryesisht të organizatave të shoqërisë civile në hartimin dhe konsolidimin e komponentëve të planit kombëtar të OGP, me qëllim marrjen e komenteve dhe propozimeve konkrete lidhur me përfitim të masave dhe aktiviteteve të reja në funksion të angazhimeve të propozuara. Qëllimi i konsultimit, në takimin e dytë të zhvilluar në MAS, mbetej diskutimi dhe dakordësimi i pyetësorit –sondazh për përcaktimin e angazhimeve prioritare të Ministrisë së AS në PKV 2023-2025 dhe të rolit të përfshirjes së OSHC-ve në to. Janë njoftuar me email 60 OSHC që kanë veprimtari institucionale të fushës dhe iu dha informacioni i detajuar për procesin e bashkë-hartimit dhe të parimeve të nismës. Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti. Në këto takime u dakordësuan edhe 2 angazhimet prioritare të përfshirjessë MAS në OGP, të cilat më pas u miratuan në Komitet.

3. Procesi i zhvillimit të procesit të Planit të Veprimit

Në fazën e III: Hartimi i Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur.

Në bazë të angazhimeve specifike të institucioneve, përfshirë dhe MAS, filloi puna për hartimin e Planit për analizën e situatës, evidentimin e problematikave specifike për të identifikuar aktivitetet specifike që do të kryhen.

Për këtë qëllim MAS organizoi një takim online në lidhje me diskutimet dhe bashkëbisedimin për aktivitetet dhe produktet e pritshme që do të duhen të kryhen në lidhje me dy angazhimet specifike të dakordësuara dhe miratuara në OGP.

Takimi u zhvillua online në datën 23 shkurt 2023, ora 12.30, nëpërmjet platformës *teams*.

Në këtë fazë lista e OSHC-ve që u njoftuan me email ishte më e madhe, pra nr i OSHC-ve që MAS ftoi për tu bërë pjesë e hartimit të pLanit të veprimit ishte më i lartë. Paraprakisht OSHC u njoftuan për temën e diskutimit dhe u kërkua të propozonin aktivitete konkrete për realizimin e objektivave/prioriteteve të MAS. Gjithashtu u dërgua formati në excel për plotësim nga ana e tyre si dhe formati përfundimtar që duhej raportuar pranë MSHSSH. Propozimet e ardhura nga OSHC- janë reflektuar në këtë dokument.

4. Angazhimet

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të angazhohet në PKV OGP 2023-2025 me dy angazhime kryesore:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.

ANGAZHIM 20

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 20: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.

Vendi	Shqipëria		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojë njohuri, shkathtësi qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake. Prandaj është e rëndësishme përmirësimi i cilësisë, barazisë, gjithëpërfshirjes dhe suksesit nëpërmjet një aksesimi të njëjtë në sistemin arsimor për të gjithë.		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Arsimit dhe Sportit është e angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, së bashku me institucionet e varësisë apo dhe institucione të tjera partnere duke përfshirë në këtë proces edhe OSHC.		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj)
Periudha e implementimit	2023- 2025		

Identifikimi i problemit

1.Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Gjithëpërfshirja në arsim nënkupton krijimin e kushteve që të gjithë djemtë dhe vajzat, pavarësisht aftësive dhe karakteristikave të tjera, të vijnë në mësimet bashkë, duke u kujdesur për nevojat individuale të tyre. Gjithëpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dekadën e fundit, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël.

2.Cilat janë shkaqet e problemit?

Ndërgjegjësimi për gjithëpërfshirjen ka rëndësi pasi gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale.

Përshkrimi i Angazhimit

3.Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Disa nga arritjet e MAS:

- Miratimi i dokumentit “Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen – Profili i mësuesit gjithëpërfshirës” me qëllim evidentimin e aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili mësues, si ai që përgatitet t’i bashkohet radhëve të profesionit të mësuesisë, ashtu dhe ai që është në shërbim, si profesionist gjithëpërfshirës . Kjo ka bërë që edhe shoqëria të ndërgjegjësohet për nevojën e përfshirjes së fëmijëve nga grupet vulnerabël, gjë që ka sjellë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijëve nga pakicat kombëtare romë dhe egjiptiane.

- Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirë planifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore.

- Është realizuar nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Ministrisë së Brendshme (MB) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.

- Është realizuar nxjerrja e Urdhrit të përbashkët të MASR-së, MB-së dhe MSHMS-së nr. 292, datë 28.05.2019 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor””.

Në vitin shkollor 2022-2023 mundësuam një shërbim të ri për regjistrimin online të të gjithë nxënësve në klasën e parë dhe në klasën e dhjetë duke lehtësur dhe përshpejtuar procedurat e

regjistrimit të tyre dhe duke realizuar shërbimin në një kohë më të shkurtër dhe me efektivitet.

- Ka avancuar koordinimi ndërmjet MAS-it, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësisve të vetëqeverisje vendore, duke rivlerësuar gjithë sistemin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për edukimin në fëmijërinë e hershme, bazuar në evidenca dhe studime. Masa përfshin një studim që do të realizohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të qeverisë dhe pritet të ofrojë rekomandime për një bashkërendim më të mirë të veprimtarive midis ministrive përgjegjëse për edukimin parashkollor dhe qeverisjen vendore, për avancimin e menaxhimit të këtij sektori.

- Krijimi i sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë. Në institucionet e arsimit bazë dhe në ZVAP-e krijohen grupe për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në klasën e parë dhe braktisjes, të përbëra nga mësuesit, përfaqësuesit e komunitetit të prindërve dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore. Për këtë hartohen plane të veçanta pune për këto grupe dhe ndërtohet një sistem raportimi për rastet e mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollimit. Braktisja për vitin 2021 - 2022 për arsimin fillor është 0.59% dhe në arsimin e mesëm të ulët 0.65%. Në total në arsimin bazë është 0.62%. Do të vijojë mbështetja me bursë nga shteti për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por që, në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë. Me VKM nr. 511, datë 28.07.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2019-2020””, të ndryshuar, nxënësit nga grupet vulnerabël përveçse me bursë, tekste dhe transport falas, do të mbështeten edhe nga punonjës të veçantë në rolin e mediatorit, që do t’i ndjekin ata në funksion të ndërgjegjësimit, aksesit dhe frekuentimit të procesit mësimor.

- Ofrimi i transportit për nxënës dhe mësues të arsimit bazë, por edhe për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë (AML) të shtresave në nevojë që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Qëllimi është që të rritet pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë, prandaj nxënësve të këtij niveli që plotësojnë kriteret e caktuara, do t’u ofrohet transporti falas. Besohet se një masë e tillë do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes së vajzave nga zonat rurale në AML.

- Në zbatim të Strategjisë të Arsimit 2021-2026 dhe në kuadrin e shumëgjuhësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit prezantoi gjuhën angleze si lëndë në klasën e parë dhe të dytë të arsimit fillor, si dhe një gjuhë të huaj të dytë të detyrueshme në arsimin bazë

- 250 mësues ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara janë shtuar në vitin shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar, duke e çuar numrin e tyre në mbi 1650, me synimin që të përmbushim sa më mirë të gjitha nevojat që kanë këta nxënës për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual, socio-emocional, zhvillimor e fizik të tyre.

- Është forcuar viti pas viti shërbimi psiko-social. Aktualisht një punonjës i shërbimit psiko-social mbulon 300-499 nxënës dhe dy punonjës të shërbimit psiko-social punojnë për cdo shkollë me 500 ose më shumë nxënës.

Në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, një vëmendje e veçantë i kushtohet arsimit të romëve dhe egjiptianëve.

- Gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve romë dhe egjiptianë në arsim e garantojnë dhe

reformat legislative, administrative dhe institucionale. Rezultat i këtyre reformave është krijimi i të dhënave për regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopsht dhe shkollë.

- Në fushën e arsimit, është vlerësuar me përparësi lehtësimi i integritit të fëmijëve dhe të rinjve romë/egjiptianë në kopshte, shkolla e universitete, me synimin që çdo fëmijë rom të shkojë në shkollë, ta ndjekë me arritje të suksesshme dhe ta mbarojë atë brenda moshës. Një aspekt të rëndësishëm për përmbushjen e përparësive për arsimimin e pakicave rome dhe egjiptiane përbëjnë bashkëpunimet e MAS-it me ministritë e linjës, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me grupe interesi, me OJF e shoqata rome/egjiptiane etj., mbështetja e projekteve të ndryshme me fokus fëmijët dhe të rinjtë romë, përfshirja e vetë pakicave rome/egjiptiane në veprimtaritë e përditshme të institucioneve arsimore, duke i bërë prindërit romë/egjiptianë pjesë e zgjidhjes së problemeve të edukimit dhe arsimimit.

- Politikat arsimore u kanë krijuar këtyre pakicave shanse të barabarta për një qasje pozitive ndaj shkollës. Disa nga dokumentet kryesore ligjore e nënligjore, të hartuara në vitin 2013 e në vijim nga MAS-i dhe nga institucionet e linjës, që i shërbejnë integritit të kësaj shtrese të popullsisë, me fokus ofrimin dhe përmirësimin e mundësive për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve romë dhe egjiptianë, janë:

- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026.

- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri (2021-2025).

- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020.

- Me ndryshimet e bëra në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 (me VKM-në nr. 511, datë 28.07.2022, për të frekuentuar rregullisht arsimin, mbështeten me bursë disa kategori sociale si nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë, nxënësit e pakicave rome dhe egjiptiane dhe nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton. Grupet vulnerabil të nxënësve do të përfitojnë, mbështetje nga punonjës të caktuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në rolin e mediatorit për këto grupe, për t'i mbështetur në funksion të ndërgjegjësimit dhe të përmirësimit të aksesit të tyre në arsim. Mediatorët do të shërbejnë për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis grupeve vulnerabil dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, në funksion të rritjes së frekuentimit të procesit mësimor. Nxënësve romë dhe egjiptianë do t'u ofrohen programe të veçanta pas mësimit për kryerjen e detyrave mësimore ose marrjen e mësimave plotësuese.

- Bazuar në ligjin nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në Shqipëri njihen 9 pakica kombëtare. Në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në sistemin arsimor parauniversitar ka institucione arsimore të veçanta ku

mësojnë nxënës të pakicës kombëtare greke dhe të pakicës kombëtare maqedonase, ndërsa nxënësit që i përkasin pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane nuk janë në shkolla të veçanta, por integrohen në institucione arsimore normale, ku kanë qendrat e tyre të banimit.

- Në nenin 10 të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar që personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe

kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore. Për këtë, bazuar në kurrikulën e re, është miratuar udhëzimi nr.20, datë 19.07.2022 “Për përcaktimin e lëndëve mësimore që zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare nga nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë në Shqipëri”.

- Bazuar në këtë udhëzimin, është mundësuar që 70 % e lëndëve mësimore për nxënësit e pakicave greke dhe maqedonase në arsimin bazë të zhvillohen në gjuhën e tyre amtare.

4.Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Angazhimi i shoqërisë civile në ndërgjegjësimin e gjithëpërfshirjes në arsim.

5.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Ky angazhim do të mbështesë vizionin e MAS për ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve,, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre.

ANGAZHIMI

Aktivitetet/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Masa 1.1: Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim			Udhëheqësi:MAS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)

				MEDPAK	
1.1.1.Përmirësimi i rrjeteve sociale, të cilat janë jo gjithëpërfshirëse dhe hapësira të hapura ku nuk kontrollohen gjuha e urrejtjes, diskriminimit, bullizmit	Publikimi	6M II-2023 6M II-2024			
	Takime informuese me prindërit dhe komunitetin për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor				
	Publikimi në rrjete sociale të videove, materialeve sensibilizuese mbi bullizmin, mosdiskriminimin etj	6M II-2023 6M II-2024			
1.1.2 Krijimi i emisioneve në TV kombëtare për ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim dhe ndryshimin e kulturës së deritanishme me qëllim ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse	Emisione në TV me në fokus gjithëpërfshirjen	6M II-2023 - 2024	Udhëheqësi:MAS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MEDPAK		
1.1.3 Asistimi i shkollave në 3 rajone Elbasan, Gjirokaster dhe Mat (3 shkolla për secilin rajon) në rishikimin dhe hartimin e planeve të gjithëpërfshirjes në kuadër të përbushjes të standardeve të shkollave si qendër komunitare	Plan për gjithëpërfshirjen	6M II-2023 - 2024	Udhëheqësi: MAS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			Save the Children		

1.1.4 Trajnimi i mësuesve në përdorimin e metodologjive që stimulojnë edukimin gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme dhe arsimin bazë në 3 rajone Elbasan, Gjirokastër dhe Mat (3 kopshte dhe 3 shkolla për secilin rajon)	Mësues të trajnuar	6M II-2023-2024	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			Save the Children		
1.1.5 Organizimi i sesioneve informuese me prinderit rreth gjithëpërfshirjes në 3 rajone Elbasan, Gjirokaster dhe Mat (3 kopshte dhe 3 shkolla për secilin rajon)	SSE Sesione informuese në 6 institucione	6M II-2023-2024			
1.1.6 Nxitja e 12 rajone të gjithëpërfshirjes së fëmijëve nëpërmjet sportit në 12 rajone (120 shkolla 9 vjeçare publike)	sensibilizuar	6M II-2023-2024	Udhëheqësi:		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
1.1.7 Dekurajimi i braktisjes shkollore përmes përfshirjes së diversitetit në programet e mësimdhënies dhe sigurimit të asistencës ekonomike të familjeve Rome.	Numri i fëmijëve romë të mbështetur me bursa referuar VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2019-2020”,	6M II-2023-2024	Udhëheqësi: MAS, MSHMS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
				MSHMS, Bashkitë	

1.1.8 Sesione informuese me pjesëmarrje rreth dialogut ndërkulturor dhe diversitetit të pakicave minoritare për mësuesit	Mësues të pakicave minoritare të informuar/trajnuar mbi rëndësinë e dialogut kulturor dhe shkëmbim eksperiencash	6M II-2023 - 2024	Udhëheqësi: MAS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, atj)
			Organizatrat Rome dhe Egjiptiane		
1.1.9 Prezantim i gjuhës Rome në sistemin arsimor	Module draft në gjuhën rome	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi: MAS		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, atj)
			IRCA		
Masa prioritare 1.2.: Edukimi i publikut të gjerë mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim			Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
1.2.1 Të fuqizohen të gjitha shkollat si shkolla Qendër komunitare të përhapjes së edukimit, ku mund të punohet për një kulturë gjithëpërfshirëse, ngritja e klubeve të prindërve .	Fuqizimi i shkollave si Shkolla Qendër Komunitare	6M II-2023 - 2024			
1.2.2 Fuqizimi i strukturave të institucioneve brenda shkollë (këshillat e prindërve, bordi i shkollës) dhe përfshirja e prindërve në	Realizimi i aktiviteteve me këtë qëllim	6M II-2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti,

sa më shumë aktivitete. Forcimi i frymës demokratike në këto struktura.					Sektori Privat, etj)
1.2.3 Në momentin kur hartojmë planet për një shkollë të ngrejme grupe pune për të hartuar plane për të gjithë, pra dizenjimi për të gjithë komunitetin e zones ku ndodhet shkolla .	Numri i grupeve të punës të ngritur për hartimin e planeve mësimore	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
1.2.4 Roli i shërbimit psikosocial në edukimin e komunitetit shkollor për rëndesinë e krijimit të kulturës gjithëpërfshirëse.	Protokolleve të shërbimit psikosocial	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
1.2.5 Kurse përme qëllim edukimin e analfabetizmin dhe aftësitë jetësore për gratë dhe vajzat Rome	Takime informuese nënave, trajnime te detyrueshme disa orë në vit, për të drejtat dhe detyrat që kanë ndaj përfshirjes së fëmijëve të tyre në aktivitetet shkollore.	6M II 2023 - 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
				Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), Bashkitë, Qendrat komunitare	

1.2.6 Sigurimi i programeve pas shkollore për nxënësit dhe minoritetin Rom me qëllim uljen e analfabetizmit funksional	Realizimi i programeve pas shkollore me përfshirjen e nxënësve që i përkasin komunitetit Rom	6M II 2023 - 2024			
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			Shkollat Qendër Komunitare, Bashki		

ANGAZHIM 21

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 21: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.

Vendi	Shqipëria		
Emërtimi i angazhimit	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<p>Digjitalizimi i sistemit arsimor shërben për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuon në krijimin e një shoqërie bazuar në dije, nëpërmjet rritjes së aksesit në kurrikula digjitale dhe mundësimin të lidhjes të tyre në internet (100%)". Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në procesin mësimor kontribuon në zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësit, e cila është thelbësore për pjesëmarrjen në mënyrë të efektshme në shoqërinë e informacionit. Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.</p> <p>Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK), ku bëjnë pjesë kompjuterat, tabletat, telefonat SMART, tabelat interaktive dhe aksesorët e tjerë, mund të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në shtimin e motivimit dhe përmirësimin e performancës së nxënësve, duke siguruar që të gjithë nxënësit të përfitojnë nivele të caktuara të kompetencës digjitale për t'iu përshtatur kërkesave të shoqërisë së dijes të shekullit XXI.</p>		
Udhëheqësi i angazhimit	MAS, ASCAP në bashkëpunim me AKSHI-n, për hartimin e politikës për përdorimin e teknologjisë në nivel shkolle, e cila rregullon sigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastrukturës së TIK-ut, përdorimin e pajisjeve nga ana e personelit të shkollës dhe nxënësve, mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet, komunikimin elektronik, etj.		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektori Privat, etj)
		MEDPAK, IRCA, SAVE THE CHILDREN,	
Periudha e implementimit	2023- 2025		

Identifikimi i problemit

3. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Promovimi i aftësive digjitale të nxënësit, si dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie është prioritet në programin e qeverisë, i cili është reflektuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021- 2026.

- mbështetje teknike që siguron efikasitet të përdorimit të infrastrukturës;
- mundësi aksesimi në portalet e arsimit, në përputhje me kurrikulën e planifikuar;
- mundësi aksesimi në portale për nxënësit me aftësi të kufizuara;
- specifikimi i kuadrit ligjor dhe infrastrukturor për shkëmbimin online të informacionit ndërmjet strukturave arsimore.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Në rastin e situatave të paparashikueshme siç janë pandemia ose fatkeqësitë natyrore, TIK-u ofron

mundësi për organizimin e mësimit në distancë, ndërkaq, në situata normale, teknologjia mund të shfrytëzohet për avancimin e procesit mësimor në shkolla. Mësimi në distancë u organizua gjatë pandemisë COVID-19, por vetëm në formë të leksioneve në kohë reale. Kjo situatë emergjente nxiti përdorimin e platformave.

Përshkrimi i Angazhimit

5. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Është krijuar sistemi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të Menaxhimit të Informacionit Paraniversitar SMIP.

Është bërë trajnimi i mësuesve për përdorimin e teknologjisë së informacionit, zhvillimi i materialeve mësimore digjitale – dhe pajisja e shkollave me kompjutera. Janë digjitalizuar shërbimet në institucione arsimore. Përfshirja e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që në klasën e parë të arsimit bazë, dhe është bërë e mundur sigurimi i materialeve dhe burimeve informative mbi përmbajtjen, strukturën dhe organizimin e programit të TIK-ut të klasës së parë në përvojë të vendeve të tjera.

Hartimi i programit të TIK-ut për klasën e parë në bashkëpunim me ekspertin britanik z.Niel McLean (AADF) dhe anëtarët e tjerë të grupit të punës nderinstitucional. (Miratuar nga MAS me urdhër nr.304, datë 10.06.2022)

- redaktimi shkencor dhe letrar i materialeve të prodhuara në kuadër të përfshirjes së TIK-ut që nga klasa e parë të cilat u hartuan nga eksperti britanik z.Niel McLean (AADF):
- Produkti: - Programi i TIK-ut për klasën e parë
- Manuali i mësuesit
- Libri i punës për nxënësit

Në kuadër të **zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë** janë hartuar dhe janë akredituar 14 module trajnimi për zbatimin e standardeve profesionale të mësuesve, me vendimin nr. 3 datë 03.02.2021 të KAPT si dhe 79 module trajnimi me vendimin nr. 166 datë 20.05.2022 në zbatim të kurrikulës me kompetenca, gjithëpërfshirjes, digjitalizimit, shërbimit psiko- social.

Janë krijuar platforma dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e këtyre platformave, që kanë si qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës me kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies dhe për sigurinë kibernetike. Në këtë kuadër, me mbështetjen e UNICEF-it, është hartuar edhe platforma

akademi.al dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e saj në mësimin *online* gjatë pandemisë COVID-19.

6. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.

Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit të shtuar të TIK-ut në të gjitha lëndët në të gjitha nivelet e arsimit duke filluar që nga klasa e parë e arsimit bazë.

Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit.

Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet.

Hartimi i metodologjisë për mësimin *online* nga ASCAP.

3. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit të shtuar të TIK-ut në të gjitha lëndët në të gjitha nivelet e arsimit duke filluar që nga klasa e parë e arsimit bazë.

Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet.

ANGAZHIMI

Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërije të bazuar në dije			Udhëheqësi: MAS, MSHMS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
1.1. Lehtësimi i Minoritetit rom në aksesin e shërbimeve sociale nëpërmjet platformës Online e-Albania	Sesione sensibilizuese mbi rëndësinë e pajisjeve digjitale në arsim	6 M II 2023 – 6M I 2025			
2. Edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërije bazuar në dije	Orë praktike mësimore për prinderit për tu aftësuar në përdorimin e platformave digjitale në laboratorët e shkolles.	6 M II 2023 – 6M II 2024	<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
Edukimi në vazhdim dhe rritja e kapaciteteve të mësuesve në 12 qarqe për përdorimin e platformave digjitale në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.	Mësues të trajnuar	6 M II 2023 – 6M II 2024	Udhëheqësi: MAS		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
		Qeveria	OSHC-të Save the Children	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)	

ANGAZHIM 22

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 22: Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar

1. Pjesa hyrëse

Mekanizmi Kombëtar i referimit ka për qëllim:

- Identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën dhe ri-integrimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit;
- Sigurimin e zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit
- Përmirësimin dhe forcimin e partneritetit të aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit;
- Përbushjen e të gjitha angazhimeve, si pjesë e një qëllimi të përbashkët kombëtar të bashkërenduar kundër trafikimit të personave, rritjes së ndërgjegjësimit publik, si dhe përbushjes së detyrës shoqërore dhe morale të mbështetjes së ri-integrimit të viktimave të trafikimit.

Fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe ndërton disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën sesi zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe, më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Përveç viktimave të trafikimit, kjo marrëveshje merr në mbrojtje edhe viktimat e mundshme të trafikimit, duke synuar kështu ushtrimin e një mbrojtjeje parandaluese për ata persona që mund të jenë viktimat e mundshme të trafikimit. Ky është instrumenti më i rëndësishëm për sa i përket identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese, sesioneve të informimit, trajnimeve dhe workshopeve me profesionistë, etj.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Mekanizmi Kombëtar i Referimit është një model pozitiv dhe tepër efikas, pasi ka në përbërje të tij, institucione dhe struktura shtetërore dhe joshtetërore, si: Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Prokuroria e Përgjithshme, organizatat ndërkombëtare IOM, ARSIS, World Vision, TDH, Mary Ward Loreto Foundation dhe 4 qendrat pritëse dhe riintegruese: Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Organizatat jofitimprurëse “Të ndryshëm e të barabartë”, “Vatra” dhe “Tjetër Vizion”. Secila nga institucionet firmëtare, ka angazhime specifike me qëllim identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe për të siguruar që ato marrin të gjithë mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme.

3. Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit

Procesi i rishikimit të marrëveshjes është produkt i një procesi të gjatë konsultimesh dhe

debatesh konstruktive ndërmjet një numri të konsiderueshëm agjencish të rëndësishme shtetërore, joshitetërore dhe të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare, me një përvojë të gjatë në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të personave, asistimin dhe mbrojtjen e viktimave jo vetëm në Shqipëri, por edhe përtej saj. Kontributi i shoqërisë civile në draftimin e marrëveshjes është vlerë e shtuar dhe, mendimet dhe sugjerimet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare do të përfshihen gjerësisht gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit.

4. Angazhimet

Edhe pse Marrëveshja ekzistuese është një model i mirë, sa i takon bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë antitrafikim, nisur edhe nga problematikat e evidentuara më lart, rivitalizimi i saj është i nevojshëm. Kjo, për disa arsye:

Marrëveshja e re e bashkëpunimit do të:

- reflektojë ristrukturimin e institucioneve/ministrive të përfshira, me strukturat e reja, më aktet ligjore e nënligjore të miratuara dhe do të rrisë angazhimin institucional të secilit anëtar.
- përcaktojë qartë strukturat përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe do të nxjerrë në pah edhe përpjekjet dhe masat e shumta që janë marrë në këtë drejtim.
- përmirësojë koordinimin e përpjekjeve, të strukturave dhe mekanizmave në mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
- përcaktojë modalitetet e veprimit dhe çfarë duhet të bëhet për parandalimin dhe luftimin e fenomenit, duke përcaktuar veprimet konkrete që duhet të bëjnë autoritetet si identifikimin fillestar apo formal, koordinimin institucional, edukimin, trajnimin, informimin, veprimet detyruese të punonjësve të policisë, pushtetit vendor, drejtësisë, inspektorët e punës, punonjësit e kujdesit social, e shëndetësor, zyrat konsullore etj.
- rrisë zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV) nga të gjithë anëtarët e MKR që kanë detyrime sipas PSV-ve. PSV është një dokument themelor për të gjithë aktorët antitrafikim pasi përfshin një zbërthim të detajuar të rolit që ka secili institucion/organizatë dhe veprimeve konkrete që duhen ndërmarrë në çdo fazë të procesit nga momenti i identifikimit fillestar deri në riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit në shoqëri.
- qendërzojë rolin dhe rëndësinë e Autoritetit Përgjegjës si struktura bërthamë e zgjidhjes së rasteve problematike të trafikimit. Nevoja për ndryshim dhe zgjerim i kësaj strukture do të evidentohet nën dritën e ndryshimeve dhe dimensioneve të reja të MKR-së dhe PSV-ve.
- intensifikojë dhe do të nxjerrë në pah, rolin e Task - Forcës së MKR dhe rëndësinë që ajo mbart në monitorimin dhe zbatimin e MKR-së.
- Evidentojë realizimin e zbatimit të saj nga Grupi Ndërinstitucional i Punës për Bashkërendimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, i cili përbëhet nga përfaqësues të secilës prej palëve të Marrëveshjes.

formalizojë qëllimin e përbashkët të të gjithë aktorëve dhe faktorëve antitrafik për përmirësimin e mekanizmit zinxhir të luftës kundër trafikimit nëpërmjet zbatimit efikas të Procedurave Standarde të Veprimit.

ANGAZHIM 22

FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA

ANGAZHIMI 22: Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar

Vendi	Shqipëria		
Emërtimi i angazhimit	Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Përmirësimi i kuadrit institucional në kuadër të rritjes së efektivitetit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, sigurimit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (miratuar me VKM nr. 499, datë 29.08.2018), si dhe krijimi i një mekanizmi bashkëpunimi me anë të të cilit institucionet shtetërore bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë të tjerë në fushën e luftës kundër trafikimit të personave.		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministria e Brendshme		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë (Parlament, Sektor i Privat, etj.) Prokuroria e Përgjithshme Organizata ndërkombëtare Media kombëtare/lokale
	Ministria e Brendshme Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Drejtësisë	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) Organizata Ndërkombëtare “World Vision” - Organizata Jo-Fitimprurëse “Nisma për ndryshim shoqëror ARSIS” Organizata Jo-Fitimprurëse “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit Organizata Jo-Fitimprurëse “Vatra” Organizata Jo-Fitimprurëse “Tjetër Vizion”	

	Fondacioni Mary Ward Loreto (MWL) Organizata “Terre des Hommes”
Periudha e implementimit	2023-2025

Identifikimi i problemit

1.Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Marrëveshja do të mundësojë rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile palë të kësaj marrëveshjeje, si dhe do të rrisë identifikimin, referimin, mbrojtjen, mbështetjen individuale mbështetjen sociale dhe ekonomike dhe drejtësinë penale për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri.

2.Cilat janë shkaqet e problemit?

Marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit përbën marrëveshjen bazë ndërinstitucionale, ndërmjet strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Nga viti 2012, vit në të cilën u nënshkrua Marrëveshja, janë arritur rezultate të rëndësishme, të cilat kanë sjellë një impakt pozitiv jo vetëm në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, por edhe për mbrojtjen e viktimës. Por, përveç arritjeve pozitive janë konstatuar edhe problematika lidhur me zbatimin efektiv të saj.

- Marrëveshja parashikon si aneks të saj VKM nr. 582, datë 27.7.2011, vendim i cili është shfuqizuar me VKM nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.
- Anëtarësimi i disa institucioneve të rëndësishme për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit;
- mungesa e bordit këshillimor të MKR-së, si një faktor i rëndësishëm për monitorimin e zbatimit të saj;
- çështjet epa trajtuara në marrëveshjen aktuale dhe, konkretisht: monitorimi dhe llogaridhënia e MKR-së.

Përshkrimi i Angazhimit

3.Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

- Edhe pse marrëveshja aktuale, ka aneks të saj, VKM nr. 582, datë 27.7.2011, i cili është shfuqizuar, pas miratimit të VKM nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, angazhimet e anëtarëve firmëtare të MKR-së lidhur me identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e

viktimave dhe viktimave të mundshme janë adresuar në zbatim të nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

- Në takimet e MKR-së janë ftuar partnerë të rëndësishëm antitrafikim, sikurse: OSBE, UNICEF, Ambasada amerikane, Ambasada e UK, etj.

4.Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

Duke rishikuar Marrëveshjen e MKR-së do të adresohen problematikat e evidentuara dhe do të zgjerohet roli dhe angazhimi i aktorëve që operojnë në fushën e luftës kundër trafikimit të personave, duke përfshirë struktura të angazhuara në identifikimin, referimin dhe asistencën e rasteve apo në koordinimin kombëtar të menaxhimit të asistencës së rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, sikurse: MD, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, MFE/Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, etj.

5.Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Marrëveshja do të përmirësojë koordinimin e përpjekjeve, të strukturave dhe mekanizmave në mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, do përcaktojë modalitetet e veprimit dhe çfarë duhet të bëhet për parandalimin dhe luftimin e fenomenit, duke përcaktuar veprimet konkrete që duhet të bëjnë autoritetet si identifikimin fillestar apo formal, koordinimin institucional, edukimin, trajnimin, informimin, angazhimet konkrete të punonjësve të policisë, të strukturave ligjzbatuese, njësive të vetëqeverisjes vendore, inspektorëve të punës, punonjësit e kujdesit social, e shëndetësor, zyrat konsullore etj.

Rishikimi i marrëveshjes do të reflektojë gjithashtu udhëzimin e ri të nxjerrë nga OSBE/ODIHR që ka udhëhequr krijimin e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit në shumë vende, do të pasqyrojë ristrukturimin e institucioneve/ministrive të përfshira në marrëveshjen aktuale, aktet ligjore e nënligjore të miratuara gjatë kësaj dekade, si dhe do të sigurojë përmirësimin e çështjeve të pa trajtuara në marrëveshjen aktuale.

Angazhimi

Aktivitetet/Milestones	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Aktivitete në kuadër të Muajit të Luftës kundër Trafikimit të Personave	Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Brendshme		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			MSHMS MAS PSH SHSSH ISHP ASHMDF QKPVT KRAT	IOM World Vision Tjetër Vizion Vatra Të ndryshëm dhe të Barabartë Terre des Hommes ARSIS Mary Ward Loreto Foundation	OSBE UNICEF GIZ Caritas Biznesi privat Media kombëtare /lokale Rrjeti Urat
Takimendërgjegjësues e me grupet vulnerabël lidhur me trafikimin e personave dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit	Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Brendshme		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, et j)
			MSHMS PSH SHSSH ISHP ASHMDF QKPVT	IOM World Vision Tjetër Vizion Vatra	SHSSH ASHMDF KRAT Bashkia Tiranë

			KRAT	Të ndryshëm dhe të Barabartë Terre des Hommes ARSIS Mary Ward Loreto Foundation	
--	--	--	------	---	--

Sesione informuese/forume diskutimi/orë të hapura me nxënës dhe studentë me temë“Mbi parandalimin dhe pasojat e trafikimit të personave në jetën tonë” dhe “Migrimi i pasigurt & rreziku nga trafikimi”; njohja e sistemit të mbrojtjes kundër trafikimit të personave dhe migracionit të pasigurt, në zonat rurale dhe urbane	Zhvillimi itakimeve/sesioneve/forumeve	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Brendshme		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Tëtjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MAS PSH SHSSH ASHMDF KRAT	IOM World Vision Tjetër Vizion Vatra Të ndryshëm dhe të Barabartë Terre des Hommes ARSIS Mary Ward Loreto Foundation	Zyra Arsimore Universiteti
Finalizimi i Marrëveshjes për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar tëReferimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit	Nënshkrimi i MKR-së nga anëtarët	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Ministria e Brendshme		
			Aktorët e Interesit		
			Qeveria	OSHC-të	Tëtjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			MAS MSHMS MEPJ MFE MD PSH ISHPSH ASHMDF	IOM World Vision Tjetër Vizion Vatra Të ndryshëm dhe të Barabartë Terre des	Prokuroria e Pëgjithshme

				Hommes ARSIS Mary Ward Loreto Foundation	
--	--	--	--	--	--

ANGAZHIM 23

FUSHA: E DREJTA NË INFORMIM & KONSULTIM DHE NDIKIM RREGULLATOR

ANGAZHIMI 23: Vlerësimi i ndikimit, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të jenë në themel të një sistemi politik-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson aksesin e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.

1. Pjesa hyrëse

Ka një vëmendje në rritje ndaj hapjes dhe transparencës së politikëbërjes, si në nivelin global ashtu edhe atë rajonal, në kuadër të “Partneritet për Qeverisje të Hapur” (OGP) dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Një qasje e tillë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e kërkesave që lidhen me reformën e administratës publike, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit si dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Për këtë qëllim, me rëndësi në këtë proces është dhe përfshirja dhe angazhimi i palëve të interesuara dhe publikut për të dhënë mendimet dhe qëndrimet e tyre. Konsultimi Publik kontribuon në forcimin e besimit në institucionet publike, sundimin e ligjit dhe demokracinë. Institucionet publike përforcohen nga konsultimi publik në procesin e vendimmarrjes dhe kjo orienton drejt politikave të qëndrueshme që plotësojnë nevojat e shoqërisë.

Politikëbërja efektive dhe e bazuar në të dhëna përfshin dhe analizën e vlerësimit të politikave, si një element thelbësor për analizimin e politikave, e cila çon në rezultate më të mira rregullatore. Veprimet e qeverisë duhet të vendosen në një kontekst të gjerë, që merr parasysh të gjitha efektet e mundshme të tyre. Përkufizimi i problemit, përcaktimi i objektivave dhe opsioneve, si dhe identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve bëhen më cilësore falë procesit të konsultimit të brendshëm dhe konsultimit publik.

Vlerësimi i ndikimit është një mjet i njohur ndërkombëtarisht dhe shumë i rëndësishëm që kontribuon në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave/legjislationit, të bazuar në prova dhe dëshmi të një cilësie të mirë. VN përfshin gjithashtu analizën e të gjitha kostove dhe përfitimeve që mund të sjellin politikat e propozuara, si dhe mbledhjen e të dhënave dhe informacionit mbi pasojat e risqet e mundshme të këtyre politikave.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Shqipëria u bë pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur në Shtator 2011, duke dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në mbështetje të vlerave dhe parimeve që janë në themel të

kësaj nisme mbarëbotërore si hapja, komunikimi dhe gjithë përfshirja për një qeverisje llogaridhënëse, transparente dhe të përgjegjshme.

Shqipëria në kuadër të këtij angazhimi ka ndërmarrë gjatë kësaj periudhe miratimin e katër Planeve Kombëtare të Veprimit nga viti 2011 dhe aktualisht po harton planin e pestë 2023-2025, në të cilin janë parashikuar angazhime të rëndësishme në adresim të sfidave të PQH-së në vend.

Konsultimi publik është mekanizmi që mundëson përfshirjen e publikut, grupeve të interesit, biznesit, komunitetit akademik, ekspertëve dhe medias në vendimarrje duke siguruar përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit të politikëbërjes, me qëllim krijimin e politikave me cilësi të lartë në përmbajtje, që mundësojnë zgjidhje afatgjata dhe sigurojnë zhvillim.

Shqipëria konsiderohet si vend pararojënë rajon lidhur me proceset e konsultimit publik dhe vlerësimin ndikimit rregullator, duke performuar mbi mesataren e rajonit bazuar në raportin Monitorimit të SIGMA 2021 mbi “Principet e Administratës Publike”.

Performanca e Shqipërisë në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave ka qenë e fortë dhe ka treguar përmirësim. Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ajo shënoi vlerat më të larta për shumë tregues. Vlera mesatare e përgjithshme dhe vlerat individuale të treguesve janë rritur nga 2.6 në 2017 në 3.4 në 2021, më e larta në rajon.

Gjithashtu dhe sa i përket procesit të vlerësimit të ndikimit, performanca e Shqipërisë është vlerësuar pozitivisht. Në Raportin e Monitorimit të vitit 2021 mbi Parimet e Administratës Publike, SIGMA vuri në dukje një rritje prej 2 pikësh për treguesin 2.10.1 –Politikëbërja e bazuar në prova dhe një rritje prej 12 pikësh për nën-treguesin e saj, në krahasim me vitin 2017. Rezultatet e arritura bëjnë që ne të renditemi mbi mesataren rajonale për këtë indikator si dhe për nën-indikatorët e tij¹².

3. Procesi i hartimit të Planit të Veprimit

Procesi u zhvillua sipas udhëzimeve dhe në përputhje me kërkesat dhe vlerat e OGP, ku institucionet dhe aktorët e interesit bashkërendojnë angazhimet dhe masat e ndërmarra në kuadër të përpjekjeve për një sistem demokratik, transparent dhe gjithëpërfshirës qeverisjeje.¹³

Takimi u zhvillua ndërmjet përfaqësuesve të Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri dhe aktorëve kryesor të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, përfaqësues nga organizata ndërkombëtare si OSCE, përfaqësues të komunitetit akademik me ekspertizë në fushën e “rregullimit të mirë” si për procesin e konsultimit publik edhe të ndikimit të vlerësimit rregullator.

Formati i hartuar i planit të veprimit u shpërnda për komente dhe rishikim pjesëmarrësve dhe versioni i konsoliduar i dakordësuar mes palëve iu dërgua Ministrisë së Shtetit për Standardet e Shërbimeve, i cili udhëheq procesin.

Dokumentacioni përkatës i procesit i përbërë nga agjenda, listë-

¹²<https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>

¹³<https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2022/03/OGP-National-Handbook-2022.pdf>

pjesëmarrja, procesverbalet e takimit, prezantimet, dhe të dhëna të tjera u publikuan në faqen zyrtare kombëtare www.ogp.gov.al

4. Angazhimet

Vlerësimi i ndikimit rregullator, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të janë në themel të një sistemi politikëbërje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson përfshirjen e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.

ANGAZHIM 23

FUSHA: E DREJTA NË INFORMIM & KONSULTIM DHE NDIKIM RREGULLATOR

ANGAZHIMI 23: Vlerësimi i ndikimit, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të jenë në themel të një sistemi politik-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson aksesin e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.

Vendi	Shqipëri		
Emërtimi i angazhimit	Vlerësimi i ndikimit rregullator, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të janë në themel të një sistemi politikë-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson përfshirjen e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Proceset e rëndësishme që lidhen me planifikimin e akteve rregullatore, vlerësimin e ndikimeve të tyre dhe konsultimit publik realizohen sipas standardeve dhe kërkesave të parashikuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor. Këto procese sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, mundësojnë që ligjet dhe politikat të hartohen mbi të dhëna dhe prova, si dhe bëjnë funksional një sistem qeverisjeje demokratik, të hapur dhe të përgjegjshëm.		
Udhëheqësi i angazhimit	Kryeministria, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë(DRrP)		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Sektor i Privat,etj.)
	Kryeministria Ministritë e Linjës Institucionet e varësisë së Kryeministritë.	<ul style="list-style-type: none"> - IDM Albania - Komiteti Shqiptar i Helsinkit - Këshilli i Investimeve - Ekspertë& Pedagogë - Etj. 	<ul style="list-style-type: none"> -Qytetarët në tërësi. -Komuniteti i biznesit -Komuniteti akademik -Organizata të Shoqërisë Civile
Periudha e zbatimit	2023 – 2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

Konsultimi Publik kontribuon në forcimin e besimit në institucionet publike, sundimin e ligjit dhe demokracinë. Institucionet publike përforcohen nga konsultimi publik në procesin e vendimmarrjes dhe kjo orienton drejt politikave të qëndrueshme që plotësojnë nevojat e shoqërisë. Procesi i konsultimit publik u mundëson autoriteteve publike të kërkojnë opinionin publik në lidhje me një temë ose politikë të caktuar, duke u informuar mbi zhvillimet aktuale të politikave dhe progresin e arritur nga autoritetet kompetente qeveritare, duke ftuar publikun të paraqesë komente, opinione dhe përgjigje, si dhe duke informuar sesi këto të fundit vlerësohen nga autoritetet publike. Një skemë e tillë jo vetëm që fuqizon publikun, por gjithashtu mundëson politika më të mira që adresojnë interesat publike.

Procesi i vlerësimit të ndikimit ndihmon qeverinë të marrë vendime më efektive në drejtim të politikëbërjes me qëllim alokimin e burimeve aty ku janë më shumë të nevojshme dhe ku japin rezultate më të larta me kosto më të ulëta. Sfidat më të madhe për mirëzbatimin e këtij procesi lidhet me efikasitetin e strukturave përgjegjëse për të kryer me sukses disa faza të ndërlydhura në këtë proces, sic janë:

- 1) Identifikimi i mirëstrukturuar i problemeve aktuale, shkaqeve të tyre dhe efekteve që shkaktohen nga to;
- 2) Sigurimi i informacionit dhe dëshmi/provave shtesë për hartimin e politikave/legjislationit;
- 3) Identifikimi i opsioneve;
- 4) Identifikimi i përfitimeve, kostove dhe rreziqeve të ndërhyrjeve të mundshme rregullatore;
- 5) Sigurimi i një argumenti përse është zgjedhur politika e rekomanduar, duke ndihmuar në këtë mënyrë në ndërtimin e besimit të publikut nëpërmjet llogaridhënies ndaj tij;
- 6) Identifikimi dhe inkurajimi i strukturave përgjegjëse për të menduar mbi rezultatet dhe se si ato do të vlerësojnë nëpërmjet monitorimit nëse këto rezultate janë arritur ose jo.

Mirëzbatimi i këtij procesi do të sigurojë një strukturë logjike për të planifikuar politikat nëpërmjet një programi legjislativ të hartuar në përputhje me nevojat reale rregullatore.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Konsultimi publik është një proces i dyanshëm i cili nënkupton transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike politikbërëse, dhe nga ana tjetër pjesëmarrjen e qytetarëve, grupeve të interesit si organizata të shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, komunitetit akademik e shkencor në procesin e hartimit të ligjeve dhe politikave duke kontribuar me komente, reagime dhe opinione, jo vetëm duke ushtruar kështu në formë të drejtpërdrejt autoritetin e sovranit por duke kontribuar gjithashtu në hartimin e ligjeve me të mira dhe të pranueshme nga publiku.

Kryerja e procesit në zbatim të parimeve, standardeve dhe kërkesave nga ana e institucioneve është në përmirësim të vazhdueshëm, megjithatë, në kuadër të angazhimeve evropiane dhe globale për një sistem akoma më të përparuar demokratik, kërkesat për konsultimin publik janë në rritje.

Nga ana tjetër, kultura pjesëmarrëse, nxitja e qytetarëve për pjesëmarrje në proces dhe sigurimi i aksesit nëpolitikëbërje të grupeve të nën përfaqësuar mbetet sfida për t'u adresuar në terma afatgjatë.

Së bashku me disa problematika si:mangësitë e respektimit në praktikë të kërkesave ligjore për konsultimin publik në nivel qendror dhe vendor, zbatimi i konsultimit publik për aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave,zbatimiinjëqasje pro aktive nga institucionet, besimi i publikut në procesin e konsultimit publik dhe rritja e kapaciteteve të koordinatorëve për kryerjen e procesit të konsultimit.

Procesi i vlerësimit të ndikimit mund te konsiderohet si një prej hallkave më të rëndësishme të procesit politikbërës. Megjithatë ky proces është ngushtësisht i ndërvarur nga procesi i programimit të akteve rregullatore, procesi i vlerësimit të cilësisë së tyre, si dhe procesi i konsultimit publik. Për këtë arsye, çdo lëshim në zbatimin e këtyre proceseve mund të krijojë probleme edhe në procesin e vlerësimit të ndikimit. Ndër shkaqete tjera mund të rendisim edhe risinë e zbatimit të këtij procesi në vendin tonë, si dhe shkaqet që lidhen me arsye administrative/kërkimore.

Përshkrimi i Angazhimit

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

1. Rritja e funksionalitetit të Regjistrisë Elektronike të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe zbatimiti njoftimeve automatike për aktorët e interesit;
2. Identifikimi i aktorëve të interesit sipas sektorëve;
3. Zyrtarizimi i detyrimit për zbatimin e procesit të vlerësimit të ndikimit nëpërmjet rishikimit të kuadrit rregullator.
4. Përforsimi i kontrollit të cilësisë së proceseve të vlerësimit të ndikimit, programimit të akteve rregullatore dhe konsultimit publik nëpërmjet fuqizimit të njësisë përgjegjëse në Kryeministri;
5. Zbatimi i një qasje monitoruese me orientim nga përmbajtja, si dhe diversifikimi i metodave të monitorimit;
6. Prezantim i rezultateve javore dhe periodike në nivele teknike dhe politike lidhur me procesin e konsultimit publik dhe procesin e vlerësimit të ndikimit;
7. Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të rrjetit të koordinatorëve të konsultimit publik, si dhe të rrjetit të koordinatorëve të vlerësimit të ndikimit.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

1. Aktorët kryesorë të interesit konsultohen gjerësisht, sipas procedurave dhe standardeve të parashikuara për procesin e konsultimit publik;
2. Qeveria dhe institucionet aplikojnë qasje proaktive dhe në shmangie të barrierave për përfshirjen në procesin e konsultimit publik të grupeve të nën-përfaqësuar nëpërmjet njoftimeve paraprake dhe konsultimeve tëtargetuara me qëllim dhënien zë këtyre target-grupeve;

3. Metodatat e konsultimit publik duhen diversifikuar, për t'u përshtatur me natyrën e projektaktit objekt konsultimi dhe veçoritë e grupit të synuar, duke zbatuar kriteret e parashikuara nga udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe matricën e analizës së palëve të interesuara;
4. Zhvillimi i dialogut konstruktiv dhe i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe aktorëve të interesit, dhe pasqyrimi i propozimeve dhe komenteve të tyre në projektin përfundimtar të aktit të hartuar;
5. Publikimi rigoroz dhe sipas parashikimeve ligjore në ligjin nr.146/2014 të raporteve të transparencës në procesin vendimmarrës.
6. Raportimi në formatin e raportit të rezultateve të konsultimit të rekomandimeve të grupeve të interesit që janë marrë në konsideratë, pranuar pjesërisht dhe refuzuar, si dhe përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre bërja e tyre transparente për çdo akt;
7. Publikimi i akteve së bashku me dokumentet shoqërues të informacionit për konsultim me publikun e gjerë në faqen zyrtare të konsultimit publik www.konsultimipublik.gov.al;
8. Vlerësimi i ndikimit rregullator zbatohet për projektaktet sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim hartimin e një legjislacioni efektiv e cilësor që prodhon efektet e dëshiruara.
9. Fillimi i procesit të vlerësimit të ndikimit nga institucionet përgjegjëse, në një fazë sa më të hershme dhe përgatitja e raporteve cilësore për projektaktet sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator.
10. Rritja e efikasitetit të strukturave përgjegjëse për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së vazhdueshme nëpërmjet zgjerimit të njohurive të tyre për këtë proces.
11. Garantim i hartimit të një programi legjislativ të mirë planifikuar dhe zbatimit efikas të tij.
12. Garantimi i qëndrueshmërisë së koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik në secilin institucion përgjegjës dhe ky pozicion të ushtrohet nga nëpunës civilë të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, për të garantuar autoritetin e nevojshëm në të gjitha nivelet e punonjësve dhe strukturat e institucioneve për zbatimin e ligjit nr.146/2014.
13. Monitorimi i zbatimit të përmbushjes së detyrimit nga institucionet për të përditësuar në mënyrë periodike raportet e konsultimit publik të hartuara, në kuadër të zbatimit të detyrave të tyre funksionale kundrejt publikut të gjerë.
14. Institucionet përgjegjëse kontribuojnë në hartimin e qasjeve metodologjike dhe formateve të thjeshta e të kuptueshme për publikun e gjerë dhe palët e interesit, të cilët synojnë përfshirjen në procesin e konsultimit publik.
15. Nxitja e një qasjeje monitoruese dhe vlerësuese nga ana e institucioneve eprorë, ndaj atyre të varësisë, lidhur me zhvillimin e indikatorëve krahasimorë dhe analizues, të suksesit, vështirësive e sfidave me të cilat haset procesi i njoftimit dhe konsultimit publik.

5. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të zbatimit të angazhimit?

1. Qeverisje transparente, llogaridhënëse, e hapur e më përfaqësuese, si dhe politika efektive jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse;
2. Forcimi i besimit në institucionet publike, sundimin e ligjit dhe funksionimit të duhur të institucioneve demokratike;
3. Kuadër ligjor dhe politika të hartuara bazuar në prova, të pranuar dhe të zbatueshme nga publiku
4. Rritje e shkallës së transparencës dhe përgjegjësisë së autoriteteve publike ndaj publikut dhe palëve të interesuara.

Angazhimi				
Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit	
Frekuenca dhe indeksi i cilësisë së konsultimit publik, monitorohen periodikisht dhe rezultatet bëhen transparente.	Raportet periodike të performancës së konsultimeve publike për qeverinë dhe institucionet hartohen dhe publikohen.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)	
			<u>Aktorët e Interesit</u>	
			Qeveria	OSHC-të
Qendra e qeverisjes udhëheq dhe monitoron cilësinë e procesit të KP duke zbatuar qasjen e orientuar nga përmbajtja.	Raportet e konsultimit publik për aktet individuale vlerësohen dhe dakordësohen nga struktura përkatëse në Kryeministri.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)	
			<u>Aktorët e Interesit</u>	
			Qeveria	OSHC-të
Përmirësimi i cilësisë së raporteve të vlerësimit ndikimit, në përputhje me kriteret e metodologjisë RIA dhe parimit të qeverisjes së mirë.	Raportet RIA të hartuara bazuar në shembujt e praktikave më të mira, në përputhje me standardet e vendosura nga metodologjia, si dhe në zbatim të rekomandimeve të institucioneve/organizatave ndërkombëtare.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)	
			<u>Aktorët e Interesit</u>	
			Qeveria	OSHC-të
			Kryeministria	
			- Ministritë e linjes	
			- Institucionet e varësisë	
			- Kryeministria	
			- Ministrite e linjes	
			- Institucionet e varësisë	
			- Kryeministria	
			- Ministrite e linjes	
			- Institucionet e varësisë	
			- Kryeministria	
			- Ministrite e linjes	
			- Institucionet e varësisë	

			-Institucionet e varësisë		
Përmirësimi i procesit të hartimit dhe zbatimit të Programit tëPërgjithshëm Analitik tëProjektakteve.	Program i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve i mirëplanifikuar dhe i zbatuar në nivele më të larta.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,et j.)
			Kryeministria -Ministrite e linjes -Institucionet e varësisë	-	
Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve të rrjetit RIA në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator.	Administratë e trajnuar mbi parimet bazë dhe aspekte të ndryshme teorike dhe praktike të procesit të vlerësimit të ndikimit.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj.)
			Kryeministria -Ministrite e linjes -Institucionet e varësisë	SIGMA, RESPA,.	
Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rrjeti KP) në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të konsultimit publik.	Trajnimeve te zhvilluara dhenëpunëstë trajnuar për procesin Konsultim Publik.	6 M II 2023 – 6M I 2025	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat,etj.)
			- Kryeministria -Ministritë e linjës -Institucionet	SIGMA, IDM/NE D, RESPA,.	

			e varësisë - ASPA		
Fuqizimi i shoqatave të biznesit dhe aktorëve të tjerë të interesit lidhur me procesin e konsultimit publik.	Workshop-e dhe trajnime të ofruara për shoqatat e biznesit dhe OJQ me qëllimritjen e përfshirjes së tyre në procesin e konsultimit publik.	6M II 2024	Udhëheqësi: Kryeministria (DRrP)		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj.)
			- Kryeministria - AMSHC	- SIGMA - Donatorë dhe Partnerë për zhvillim.	

ANGAZHIM 24

FUSHA: PARLAMENT I HAPUR

ANGAZHIMI 24: Bashkëndimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimit të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vënies në jetë të Platformës e legislation

1.Pjesa hyrëse

Një parlament i hapur që inkurajon transparencën, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien gjatë gjithë procesit legjislativ është një kriter thelbësor për një parlament demokratik dhe gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e një qeverisjeje të hapur. Sigurimi i aksesit në informacionin legjislativ dhe krijimi i mekanizmave për pjesëmarrjen e publikut janë thelbësore për ndërtimin e një marrëdhënieje transparente dhe besimi me qytetarët. Ky angazhim është vendimtar edhe për progresin e përgjithshëm të Shqipërisë drejt integritimit në BE dhe për krijimin e një roli më aktiv dhe më kuptimplotë të parlamentit në zhvillimin e Shqipërisë.

2. Progresi i qeverisjes së hapur

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka nënshkruar Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Konfederatës Zvicerane të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim që vepron nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nëpërmjet Prezencës së saj në Shqipëri mbi projektin “Mbështetje për Kuvendin dhe Edukimi Qytetar (PACEP)”

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është: Qytetarë më të vetëdijshëm dhe të arsimuar për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje. Objektivat kryesore të projektit janë: a) Rezultati 1: Administrata e Kuvendit tëpërbushëfksionet e saj në mënyrë efikase dhe efektive. b) Rezultati 2: Parlamenti të përmirësojë funksionet e tij legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese duke përfaqësuar më mirë votuesit e tij dhe duke e mbajtur pushtetin ekzekutiv përgjegjës. c) Rezultati 3: Qytetarë që kërkojnë hapësirën e tyre në zhvillimet demokratike të vendit dhe janë të përgatitur të kërkojnë llogari nga deputetët e Kuvendit dhe të ndikojnë në reformat e vendit.

3.Angazhimet

Bashkëndimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimit të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vënies në jetë të Platformës e legislation

ANGAZHIM 24

FUSHA: PARLAMENT I HAPUR

ANGAZHIMI 24: Bashkërendimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimit të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vënies në jetë të Platformës e-legislation

Vendi	Shqipëria		
Emërtimi i angazhimit	FUSHA 8: Hapja E Parlamentit/Open Parliament Bashkërendimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimit të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vënies në jetë të Platformës e-legislation		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	<ul style="list-style-type: none">• Implementimi i platformës“e-legislation” (pjesë e projektit PACEP) përmes Standardit AKN4AL (Akomantoso për Shqipërinë) do të rezultojë në një sistem legjislativ të integruar dhe transparent që do të përmirësojë aksesin në ligjet e konsoliduara dhe të dhënat parlamentare.• Shqyrtimi i vendimit 49/2017 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese” synon të forcojë rolin e Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin në monitorimin e ministrive të linjës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe të inkurajojë më tej përdorimin e Platformës Ndërinstitucionale Online.		
Udhëheqësi i angazhimit	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin		
Grupet e Interesit që mbështesin angazhimin	Qeveria	Shoqëria Civile	Aktorë të tjerë(Parlament,Spektori Privat,etj)
			Kuvendi i Shqipërisë
Periudha e implementimit	2023 – 2025		

Identifikimi i problemit

1. Çfarë problemi synon të adresojë angazhimi?

- Përmirësimi i ndërveprueshmërisë ndërmjet sistemeve dhe fazave të ndryshme gjatë procesit legjislativ.
- Nevoja për të pasur formate standarde për të shmangur format e ndryshme të formatimit dhe devijimet nga rregullat e hartimit.
- Pamundësia për të përcaktuar përmbajtjen e një dokumenti në momente të ndryshme kohore.
- Mungesa e legjislacionit në një format lehtësisht të aksesueshëm që pasqyron të gjitha ndryshimet e deritanishme, ndryshe referuar si version i konsoliduar i një ligji të ndryshuar disa herë.
- Kapacitetet e parlamentit në procesin ligjberës dhe mbikëqyrja janë të ulëta për shkak të një sistemi të dobët të administratës Kuvendit.
- Deputetët janë të ndikuar nga analizat e qeverisë për të vlerësuar ligjet dhe politikat e qeverisë dhe janë më të prirur ndaj polarizimit politik të punës së tyre.
- Për sa i përket funksionit të përfaqësimit të parlamentit, ka një hendek të madh mes qytetarëve dhe parlamentit.
- Kontributi i organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në procesin legjislativ është i kufizuar.
- Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është shumë e kufizuar në realitetin shqiptar.
- Mungesa e reagimit të organeve të administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Disa nga shkaqet e problemeve:

- Mungesa e kapaciteteve në stafin administrativ të Kuvendit.
- Teknologjia e vjetëruar, veçanërisht në procesin legjislativ.
- Mungesa e transparencës së procesit legjislativ.
- Mungesa e një plani strategjik afatgjatë për parlamentin
- Mangësitë teknologjike të infrastrukturës parlamentare për sa i përket shërbimeve arkivuese apo legjislative.
- Ekzistenca e një mosbesimi të lartë të qytetarëve ndaj parlamentit.
- Mungesa e informacionit të besueshëm mbi zhvillimet legjislative nëpërmjet medias dhe aksesit në vendimmarrje.
- Mungesa e reagimit të organeve të administratës shtetërore ndaj rekomandimeve të institucioneve të pavarura

3. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Janë bërë shumë ndryshime praktike.

Për sa i përket projektit E-legislation/PACEP:

- Shërbimi i Edukimit Qytetar (SHEQ) është ndërtuar si pjesë e Institutit Parlamentar (IP), i cili ka për mision të krijojë dhe zbatojë programe që informojnë dhe edukojnë qytetarët për demokracinë dhe qeverisjen, si dhe inkurajojnë qytetarët të jenë aktivë në punën e Kuvendit. Për të arritur atë që synon, SHEQ zbaton programe dhe aktivitete edukative dhe informative, si: 1) Programi "Democracy Workshop"; 2) Programi "Pikëpamja ime"; 3) Programi "Modeli i Kuvendit të Shqipërisë"; 4) "Udhëtimet parlamentare; 5) "Dyert e hapura", etj.
- Është hartuar një Plani Strategjik i Kuvendit. Plani Strategjik i Kuvendit 2020-2025, është dokumenti i parë gjithëpërfshirës strategjik që synon, ndër të tjera, modernizimin e ligjbërjes dhe forcimin e kontrollit parlamentar.
- Një aplikacion e-legislation është zhvilluar në telefon për deputetët
- Digjitalizimi i të dhënave ekzistuese parlamentare dhe integrimi me sistemin e-legislation

Për sa i përket Platformës së Mekanizmit Ndërinstitucional:

- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka krijuar një rrjet koordinatorësh brenda çdo ministrie për të mbështetur procesin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ky rrjet është përgjegjës për monitorimin e progresit të nivelit të zbatueshmërisë dhe raportimin dy herë në vit.
- Në prill 2022 u mbajt takimi vjetor i rrjetit të koordinatorëve, me detyra konkrete për vazhdimin e procesit të raportimit dhe përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjes së raportit.
- Me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, është ngritur një grup pune për shqyrtimin e vendimit 49/2017 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese". Ky grup pune përbëhet nga anëtarë të Drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit në Kuvend, përfaqësues nga Institucionet e Pavarura dhe përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

4. Cilat janë zgjidhjet e propozuara?

- **Ndërveprueshmëria:** Harmonizimi i formateve të dokumenteve ligjore përmes AKNAL do të mundësojë ndërveprueshmërinë ndërmjet institucioneve, shkëmbimin e të dhënave, përdorimin e mjeteve të përbashkëta.
- **Legjislacioni i konsoliduar:** Legjislacioni i konsoliduar do të gjenerohet në kohë reale pa pasur nevojë për përpilim manual.

- **Qasje publike:** Media, OSHC dhe gjithë publiku do të jetë në gjendje të kërkojë dhe të gjejë legjislacionin në një format të përpiluar, së bashku me të gjithë historinë legjislative të çdo akti.
- **Transparenca:** Aftësia për të parë të gjithë historinë legjislative të një akti do të përmirësojë transparencën e Parlamentit si brenda (ndërmjet deputetëve, komisioneve, stafit) ashtu edhe jashtë (publiku).

Për sa i përket Platformës së Mekanizmit Ndërinstitucional:

- Një angazhim shumë aktiv drejt një funksionimi të mirë të mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe gjithashtu në nxitjen e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura të dhëna për institucionet ekzekutive.

5. Cilat janë rezultatet e pritshme në kuadër të implementimit të angazhimit?

Rezultatet e projektit E-legislation:

- Zbatimi i standardit AKN4AL XML në dokumentet legjislative
- Dixhitalizimi i dokumenteve dhe arkivave të kaluara parlamentare duke përdorur AKN4AL dhe inkorporimi i të dhënave dixhitale në kornizën e Legjislacionit elektronik.

Rezultati i Rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të platformës së mekanizmit ndërinstitucional:

- Përmirësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura të dhëna për institucionet e ekzekutivit me qëllim: Forcimin e rolit të Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin në monitorimin e ministrive të linjës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe nxitjen e mëtejshme të përdorimit të Platformës Ndërinstitucionale Online.

Angazhimi					
Aktivitetet/Milestone s	Produktet e pritshme	Data e pritshme e përfundimit	Aktorët e Interesit		
Organizimi i eventeve të rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit mbi e-Legislation me target group deputetët, stafet e ministrive, përfaqësues të akademisë dhe shoqërisë civile.	<ul style="list-style-type: none"> Objektivi do të jetë të fitohen njohuri nga praktikat e avancuara dhe në të njëjtën kohë të demonstron se si funksionon sistemi e-Legjislacioni dhe si do të përfitojnë grupe të ndryshme të interesit. 	6M II 2023-6M I 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			Specialistë nga zyrat e deputetëve të 12 qarqeve të vendit		
Përditësimi i <i>Standard Operating Procedures</i> (SOPs) të Parlamentit dhe i kornizës ligjore për tu përshtatur me <i>workflow</i> të e-Legjislacioni. Workflow i stafit parlamentar në departamentin e legjislacionit dhe komisionet duhet të përditësohen dhe përshtaten me procesimin e dokumenteve legjislative gjatë përdorimit të software-t të E-legislation.	<ul style="list-style-type: none"> Inkorporimi i e-Legjislacionit në <i>workflow</i> të punës së stafit parlamentar do të realizohet duke përgatitur PSV-të për e-Legjislacionin. Kuadri ligjor që rregullon mënyrën se si përpunohen, modifikohen dhe publikohen ligjet, duke përfshirë Rregulloren e Punës të Kuvendit, do të rishikohet gjithashtu për të përcaktuar nëse do të nevojiten ndonjë ndryshim për të akomoduar sistemin e-Legjislacioni 	6M II 2023-6M I 2024	Udhëheqësi:		
			<u>Aktorët e Interesit</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerë(Parlamenti, Sektori Privat, etj)
			OSBE		

